

Glikeria Ilioska

DORACAK PËR MËSIMDHËNËSIT E SHOQËRISË për klasën e parë



Shkup, viti 2022

Impresum

Autore:

Glikerija Ilioska, mësimdhënëse klasore – mentore

Recensioni :

Prof. Dr. Lena Damovska, Instituti i Pedagogjisë, Fakulteti Filozofik UKM – Shkup

Sonja Trifunovska, mësimdhënëse klasore – mentore

Lektor:

Aleksandar Zdravevski

Dizajni grafik dhe rregullimi teknik:

KOMA dizajn studio

PËRMBAJTJA	
HYRJE	6
UDHËZIME PËR PËRDORIMIN E DORACAKUT	7
UDHËZIME METODIKE-DIDAKTIKE.....	8
PROPOZIM-SKENARË PËR REALIZIMIN E PËRMBAJTJEVE MËSIMORE NË SHOQËRI PËR KLASËN E I-rë..	14
.....	15
TEMA 1: UNË JAM FËMIJË.....	15
PËRMBAJTJA: KUSH JAM UNË?.....	15
PËRMBAJTJA: ÇFARË MUND TË BËJ TANI DHE ÇFARË DO TË MUND TË BËJ NË TË ARDHMEN?.....	18
PËRMBAJTJA: ÇFARË MË PËLQEN TE VETJA.....	20
PËRMBAJTJA: ÇFARË MË PËLQEN TE VETJA? (ME PUNË DREJT SUKSESIT).....	25
PËRMBAJTJA: SHOKËT DHE SHOQET E MIA.....	29
TEMA 2: UNË JAM NXËNËS	32
PËRMBAJTJA: KLASA DHE SHKOLLA JONË	33
(KLASA JONË)	33
PËRMBAJTJA: KLASA DHE SHKOLLA JONË	39
(KUJDESI PËR HIGJENËN NË SHKOLLË DHE OBORRIN E SHKOLLËS)	39
PËRMBAJTJA: KLASA DHE SHKOLLA JONË	42
(SI SILLEM NË KLASË, SHKOLLË DHE OBORRIN E SHKOLLËS?)	42
PËRMBAJTJA: NE NXËNËSIT DHE MËSUESI/MËSUESJA JONË.....	45
TEMA 3: SHTËPIA IME.....	48
.....	48
PËRMBAJTJA: SHTËPIA DHE FAMILJA –	48
KU JETOJ (SHTËPI, BANESË)?	48
PËRMBAJTJA: SHTËPIA DHE FAMILJA.....	53
(ME KË JETOJ?)	53
PËRMBAJTJA: ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË SHTËPI.....	55
(SI KUJDESIMI PËR SHTËPINË TONË?).....	55
PËRMBAJTJA: ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË SHTËPI.....	58
(RESPEKTIMI I NDËRSJELLË NË SHTËPI)	58
PËRMBAJTJA: AKTIVITETE BREDA DITËS	61
(NJË DITË ME FAMILJEN TIME)	61

PËRMBAJTJA: QYTETI/FSHATI DHE SHTETI IM –.....	66
KU JETOJ (QYTET/FSHAT, SHTET)?	66
PËRMBAJTJA: LUAJ I SIGURT DHE ORIENTOHEM NË HAPËSIRË	70
PËRMBAJTJA: UNË LËVIZ I SIGURT DHE MARRË PJESE NË TRAFIK.....	72
(SHENJAT E TRAFIKUT DHE SEMAFORI).....	72
PËRMBAJTJA: NDIHMA E PARË, ZJARRFIKËSI DHE POLICIA	75
SHTOJCA.....	78
Falënderim.....	98
Literatura e shfrytëzuar	99

Të nderuar mësimdhënës,

Doracaku për Shoqërinë për klasën e parë, i cili është mjet ndihmës për punën e mësimdhënësve klasorë, është hartuar përmes bashkëpunimit dhe mbështetjes profesionale të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit. Ky doracak përmban qasje të reja, moderne për mësimin e hershëm dhe zhvillimin e fëmijëve në ciklin e parë arsimor të arsimit fillor. Duke ndjekur udhëzimet, Doracaku ju jep mundësinë për të forcuar kompetencat tuaja për një qasje inovative në procesin mësimor dhe për të realizuar mësimdhënien në përputhje me programet e reja mësimore.

Sinqerisht, besoj se përdorimi i këtij Doracaku do ta bëjë punën tuaj më të lehtë dhe do të jetë një nxitje për orë edhe më kreative që do të jenë të mbushura me buzëqeshje, entuziazëm dhe dëshirë për t'u sendërtuar.

Autorja

HYRJE

Bazuar në njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet që duhet të përvetësojnë nxënësit e arsimit fillor në kontekstin tonë shoqëror, janë përcaktuar tetë fusha të standardeve kombëtare në arsimin fillor në vendin tonë. Ato përfshijnë kompetenca transversale dhe/ose kompetenca që lidhen me fusha specifike lëndore. Ato fusha janë:

I. Edukimi gjuhësor.

II. Përdorimi i gjuhëve të tjera.

III. Matematika dhe shkencat natyrore.

IV. Edukimi digjital.

V. Zhvillimi personal dhe social.

VI. Shoqëria dhe kultura demokratike.

VII. Teknika, teknologjia dhe sipërmarrja.

VIII. Shprehja artistike dhe kultura¹.

Ky kompleksitet krijon një nevojë në rritje për nxënësit që të zotërojnë aftësitë bazë (si: komunikim, të menduarit kritik, zgjidhje e problemeve etj.) për t'u mundësuar atyre të kuptojnë më mirë dhe të marrin pjesë në shoqërinë në të cilën jetojnë. Duke u nisur nga fakti se shkencat shoqërore janë të lidhura ngushtë me përvetësimin e këtyre kompetencave, mund të shihet rëndësia e lëndës **Shoqëria** për ndërtimin e një personaliteti që do të marrë pjesë dhe do të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë dhe, në të njëjtën kohë, do të ndërtojë veten si një personalitet.

Lënda mësimore **Shoqëria** në klasën e parë përfaqësohet me një orë në javë, pra 36 orë në vit. Temat dhe përmbajtjet që dalin nga rezultatet e të nxënit janë të strukturuar në atë mënyrë që u mundëson atyre të integrohen me lëndët dhe përmbajtjet e tjera mësimore, duke mundësuar kështu transversalitetin në fushat e sipërpërmendura.

Doracaku është konceptuar që t'u shërbejë mësuesve² si një mjet pune dhe qëllimi i tij është të kontribuojë në zhvillimin e kompetencave të mësuesve dhe promovimin e gjithëpërfshirjes, ndërkulturës dhe barazisë/ndjeshmërisë gjinore. Synimi është që nëpërmjet Doracakut të merren ide, frymëzim dhe ndihmë praktike për aplikimin e qasjeve inovative pedagogjike që do të kontribuojnë në zhvillimin e njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësve që promovojnë standardet kombëtare. Ai ofron shembuj se si nxënësit mund t'i demonstrojnë këto kompetenca dhe shembuj të mënyrave se si mësuesit mund të mbështesin njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nxënësve: angazhimi në të nxënit, zgjidhjen e problemeve dhe iniciativën dhe kreativitetin e tyre.

¹ Standardet nacionale për arttjet e nxënësve deri në fund të arsimit fillor.

² Shënim: Në tekstin e mëposhtëm fjala mësues do të përdoret si term për personin që kryen mësimdhënie (mësues, mësuese).

Nëpërmjet aktiviteteve të paraqitura në Doracak për lëndën Shoqëria për klasën e parë, nxënësit do të shqyrtojnë role, marrëdhënie dhe përgjegjësi të ndryshme në shtëpi dhe shkollë, si mund të ndryshojnë dhe si lidhen me ndjenjën e tyre dhe të tjerëve për veten. Ata do të zhvillojnë nevojën e tyre për t'u sjellë me përgjegjësi dhe respekt ndaj të gjitha qenieve të gjalla, si dhe ndaj mjedisit natyror. Nxënësit, po ashtu, do të eksplorojnë edhe komunitetin e tyre lokal, karakteristikat e tij dhe mënyrën se si ai plotëson nevojat e njerëzve që jetojnë dhe punojnë atje. Nëpërmjet aktiviteteve të propozuara në skenarë, ata do të njihen me procesin e kërkimit, debatit, të mësuarit kooperativ dhe do ta përdorin këtë proces për të përvetësuar aftësitë e komunikimit, të të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve.

ÇFARË PËRMBAN KY DORACAK?



UDHËZIME PËR PËRDORIMIN E DORACAKUT

Doracku përbëhet nga katër pjesë. Pjesa e parë përmban udhëzimet për përdorimin e Doracakut për lëndën Shoqëria për klasën e parë. Pjesa e dytë përmban udhëzime metodike-didaktike që përmbajnë shembuj metodash, teknikash, monitorimi dhe vlerësimi të arritjeve të nxënësve, vetëreflektimi i mësuesit dhe përdorimi i TIK-ut në mësimdhënien e lëndës së Shoqërisë. Pjesa e tretë jep shembuj të skenarëve të mësimit.

Aktivitetet praktike që duhet të zbatojë mësuesi në mësimdhënie jepen në pjesën e tretë me shembuj të skenarëve të mësimit. Në këtë pjesë ofrohen nëntëmbëdhjetë shembuj përfaqësues të skenarëve që menduar se do të ishin të dobishëm për mësuesin në zbatimin e përmbajtjes mësimore. Çdo skenar bazohet në programin mësimor të lëndës Shoqëria e klasës së parë dhe përmban:

✓ **TEMA.** Në Programin mësimor të Shoqërisë për klasën e parë parashikohen katër tema: **Unë jam fëmijë, jam nxënës, Shtëpia ime dhe Vendi ku jetoj.** Në Doracak janë përfshirë të katër temat me shembuj për skenarë.

✓ **REZULTATET E TË NXËNIT.** Tregohet se cilat janë rezultatet e pritura (më të përgjithshme) të mësimit të temës përkatëse. Zakonisht ato janë një kombinim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve/vlerave të shumta. Ato janë dhënë në fillim të çdo teme në Doracak.

✓ **PËRMBAJTJA.** Tregohet se cila përmbajtje mësimore realizohet në atë orë mësimi (sipas standardeve të vlerësimit). Titujt e dhënë në kllapa u referohen titujve të materialeve mësimore.

✓ **STANDARDET E VLERËSIMIT.** U referohen rezultateve specifike dhe të matshme të të mësuarit bazuar në Taksonominë e Bloom-it. Ato mbulojnë fushën kognitive të arritjeve të nxënësve.

✓ NOCIONET. Informacion kyç kuptimin e të cilit nxënësit duhet të mësojnë.

✓ INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA DHE PËRMBAJTJE. Propozim për integrimin e lëndëve, temave dhe përmbajtjeve në një ditë mësimore. Përmbajtja e lëndës Shoqëria ofron mundësi për integrim me përmbajtjet e të gjitha lëndëve, ku kreativiteti i mësuesit del në pah. Në Doracak jepen sugjerime për integrim me një lëndë mësimore, temë dhe përmbajtje, por kjo nuk do të thotë që mësuesi duhet t'u përmbahet rreptësisht sugjerimeve të dhëna, por mund t'i përshtatë ato sipas planifikimit të tij. Një shembull konkret mund të gjendet në pjesën **Shtojcat** (shtojca nr. 3).

✓ NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË E MËPARSHME DHE TË ARDHSHE. Përshkruhet se cilat njohuri dhe aftësi të mëparshme i zotëron nxënësi, të cilat do të jenë bazë për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të reja dhe do të jenë kusht për arritjen e kompetencave që lidhen me standardet kombëtare.

✓ PAJISJET DHE MJETET E NEVOJSHME. Pajisjet dhe mjetet që nevojiten për realizimin e përmbajtjes përkatëse.

✓ KËSHILLA PËR MËSUESIMDHËNËSIN. Këshilla që do ta ndihmojnë mësuesin të realizojë më me sukses përmbajtjen e planifikuar mësimore dhe që u referohen udhëzimeve që lidhen me karakteristikat njohëse, afektive, socio-emocionale të nxënësve të kësaj periudhe zhvillimore, udhëzime metodike-didaktike të cilat do të jenë në dobi të mësuesit, por edhe propozimet për realizimin e aktiviteteve të lira.

✓ PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN. Propozime për aktivitete për pjesën hyrëse, kryesore dhe përfundimtare të orës së mësimi. Për çdo pjesë të orës ka një ose dy sugjerime nga të cilat mësuesi zgjedh një. Mësuesi zgjedh propozimin që mendon se do t'i përgjigjet strukturës së klasës, kohës dhe kushteve që disponon. Përveç sugjerimeve për aktivitete, kjo pjesë ofron edhe propozim-pyetje bazuar në Taksonominë e Bloom-it. Mësuesi/ja u drejton propozim-pyetjet nxënësve gjatë aktiviteteve dhe nëpërmjet tyre i udhëzon nxënësit në procesin e mësimnxënies.

Pjesa e katërt e Doracakut përmban shtojca me një tabelë për lidhjen e përmbajtjes me standardet kombëtare, shembuj të monitorimit dhe vlerësimit dhe një shembull të zbatimit praktik të metodës së të mësuarit aktiv në një ditë mësimore të integruar.

UDHËZIME METODIKE-DIDAKTIKE

Nisur nga fakti se mësimi i lëndës Shoqëria në klasën e I-rë realizohet sipas Konceptit të ri për arsimin fillor, duhet pasur parasysh se organizimi dhe realizimi i orës/ditës mësimore do të jetë në funksion të krijimit të nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike. Për këtë qëllim mësuesi është ai që e planifikon orën mësimore apo ditën mësimore të jenë efikas dhe efektiv. Efikasiteti nënkupton përdorimin racional dhe optimal të kohës dhe burimeve, kurse efektiviteti i referohet sistematikitetit dhe organizueshmërisë për arritjen e qëllimit.

Në mënyrë që mësuesi të arrijë qëllimin, duhet të planifikojë sistematikisht orën mësimore, gjatë së cilës duhet të dijë se cilat rezultate mësimore do të arrihen, cilat nocione duhet të përvetësohen, cilat janë standardet e vlerësimit dhe në çfarë mënyre do t'i arrijë të gjitha këto.

Njohja e qasjeve moderne të të nxënit, metodave dhe teknikave, formave të punës do t'i mundësojë mësuesit të realizojë në mënyrë efektive procesin mësimor, ndërsa qëllimi do të arrihet në mënyrë efikase.

Çdo metodë mësimore, në kombinim me metodat e tjera të mësimdhënies, teknikat mësimore dhe format e punës, duhet të gjejë aplikimin e duhur në varësi të natyrës së orës dhe përmbajtjes mësimore që përpunohet. Asnjëherë nuk duhet të ketë një qasje skematike në zbatimin e metodave të mësimdhënies.

Nga metodat e të nxënit aktiv të aplikuar në mësimdhënie, theksi vihet në disa prej tyre që do të mbështesin të nxënit. Këto janë:

Diskutim³. Nxënësit shkëmbejnë mendime dhe përvoja duke iu përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga mësuesi ose duke zgjidhur së bashku një problem të caktuar. Diskutimi si metodë zbatohet në të gjitha pjesët e orës së mësimimit. Mund të jetë gjithashtu një diskutim debati, kur dy (ose më shumë) grupe me këndvështrime të kundërta debatojnë për një temë të caktuar, pas një detyre të caktuar nga mësuesi. Një shembull i një diskutimi të tillë gjendet në skenarin për përmbajtjen *Shtëpia dhe familja* - Ku jetoj (shtëpi, banesë)? Por, mësuesi mund ta zbatojë atë edhe në përmbajtje të tjera sa herë që kupton se përmes tij mund të arrihen standardet e pritura të vlerësimit.

Mësimi i bazuar në projekte⁴. Bazohet në zhvillimin e shkathtësive njohëse, krijuese të rezultateve, përpjekjen për të dizajnuar njohuritë e veta në mënyrë të pavarur, zhvillimin e të menduarit kritik, bashkëpunimin dhe komunikimin. Nxënësit lëvizin drejt niveleve më të larta të të nxënit kognitiv (analizë, vlerësim dhe krijim) dhe mësojnë përmes të mësuarit nga përvoja, respektivisht të mësuarit përmes zbulimit. Karakterizohet nga fakti se mundëson integrimin e përmbajtjeve nga disiplinat/lëndët e njëjta ose ndryshme, nxënësit marrin pjesë në vlerësim, punojnë në një problem real dhe rezultati përfundimtar është një produkt. Kjo metodë në mësimdhënien e lëndës së Shoqërisë në klasën e parë mund të zbatohet pothuajse në çdo përmbajtje mësimore, duke u integruar me lëndët e tjera. Projektet ndiqen gjithmonë nga kërkimi, kështu që si lloje të veçanta të të mësuarit të bazuar në projekte mund të përmenden:

- Të mësuarit e bazuar në hulumtim/kërkim. Promovon të mësuarit nga përvoja dhe kooperativiteti. Zhvillon mendimin kritik dhe arsyetimin logjik bazuar në prova. Kjo zhvillohet në disa faza:

1. Vendosja e një problemi për hulumtim (pyetjes që duhet përgjigjur) dhe hipotezë (përgjigje e supozuar).

2. Mbledhja e të dhënave.

3. Përpunimi i të dhënave dhe nxjerrja e konkluzionit/konkluzioneve.

4. Prezantimi i hulumtimit.

Në materialet mësimore për lëndën Shoqëria për klasën e parë ka sugjerime për hulumtime të përshtatura me karakteristikat e moshës së nxënësve në këtë periudhë zhvillimore. Mësuesi zgjedh se çfarë lloj kërkimi do të zbatojë sipas kohës dhe kushteve që disponon, sipas karakteristikave të nxënësve të klasës.

- Të menduarit dizajnues (design thinking)⁵ (shtojca nr. 4). Projekte për zgjidhjen e problemeve duke

³ Planifikimi dhe realizimi i mësimdhënies sipas Konceptit të ri për arsimin fillor, Moduli 2, MASH, BZHA, 2021.

⁴ Planifikimi dhe realizimi i mësimdhënies sipas Konceptit të ri për arsimin fillor, Moduli 2, MASH, BZHA, 2021.

⁵ Më shumë rreth kësaj metode në: <https://www.youtube.com/watch?v=CeVal1eNSP0&t=4368s> dhe <https://www.interaction-design.org/literature/article/what-is-design-thinking-and-why-is-it-so-popular>.

dizajnuar një qasje mësimore ku nxënësit angazhohen në procesin e të mësuarit për të zgjidhur një problem të rëndësishëm, autentik dhe real. Nëpërmjet procesit të të menduarit dizajnues, nxënësit aplikojnë dhe zhvillojnë njohuritë e tyre për teknologjinë, shkencat natyrore, matematikën, shkencat shoqërore dhe gjuhët, rezultati përfundimtar i të cilave është një produkt me një zgjidhje origjinale. Gjithmonë përfshin integrimin e lëndëve të shumta dhe zhvillimin e proceseve më të larta të mendimit. Fazat e të menduarit dizajnues janë:

1. Hulumtimi dhe mirëkuptimi (empatia ndaj përdoruesve), duke përdorur metodat e mëposhtme: vëzhgim, intervistim, hulumtim.
2. Përcaktimi i sfidës: grupimi i temave dhe zgjedhja e një teme.
3. Gjenerimi i ideve përmes teknikës Stuhi mendimesh, krijimi i një matrice vlerësimi dhe votimi i ideve.
4. Prototipi i produktit (mund të jetë në formën e narrativëve, prototipit fizik, prototipit digjital, prototipit të hapësirës/shërbimit/ndërveprimit).
5. Testimi që përfshin: testimin me përdoruesit, grumbullimi i përshtypjeve, orientimet për përmirësim).

Në Doracak është prezantuar një shembull (në pjesën e **Shtojcave**, shtojca nr. 4) se si metodologjia e të menduarit dizajnues mund të zbatohet në një ditë të integruar duke integruar lëndët dhe përmbajtjet e Shoqërisë (tema: **Shtëpia ime**, përmbajtja: *Ku jetoj ?*), Shkencat e natyrës (tema: **Materialet**, përmbajtja: *Aplikimi i materialeve*), Gjuha maqedonase (fusha: **Edukimi mediatik dhe kultura mediatike**, përmbajtja: *Informacione nga media të ndryshme*) dhe Arsimi figurativ (tema: **Modelimi i plastikës**, përmbajtja: *Materialet/mjetet bazë për modelimin e plastikës*). Për shkak të kompleksitetit, rekomandohet që kjo metodë të zbatohet pasi nxënësit të jenë përshtatur me mjedisin shkollor dhe pasi të kenë filluar të respektojnë dhe zbatojnë rregullat për punën në grup.

Klasë e përmbysur (Flipped classroom)⁶. Kjo është një metodë në të cilën nxënësit fillimisht mësojnë përmbajtjen e re në shtëpi, dhe më pas në orë diskutojnë atë që kanë mësuar dhe i thellojnë njohuritë e tyre. Në mësimin e Shoqërisë në klasën e parë kjo qasje mund të përdoret në realizimin e përmbajtjeve të temës **Vendi ku jetoj** (*Shenjat e trafikut dhe semafori*), por nuk përjashtohen as temat dhe përmbajtjet tjera.

Metoda enigmatike⁷. Kjo metodë karakterizohet nga të mësuarit bashkëpunues ndërmjet anëtarëve të grupit, por edhe ndërmjet grupeve. Mozaiku është një strategji mësimore bashkëpunuese që lejon çdo nxënës i grupit "nikoqir" të specializohet në një aspekt të temës (për shembull, një grup i studion hapësirat dhe objektet në shkollë, grupi i dytë është i dedikuar për hapësirat dhe objektet, dhe grupi i tretë e studion sjelljen e duhur në hapësirat dhe ambientet e shkollës). Anëtarët e grupit bëjnë një plan pune dhe diskutojnë detyrën e caktuar. Pasi mësuesi ka caktuar detyrat, ai u lë kohë anëtarëve të grupit për të shqyrtuar materialin e ofruar dhe më pas krijon grupe të reja "eksperte" me një përfaqësues nga grupet "nikoqire". Nxënësit takohen me anëtarët e grupeve të tjera të cilëve u është caktuar i njëjti aspekt dhe pasi të kenë përvetësuar materialin, ata kthehen në grupin e tyre "nikoqir" dhe ua përcjellin materialin informues anëtarëve të grupit. Me këtë strategji, çdo nxënës në grupin "nikoqir" shërben si një pjesë e enigmës së temës dhe kur punojnë së bashku në tërësi ata krijojnë enigmën e plotë. Në fund të aktivitetit nxënësit i paraqesin të gjitha informacionet dhe prej tyre nxirren përfundime në nivel klase.

⁶ Më shumë rreth kësaj metode në: <https://www.yeseep.org/blog/the-flipped-classroom-model-what-it-is-and-how-it-works> dhe <https://www.youtube.com/watch?v=iCK4YhsL4Fw>.

⁷ Më shumë rreth kësaj metode në: <https://www.readingrockets.org/strategies/jigsaw>.

Kjo metodë mund të zbatohet sa herë që nxënësit duhet të eksplorojnë diçka brenda një përmbajtjeje të caktuar. Në këtë moshë mund të përdoret gjatë realizimit të temave: **Unë jam nxënës, Shtëpia ime dhe Vendi ku jetoj**. Një shembull i aplikimit të kësaj metode është dhënë në skenarin për përmbajtjen *Shkolla jonë*, e cila ndodhet në këtë Doracak.

Loja është një proces natyror përmes të cilit fëmijët mësojnë në mënyrë aktive. Nëpërmjet saj ata motivohen nga brenda për të eksploruar, eksperimentuar dhe zbuluar. Ajo e angazhon intelektin e tyre, emocionet, nxitjen për të mësuar gjëra të reja, për të krijuar ide, koncepte dhe aftësi të reja. “Loja, veçanërisht ajo didaktike dhe aktivitetet kërkimore bëhen strategji dominuese në krijimin e procesit edukativ-arsimor të fëmijëve të moshës së hershme shkollore. Nuk ka dyshim se kjo metodë e të nxënës (të mësuarit përmes lojës) duhet të jetë dominuese në periudhën parashkollore dhe atë të hershme shkollore”⁸. Në Doracak, në pjesën me skenarët e orës, ofrohen një sërë lojërash didaktike, lojëra të dramatizuara, lojëra kërkimore dhe lojëra krijuese. Të gjitha ato i mundësojnë nxënësit të kësaj periudhe zhvillimore që në mënyrë aktive të mësojë dhe zhvillojë aftësitë e tij njohëse, afektive dhe socio-emocionale.

Nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, nxënësit përdorin **të nxënës kooperativ**, i cili është një formë e të nxënës aktiv ku nxënësit punojnë së bashku për të kryer detyra konkrete në një grup të vogël. Çdo grup mësimor bashkëpunues duhet të zgjidhet me kujdes nga mësuesi, në mënyrë që struktura heterogjene t’i lejojë secilit nxënës të kontribuojë me pikat e tij të forta në përpjekjet e grupit. Ky lloj i të nxënës ndryshon nga të mësuarit tradicional në grup (puna në grup) në atë që në mësimin bashkëpunues anëtarët janë të ndërlidhur dhe përgjegjës si për mësimin e tyre ashtu edhe për mësimin e anëtarëve të tjerë, përbërja e grupit është e larmishme dhe të gjithë anëtarët e grupit kanë rolet e veta.

Teknikat e të nxënës dhe të mësimdhënies që do të përdorë mësuesi varen nga përmbajtja mësimore, struktura e klasës, kushtet materiale që disponon shkolla, por edhe nga gatishmëria e mësuesit për të përdorur teknikat e ndryshme dhe të shumta të të nxënës dhe mësimdhënies. Në varësi të qëllimit metodik të teknikës, mësuesi përcakton se cilën teknikë do të përdorë në cilën pjesë të orës së mësimi. Teknikat më të përshtatshme të të mësuarit në këtë periudhë zhvillimore janë loja me role, asociacionet, kuize, bingo, zgjidhja e situatave problematike, Imagjinata e drejtuar, Diagrami i Venit, Akuariumi, Stuhi mendimesh.

Monitorimi dhe vlerësimi i nxënësve ka për qëllim monitorimin dhe kontrollimin e arritjes së standardeve të vlerësimit nga program mësimor. Kryhet në mënyrë formative dhe përmbledhëse. Në fillim të vitit shkollor, në fillim të një teme të re ose në fillim të orës së mësimi të përmbajtjes së re, mësuesi nën *kontroll diagnostik* të njohurive të mëparshme të nxënësve që, duke pasur parasysh se gjatë gjysmëvjetorit të parë nxënësit nuk dinë shkrim-lexim, zhvillohet me gojë ose me ndihmën e ilustrimeve, fotografive, simboleve. *Monitorimi formativ* i nxënësve realizohet nëpërmjet aplikimit të instrumenteve dhe teknikave të ndryshme. Mësuesi e monitoron sferën njohëse, afektive dhe psikomotorë të nxënësve duke mbajtur shënime. Instrumentet monitoruese që mësuesi mund t’i përdorë në mësimin e lëndës së Shoqërisë për klasën e parë janë: listat kontrolluese, shënime anekdotike, rubrika, listat e vetëvlerësimit

⁸ Lena Damovska, Loja dhe të mësuarit – *koncepte të reja për mësimin e hershëm*. Shkup: “Prosvetno dello”, 2021.

të nxënësve, por edhe çdo instrument që ai vlerëson se është adekuat për të monitoruar progresin e nxënësve të këtë periudhë zhvillimore.

Rëndësi të veçantë ka vlerësimi ipsativ, respektivisht vetëvlerësimi i nxënësve, ku nxënësit vlerësojnë në mënyrë të pavarur arritjet e tyre dhe i krahasojnë ato me arritjet e tyre të mëparshme. Nëpërmjet vetëvlerësimit, nxënësi nxitet të konkurrojë me veten e tij, duke e përmirësuar veten. Në mësimin e lëndës Shqipëria për klasën e parë, ky lloj vlerësimi mund të kryhet me sukses në të gjitha përmbajtjet mësimore duke plotësuar simbole që tregojnë nivelet e arritjeve, simbole për vetëreflektim (*Sa jam i kënaqur me atë që kam mësuar? - Çfarë tjetër dua të mësoj? etj.*) ose të shfaqet përmes Shkallës së Arritjeve (shtojca 4). Gjatë periudhës së shkrim-leximit, nxënësit tashmë do të jenë në gjendje të vetëvlerësohen duke shkruar fjalë ose fjali të shkurtra.

Në mënyrë që monitorimi dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve të jetë më i suksesshëm, është mirë të njihen paraprakisht rezultatet specifike të pritura të të nxënësit (standartet e vlerësimit). Nxënësit informohen për të në fillim të çdo teme dhe çdo përmbajtjeje.

Informacionet kthyes me shkrim nga mësuesi u dedikohen prindërve. Nxënësit informohen gojarisht dhe me simbole të shkruara. Çdo informacion kthyes mbi arritjet dhe përparimin duhet të përmbajë tre elementë: çfarë është bërë mirë, çfarë duhet përmirësuar dhe çfarë duhet të bëjë nxënësi për ta përmirësuar atë.

Vetëreflektimi i mësuesit. Vetëreflektimi u lejon mësime nxënësve të shohin të gjitha vështirësitë me të cilat janë përballur në zbatimin e secilit segment të mësime nxënësve (të mësuarit, mësime nxënësve dhe vlerësimin) gjatë orëve të caktuara të ditës dhe njohuritë për t'i marrë ato parasysh në planifikim për të siguruar tejkalimin e dobësive të mundshme në mësime nxënësve. Kjo nënkupton ndryshimin e mësime nxënësve kur bëhet fjalë për miratimin e vazhdueshëm të përmbajtjeve konkrete mësimore dhe arritjen e rezultateve të pritura mësimore tek nxënësit aktualë, por edhe sendërtimin e përvojave të fituara në planifikimin për zbatimin e mësime nxënësve për nxënësit e ardhshëm⁹.

Kjo është kyç për përmirësimin e procesit të mësime nxënësve dhe u mundëson mësuesve të vlerësojnë dhe përmirësojnë qasjet e mësime nxënësve. Në vetëreflektim shprehen përshtypjet e mësuesit, përshtypjet e tij pas realizimit të orëve mësimore për suksesin në arritjen e rezultateve/standardeve të pritura për vlerësim, të cilat çojnë në drejtimin se çfarë duhet ndryshuar aktualisht apo në të ardhmen, e që është në interes të nxënësve. Vetëreflektimi është baza për:

✓ ndryshimet aktuale në punën (aplikimi i metodave, strategjive dhe teknikave të reja të punës);

✓ ndryshime në planin e orës mësimore (skenar) dhe/ose materiale mësimore për të ardhmen.

Mësuesi analizon situatën (në orë) dhe u jep përgjigje pyetjeve konkrete:

✓ *A i përmbahesha planit tim në aktivitetet e mia mësimore?*

✓ *Çfarë strategjish dhe teknikash kam aplikuar?*

⁹ *Koncepti për arsimin fillor*. Shkup: MASH, BZHA, 2021.

✓ Çfarë kam bërë mirë dhe çfarë kam për të përmirësuar?

✓ Çfarë ishte e vështirë për nxënësit? Si ta kapërcej atë?

✓ Duhet të punoj më shpejt apo më ngadalë?

✓ A ka ndonjë gjë që duhet të ndryshojë?

✓ Si mund ta përmirësoj performancën time?

✓ Do të përpiqem në punën time të ardhshme në klasë të arrij si vijon: ...

Aplikimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) në mësimdhënie është pjesë e mësimdhënies së nxënësve të klasës së parë. Pasuria e zgjedhjes që ofron interneti për krijimin e përmbajtjeve mësimore i jep mësuesit mundësinë të përdorë këtë burim të pakufizuar informacioni dhe të përmirësojë punën e tij me nxënësit. Lojëra edukative, kuize, asociacione, prezantime, përmbajtje multimediale tërheqin vëmendjen e nxënësit gjashtëvjeçar dhe nxisin kureshtjen dhe kreativitetin e tij. Në Doracak ofrohen shembuj të disa ueb aplikacioneve falas që do t'i mundësojnë mësuesit të krijojnë, ruajë dhe ndajë lehtësisht dhe shpejt kuize, asociacione, karta flash, shënime, prezantime interaktive, materiale video dhe audio, fletë pune ndërvepruese.

PROPOZIM-SKENARË PËR REALIZIMIN E PËRMBAJTJEVE MËSIMORE NË SHOQËRI PËR KLASËN E I-rë

TEMA 1: UNË JAM FËMIJË

Nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje të:

1. prezantohet para të tjerëve;
2. njeh ndjenjat themelore të vetja dhe të të tjerët;
3. përshkruajë tiparet e dëshiruara dhe sjelljen karakteristike të shoqërimet;
4. shpreh dhe të dallojë muajt e vitit dhe ditët e javës, të dallojë të tashmen (sot), të shkuarën më të afërt dhe më të largët (dje dhe kur isha i/e vogël) dhe të ardhmen (nesër dhe kur rritem).

Nxënësi/nxënësja do të zhvillojë:

5. imazh pozitiv për veten (vetëbesimi dhe vetëvlerësimi);
6. rezistencë ndaj sjelljeve korruptive.



PËRMBAJTJA: KUSH JAM UNË?

STANDARDET E VLERËSIMIT

Prezantohet duke treguar emrin dhe mbiemrin, adresën dhe vendbanimin dhe identifikohet sipas gjinisë (djalë apo vajzë) dhe moshën.

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Fëmijë, djalë, vajzë, emri, mbiemri, adresa.



INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Të dëgjuarit dhe të folurit** (*Përshëndetje, prezantim dhe adresim*); Shkencat natyrore, tema: **Njeriu dhe trupi i njeriut** (*Karakteristikat e jashtme të njerëzve*); Matematikë, tema: **Gjeometria dhe matja** (*Pozicioni dhe lëvizja*); Arsimit Figurativ, tema: **Vizatim (Vizatim i thjeshtë)**; Edukimi muzikor, tema: **Këndojmë, kërcëjmë dhe luajmë** (*Këngë dhe numëratore*); Arsimit fizik dhe shëndetësor: tema: **Unë dhe trupi im** (*Sa i madh jam?*)

NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË E MËPARSHME DHE TË ARDHSHE

Përmbajtja *Kush jam unë?* lidhet me përvojat e mëparshme të nxënësve për vetëdijen e tyre. Në fillim të temës ose në fillim të përmbajtjes, mësuesi kryen një kontroll fillestar të njohurive paraprake të nxënësve për të identifikuar dhe përshkruar pamjen e jashtme të tyre (flokët, ngjyra e syve, gjatësia, rrobat), moshën, gjininë (mashkull, femër), mënyrën e prezantimit, identifikimin e vendbanimit dhe adresës së tyre. Njohuritë dhe aftësitë e të kuptuarit të përvetësuar nga kjo përmbajtje do të jenë bazë për ngritjen e kompetencave të nxënësve që i referohen jetës ndërkulturore, ndjeshmërisë gjinore dhe përfshirjes së përmbajtjeve që vijojnë në këtë temë.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Pasqyrë, shkumësa me ngjyra, siluetë e vizatuar e një fëmije.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Mësuesi planifikon aktivitete që do të lidhen me nxitjen e njohurive paraprake të marra në kopsht dhe njohurive të përgjithshme nga shtëpia ku jeton nxënësi, nga prindërit/kujdestarët, të afërmit dhe moshatarët. Në këtë kontekst, ai organizon aktivitete që ndërlidhen në përvojat e mëparshme të nxënësve.

Propozimi 1. Secili nxënës prezantohet para shokëve të klasës me fjalët: *“Përshëndetje! Unë jam..., kam... vjet dhe jetoj në... në rrugën...”* Në aktivitetin e radhës, secili nxënës i përshkruan karakteristikat e tij fizike dhe më pas përshkruan shokun e tij.

Propozimi 2. Nxënësit e shohin veten në një pasqyrë të madhe dhe e përshkruajnë veten gojarisht, duke filluar nga pamja e jashtme: gjatësia, ngjyra dhe gjatësia e flokëve, ngjyra e syve, veshja. Ata, gjithashtu, e tregojnë emrin dhe mbiemrin, gjininë dhe moshën. Nëse një nxënës nuk e di moshën, mësuesi e nxit atë duke e krahasuar moshën me shokët e tjerë të klasës. Më pas nxënësit e përshkruajnë shokun e tyre në të njëjtën mënyrë dhe rend siç e përshkruan veten. Pasi e përshkruajnë shokun e tyre, nxënësit e deklarojnë vendbanimin (qytetin/fshatin) dhe adresën.

Propozim-pyetje. *Si e ke emrin dhe mbiemrin? – Ku jeton? – Sa vjet ke? – Çfarë je – mashkull apo femër? Përshkruaje veten si dukesh – e më pas përshkruaje shokun tënd! – Si duhet të prezantohemi? – Në cilat*

situata duhet të prezantohen me emrin dhe mbiemrin e plotë dhe adresën e banimit? – Çfarë duhet të bësh kur prezantohesh?

AKTIVITETI KRYESOR – të mësuarit nga përvoja

Shtojca 1. Nxënësit e ndjekin tregimin "Lepurushat pa emër" teksa mësuesi ua lexon dhe më pas u përgjigjen pyetjeve që lidhen me përmbajtjen. Qëllimi është t'i inkurajojmë ata të kuptojnë se çdo fëmijë ka emër dhe mbiemër.

Shtojca 2. Nxënësit e ngjyrosin një siluetë të përfunduar të një fëmije. Ata i vënë një emër dhe luajnë një lojë në të cilën ua prezantojnë dhe përshkruajnë shokun e tyre imagjinar shokëve të klasës. Qëllimi i këtij aktiviteti është të inkurajojë dhe zhvillojë shkathësitë e të folurit tek nxënësit, të fitojnë shprehinë e të shprehurit të lirë para të tjerëve dhe, në të njëjtën kohë, të krijojnë një parakusht për prezantim para shokëve të klasës dhe se si të prezantohen në situatë e përshtatshme.

Propozim-pyetje. *Për çfarë shërben emri dhe mbiemri? - Çfarë emri tjetër do t'i vendosnit lepurushëve/fëmijës që i vizatove? - Si do të prezantohesh para shokut tënd dhe para një të rrituri? - Si do ta prezantoni veten? (Kjo do të thotë lëvizje, gjestikulim, intonacion zëri.) - Pse është e nevojshme të dini se si dhe në cilat situata të prezantoheni? - Pse është e nevojshme të dihet adresa e banimit?*

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit ndahen në dyshe dhe vizatojnë në një fletë veten dhe shokun e tyre nga dyshja. Ata i perceptojnë dallimet dhe diskutojnë për sa i përket karakteristikave fizike, emrit, mbiemrit, gjinisë, moshës, adresës së banimit. Zbulojnë tipare të përbashkëta (e njëjta ngjyrë sysh, i njëjti emër, e njëjta gjini, i njëjti vendbanim). Më pas, në nivel klase zbulojnë se cilët prej tyre kanë të njëjtin emër, të njëjtin mbiemër, të njëjtin vendbanim. Ata krijojnë një tabelë në të cilën shkruajnë ose vizatojnë me një simbol emrat e shokëve të tyre me të njëjtin emër, të njëjtin mbiemër ose të njëjtat initiale. Ata diskutojnë pse çdo person duhet të ketë emër dhe mbiemër.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë që kanë bërë në klasë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, ku do ta zbatojnë atë që e kanë mësuar.

Propozim-pyetje. *Çfarë gjete të përbashkët me shokun tënd? - Çfarë është ndryshe? - Cili nga ju ka të njëjtin emër? - Kush kanë të njëjtin mbiemër? - Cili prej jush ka të njëjtin vendbanim? - Pse çdo person duhet të ketë një emër dhe mbiemër?*

SHTOJCË

LEPURUSHËT PA EMRA

Një lepurushe kishte dy lepurushë. Lepurushët ishin të vegjël dhe kishin lesh të bardhë. Ata nuk dalloheshin në asgjë. Ata vazhdimisht luanin bashkë dhe ishin të pandashëm. Një ditë, të zhytur në lojë, ata u larguan nga nëna e tyre. Kur erdhi koha për drekë, ajo filloi t'i kërkonte. Ajo i kërkoi, i kërkoi, por nuk i gjeti. Filloi t'i thërriste: "Lepurusha, lepurusha, ku jeni?" Ata e dëgjuan, por nuk e dinin që ajo po i thërriste. Ata menduan se ishte një lepurushe tjetër nënë që i thërriste lepurushët e saj. Ata thjesht shikuan njëri-tjetrin, buzëqeshën dhe vazhduan të luanin. Lepurusha i dëgjoi zërat e tyre duke qeshur dhe me shpejtësi, duke u kërcyer, pasi vetëm lepujt dinë të vrapojnë dhe të kërcejnë, vrapoi drejt tyre. Ajo i përqafoi butësisht dhe u tha: "Që tani e tutje ti do të quhesh Belço dhe do ti Gricko. Në këtë mënyrë do ta dini gjithmonë kur do t'ju thërras. Emrat do t'ju shërbejnë për t'ju dalluar nga lepurushët e tjerë, por edhe që të tjerët të dinë se kujt po i drejtohen. Lepurushët, të gëzuar pa masë me emrat e tyre, shkuan te shokët e tyre për t'u mburrur. Nga gëzimi harruan të hanin karotat e ëmbla që u kishte përgatitur nëna e tyre.

PËRMBAJTJA: ÇFARË MUND TË BËJ TANI DHE ÇFARË DO TË MUND TË BËJ NË TË ARDHMEN?

STANDARDET E VLERËSIMIT

Përkthyer atë që mund dhe di tani, çfarë ka mundur të dijë në të kaluarën dhe çfarë do të dëshironte të dinte në të ardhmen. Shpjegon se si fëmijët (përfshirë veten) gradualisht i zhvillojnë shkathtësitë dhe aftësitë e tyre. Në rrjedhën e jetës së tij e dallon të tashmen nga e kaluara dhe e ardhmja dhe njeh rëndësinë e organizimit të kohës. Emërton tipare pozitive tek vetja dhe i krahason ato me tipare pozitive tek të tjerët.

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Të menduarit, e tashmja, e kaluara, e ardhmja.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Shkencat natyrore, tema: **Njeriu dhe trupi i njeriut** (*Pjesët e trupit*); Gjuhë maqedonase, fusha: **Të dëgjuarit dhe të folurit** (*Kryerja e një bisede të shkurtër; Komunikimi joverbal*); Matematikë, tema: **Matja (Koha)**; Arsim figurativ, tema: **Vizatim** (*Vizatim i thjeshtë*) Edukim fizik dhe shëndetësor, tema: **Unë dhe trupi im** (*Si mund të lëviz me trupin tim?*) dhe Sporti dhe loja (*Alfabeti atletik*).

NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË E MËPARSHME DHE TË ARDHSHE



Përmbajtjen *Çfarë mund të bëj tani dhe çfarë do të mund të bëj në të ardhmen?* mësuesi e lidh me përvojën e mëparshme të nxënësve lidhur me gjërat që dinin/mundnin. Ai bazohet në njohuritë dhe aftësitë e fituara në kopshtin e fëmijëve ose në shtëpi. Bën pyetje ose jep aktivitete përmes të cilave do të kuptojë se në çfarë niveli nxënësi/nxënësja ka marrë njohuri apo aftësi të zotëruara më parë. Për shembull, duke demonstruar ilustrime, foto, video dhe duke folur për përmbajtjen, mësuesi do të fitojë njohuri për nivelin në të cilin nxënësit kanë zotëruar një shkathtësi ose njohuri. Kjo qasje ndaj njohurive të mëparshme të nxënësve i shërben mësuesit si bazë për realizimin e përmbajtjes. Njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e fituara nga kjo përmbajtje do të jenë bazë për përmirësimin e përmbajtjeve në lidhje me përcaktimin e kohës, orarit, pyetjeve dhe përgjigjeve, duke kuptuar se të gjitha njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë nuk kryhen nga aktiviteti fizik, duke kuptuar se për çdo sukses duhet investuar edhe në shprehjen kreative të nxënësve.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Oborri i shkollës, salla sportive, kornizë kohore e vizatuar, ilustrime me foshnje, nxënës, të rritur dhe të moshuar, shkurtesa me ngjyra.

Këshilla për mësimdhënësin

Aktivitetet hyrëse së pari fillojnë me atë që se çfarë fëmijët **mund** të bëjnë dhe më pas kalojnë në atë që **dinë** fëmijët. Shprehen gradualisht termat *mundem* dhe *di*, por nëse mësuesi vëren se nxënësit kanë vështirësi në dallimin e këtyre termave, nuk duhet të insistojë në të. Një qasje e tillë mundëson lëvizjen nga konkretja në abstrakte, pra respektimin e karakteristikave njohëse-zhvillimore të nxënësve.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITETI HYRËS - Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozimi 1. Nxënësit së bashku me mësuesin ndodhen jashtë klasës (janë në oborrin e shkollës ose në sallën e sportit). Secili prej tyre tregon se çfarë mund të bëjë një nga një (vrapim, zvarritje, kërcim, ngjitje në pajisje sportive, gjuajtje e topit dhe aktivitete të ngjashme fizike). Nxënësit e tjerë ndjekin demonstrimin e tij/saj dhe përpiqen ta imitojnë atë.

Propozimi 2. Nxënësit ndahen në dyshe dhe luajnë lojën: “Unë mundem, ti mundesh”. Një nxënës nga dyshja bën një deklaratë: *Unë mund të...* (vrapoj, vizatoj, kërcëj etj.), *ti mund të...* (ujisësh lulet, mbushësh gotën me ujë etj.). Nëse shoku i klasës së çiftit mund ta bëjë vërtet, ai merr një pikë. Nëse ai nuk e di se çfarë tha shoku i tij në deklaratë, pjesëmarrësi tjetër merr një pikë.

Propozim-pyetje. *Çfarë po bënit? (Nxënësit i numërojnë aktivitetet.) – Sa prej jush munden të... (kërcejnë, vrapojnë, zvarriten...)? – Cila ishte më e vështira për ju? – Përshkruani se si e keni bërë atë! – Cila është më e vështira nga ajo që keni regjistruar?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozimi 1. Në klasë, mësuesi demonstroi një aktivitet me pantomimë ose përshkrim verbal dhe nxënësit ia qëllojnë se për cilin aktivitet bëhet fjalë. Prononcohen nëse mund/dinë si ta bëjnë ose nëse nuk munden/nuk dinë.

Nxënësit i shprehin dëshirat e tyre, çfarë do të donin të mësonin në të ardhmen (mësuesi shpjegon termin *e ardhmja* me shembuj konkretë nga jeta e përditshme) dhe çfarë duhet të bëjnë për të mësuar.

Propozimi 2. Nxënësve u shfaqen katër ilustrime që tregojnë një foshnjë, një nxënës/nxënëse (5 deri në 6 vjeç), një të rritur dhe një plak/plakë. Emërtohen kategoritë e moshave. Nxënësit ndahen në katër grupe dhe secili grup duhet të numërojë se çfarë mund/di dhe nuk di/nuk di çdo pjesëtar i kategorive të moshës (për shembull: një foshnje mund të qajë, nuk di të lexojë; një nxënës di të lexojë, por nuk mund të vrapojë një maratonë). Diskutojnë pse disa nga gjërat e specifikura mund/dinë dhe disa nuk mund dhe nuk dinë t'i bëjnë ato.

Konstatohet se fëmijët rriten dhe zhvillohen dita-ditës, e me këtë edhe aftësitë, njohuritë, shkathtësitë e tyre.

Nxënësit i perceptojnë termat: *e kaluara*, *e tashmja* dhe *e ardhmja* përmes shembujve konkretë nga jeta e përditshme. Mësuesi mund të përdorë gjithashtu një kornizë kohore në të cilin janë shkruar termat: *foshnjë*, *nxënës*, *i rritur* dhe *i moshuar* dhe jepen shembuj përmes ilustrimeve të asaj që mund/dinë. Pasi nxënësit deklarojnë se çfarë do të donin të mësonin në të ardhmen, ata arrijnë në përfundimin se për të pasur sukses në diçka duhet të bëjnë përpjekje.

Propozim-pyetje. *Çfarë do të dëshironit të mësoni në të ardhmen? - Kush mund t'ju ndihmojë me këtë? - Si do ta ndihmonit shokun tuaj të mësonte diçka të re? - Çfarë duhet të bësh për të mësuar diçka? - Si mund të përmirësoheni në atë që dini/mund të bëni tani? – Për çfarë përdorni atë që tani e dini/mundeni dhe çfarë do të përdornit atë që do të mësoni në të ardhmen?*

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit vizatojnë atë që kanë mundur/ditur në të kaluarën, çfarë mund/dinë tani dhe çfarë do të jenë në gjendje/të dinë në të ardhmen. Ata diskutojnë se sa gjëra kanë ditur/mundur të bëjnë në të kaluarën dhe sa gjëra do të dinë/mund të bëjnë në të ardhmen. Përmes diskutimit ata arrijnë në përfundimin se fëmijët gradualisht i zhvillojnë shkathtësitë e tyre.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë që kanë bërë në klasë, si u ndjenë, çfarë mësuan, çfarë nga ajo që bënë sot do t'u ndihmojë në jetë.

Propozim-pyetje. *Krahasoni sa gjëra dinit dhe mund të bënit në të kaluarën dhe sa tani! - I mësuat ato gjëra menjëherë? - Sa kohë ju desh?*

PËRMBAJTJA: ÇFARË MË PËLQEN TE VETJA

STANDARDET E VLERËSIMIT

Emërton ditët e javës dhe identifikon se cila ditë i paraprin dhe pason. Zbaton saktë termat *dje*, *sot*, *nesër*. Përshkruan atë që ai/ajo ka mësuar të bëjë sot në krahasim me dje dhe javën e kaluar, dhe çfarë do të dëshironte të mësonte të bënte nesër dhe javën e ardhshme.



NOCIONET që duhet të përvetësohen

Ditët e javës, sot, dje, nesër.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Matematikë, lënda: **Matja (Koha)**; Gjuhë maqedonase, fusha: **Letërsi, shprehja dhe krijimtaria (Renditja e ngjarjeve në tekst)**; Shkencat e natyrës, tema: **Njeriu dhe trupi i njeriut (Kujdesi për shëndetin)**, Arsimi figurativ, tema: **Vizatim (Vizatim i thjeshtë)**.

NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË E MËPARSHME DHE TË ARDHSHME

Përmbajtjen *Çfarë më pëlqen te vetja?* mësuesi e lidh me përvojën e mëparshme të nxënësve me emërtimin dhe renditjen e ditëve të javës. Nëse mësuesi e kupton se nxënësit i kanë përvetësuar mirë këto nocione dhe identifikojnë se cila ditë i paraprin, ai kalon në një kontroll për t'u marrë me nocionet e kohës *dje, sot dhe nesër*. Njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e fituara nga kjo përmbajtje do të jenë bazë për ngritjen e kompetencave të nxënësve në lidhje me jetën ndërkulturore, ndjeshmërinë gjinore dhe përfshirjen e përmbajtjeve në vijim në këtë temë.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Ilustrime në të cilat janë paraqitur simbolikisht ditët e javës, poezia “Ditët” (shtojca 1), tregim “Java e Almiri”, kartonë me emrat e shkruar dhe simbolet e ditëve të javës.

Këshilla për mësimdhënësin

* Është më e vështirë për nxënësit në këtë periudhë zhvillimore të kuptojnë konceptin e kohës. Ata janë ende në fazën para-operative të zhvillimit kognitiv dhe ende e kanë të vështirë të bëjnë dallimin midis klasave (javë, si tërësi) dhe nënklasave (sot, dje, nesër, si nënklasa). Për këtë arsye, rekomandohet që futja e termave *dje, sot, nesër* të bëhet pasi ta kuptojnë javën në tërësi të përbërë nga pjesë (ditët e javës) që kanë orarin e tyre. E njëjta gjë vlen edhe për emrat e ditëve. Nëse mësuesi thjesht i rendit dhe kërkon që nxënësit t'i përsërisin si të dhëna faktike, nuk do të ketë efektin e dëshiruar. Prandaj mësuesi prezanton emrat e ditëve duke i lidhur me aktivitete të caktuara që zhvillohen ato ditë ose me ndonjë simbol vizuel (formë, ngjyrë) që do t'ua kujtojë nxënësve emrin e ditës së javës. Duke i lidhur aktivitetet karakteristike të çdo dite të javës me emrat e ditëve, nxënësit do të mund të përvetësojnë më lehtë termat *dje, sot, nesër*, por edhe të planifikojnë aktivitetet që duan të realizojnë gjatë javës dhe kështu ata e kuptojnë rëndësinë e planifikimit të kohës së tyre dhe se çdo ditë ndryshojnë, përparojnë dhe zhvillohen si individë.

* Duke zhvilluar këtë përmbajtje, mësuesi përdor aktivitete përmes të cilave nxënësit do të kuptojnë se dita-ditës po përparojnë gjithnjë e më shumë, se çdo sukses kërkon përpjekje dhe për të ndërtuar një imazh pozitiv për veten e tyre bazuar në aftësitë/njohuritë e fituara, por edhe për të bërë me dije rëndësinë e organizimit korrekt të kohës. Nëse nxënësit nuk mësojnë të thonë me rend e ditëve, në periudhën në vijim rekomandohet që mësuesi t'u kujtojë herë pas here duke përdorur një kalendar, duke u kujtuar orarin e orëve, duke i kujtuar një aktivitet që i ka paraprirë ose që do të vijë etj.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITETI HYRËS - Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozimi 1. Nxënësit dëgjojnë poezinë “Ditët” (shtojca 1) e lexuar nga mësuesi dhe u përgjigjen pyetjeve. Gjatë leximit mësuesi tregon ilustrime që lidhen me përmbajtjen e strofave. Ilustrimet duhet të mbeten të dukshme gjatë gjithë diskutimit të përmbajtjes së poezisë.

Propozimi 2. Nxënësit dëgjojnë tekstin “Java e Almiri” (shtojca 2) të lexuar nga mësuesi. Nëpërmjet tij njihen me aktivitetet e Almiri për çdo ditë të javës. Mësuesi përdor ilustrime që tregojnë ditët e javës dhe aktivitetet e Almiri. Nxënësit diskutojnë për përmbajtjen.

Propozim-pyetje. *Si quhen ditët e javës? – Renditni sipas radhës! - Cila ditë është e dyta me radhë? - Çfarë dite del Almiri për shëtitje me shokët e tij? - Cilat janë ditët e fundjavës?*



AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozimi 1. Nxënësit i thonë ditët e javës dhe më pas flasin për aktivitetet e tyre gjatë javës, duke i emërtuar ditët. Bëhet një ndarje e ditëve të punës dhe ditëve të fundjavës. Ditët e javës janë shënuar në një kornizë me ngjyra të ndryshme. Nxënësit duhet të përcaktojnë se çfarë dite është sot, çfarë dite ishte dje dhe çfarë dite do të jetë nesër dhe t'i ngjyrosin ditët në mënyrën e duhur. Në fushat bosh i vizatojnë aktivitetet që i kanë pasur dje, sot dhe që do t'i kenë nesër.

Propozimi 2. Nxënësit, të ndarë në grupe me nga shtatë nxënës secili, tërheqin karta në të cilat janë shkruar emrat e ditëve dhe ilustrohen aktivitetet e Almiri sipas ditës. Nxënësit e secilit grup rreshtohen sipas emrit të ditës që kanë vizatuar. Secili grup bën një deklaratë: *Almiri shkon në mësim muzike të hënën, dhe unë...* (plotëson atë që ai/ajo bën të hënën). Ai/ajo ndiqet nga nxënësi i grupit që ka nxjerrë një kartë me të martën etj. Në fund zgjidhet se cili grup ka më shumë aktivitete gjatë javës.

Në shiritin kohor janë shënuar ditët e javës me ngjyra të ndryshme. Nxënësit duhet të përcaktojnë se çfarë dite është sot, çfarë dite ishte dje dhe çfarë dite do të jetë nesër dhe t'i ngjyrosin ditët në mënyrë e duhur. Në fushat bosh vizatojnë aktivitetet që kanë pasur dje, sot dhe do të kenë nesër. Nxënësve më të shpejtë mund t'u jepet një tabelë për të plotësuar ditët e gjithë javës. Në fund, ata krahasojnë se cilat aktivitete i kanë të përbashkëta dhe në cilat ditë zhvillohen ato aktivitete.

Propozim-pyetje. Çfarë dite ishte dje/do të jetë nesër? - Çfarë keni bërë dje dhe çfarë do të bëni nesër? - Çfarë mundeni/dinit një/dy javë më parë, dhe çfarë tani? - Si e arritët këtë? - Çfarë të re dëshironi të mësoni javën e ardhshme? - Çfarë duhet të bësh për të mësuar diçka të re? - Pse disa gjëra mësohen më shpejt dhe disa gjëra më gjatë? - Çfarë do të ndodhë nëse nuk e organizoni kohën tuaj?

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit plotësojnë një shkallë emocionesh për të treguar se sa të kënaqur janë me atë që kanë mësuar këtë javë.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë që bënë në klasë, si u ndjenë, çfarë mësuën.

Propozim-pyetje. Si e vlerësoni atë që mësuat këtë javë në krahasim me javën e kaluar? - Çfarë mendoni, do të mësoni më pak apo më shumë javën e ardhshme se këtë javë?

SHTOJCË

DITËT

E hëna është e para,

i praparin javës së mbarë.

E marta e shqetësuar po ikën nga radha e saj,

për të kapur të gjitha tani.

E mërkura renditet e gëzuar në rreshtin e tretë,

ajo fluturon si një bletë.

E enjte nxiton e katërta,

për të takuar shoqet e saj.
E, e premtja, është e gjithë e buzëqeshur,
se ka zënë ditën e pestë.
E shtuna qëndron në vendin e saj,
një, dy, tre... shoqet e saj po i numëron.
Ja pra, edhe e diela nxori kokën,
u numërua, doli e shtata.
Shtatë ditët në numër,
e bëjnë shoqërimin e bukur.

Autore: Glikeria Ilioska (e përshtatur)

SHTOJCË

JAVA E ALMIRIT

Përsëritet! Unë jam Almiri dhe mësoj në klasën e parë. Unë kam shumë shokë e shoqe në shkollë. Unë shoqërohem me ta edhe kur nuk jemi në shkollë. Më pëlqen kur mbledhemi në park dhe luhatemi në luhatëse. Por më pëlqen gjithashtu kur hamë akullore së bashku dhe e ndajmë një sanduiç.

Një ditë mësuesja u tha mamit dhe babit se unë isha i talentuar në muzikë. Ata ranë dakord me të dhe më regjistruan në ore për muzikë. Kështu që çdo të **hënë** shkoj në orë muzike. Edhe këtu kam shokë dhe shoqe. Çdo të hënë luajmë të gjithë bashkë. Së shpejti do të kemi një koncert. Edhe koncerti do të jetë të hënë. Jam shumë i gëzuar!

Kur kthehem nga shkolla, më pret qenushi im Bruno. Sapo më sheh, fillon të tundë bishtin dhe të hidhet mbi mua. Kështu më përsëritet dhe më tregon se më do. Të gjithë kujdesemi për të në shtëpi. Secili prej nesh ka ditën e tij të javës kur duhet ta çojmë në shëtitje. Radha ime është të **martën**. Çdo të martë e çoj në parkun aty pranë për të vrapuar së bashku. Edhe qentë duan të vrapojnë, apo jo? Rrofshin të martat dhe Brunoja!

Pranë nesh jeton edhe gjysha ime. Çdo të **mërkurë** shkoj në shtëpinë e saj për ta ndihmuar me kopshtin. Ajo ka një kopsht shumë të bukur me lule të ndryshme. Unë jam përgjegjës për ujitjen e luleve në kopshtin e gjyshes çdo të mërkurë dhe ajo çdoherë më jep biskota të ëmbla, të pjekura. Hmmm, unë i dua të mërkurat dhe më pëlqejnë biskotat. Kështu që, ditën e mërkurë e kam të rezervuar për kopshtarinë dhe biskotat e gjyshes.

Hmmm, **e enjte**. E enjtja është dita ime e preferuar. Pastaj shkoj në pishinë dhe notoj. Po, po, e praktikoj edhe notin. Një ditë dua të kaloj me not liqenin e Ohrit. Dhe ndoshta La Manshin. Nuk e di se çfarë është

La Manshi, por babai im thotë që nëse ushtrohem fort çdo të enjte, do të jem një notar i famshëm dhe do të notoj këtë të ashtuquajtur La Mansh. Pra të enjten – not dhe La Mansh!

Çdo të **premtë** pasi kthehem nga shkolla vizatoj. Unë vizatoj gjithçka: lule, makina, shtëpi. Një herë kam vizatuar edhe autobus. Mami thotë se unë vizatoj mirë dhe më në fund ndalova së vizatuari kryeveprat e mia në muret e banesës. Nuk e di pse u zemërua kaq shumë kur vizatova diçka në mur. A nuk se duhet të praktikosh për të mësuar diçka? Dhe kështu tani çdo të premtë vizatoj në një bllok, dhe nëna është e lumtur. Pra, e premtja – vizatim.

Dhe po, pas të premtes vjen fundjava. Ditët e fundjavës janë e shtuna dhe e diela, ditët e mia më të preferuara. Pse? Tani do t'ju tregoj.

Të **shtunave** shkojmë në park me Milën, Janen dhe Sanelën për shëtitje. Ne flasim në ato shëtitje. Ne flasim për gjithçka që na intereson. Një të shtunë, Mila më pyeti se cila ishte dita ime e preferuar. "Të gjitha ditët janë të preferuarat e mia", i thashë. "Por e preferuara ime është e shtuna, sepse mund të shoqërohem me ty." Më pëlqen kur ecim, i shikojmë zogjtë, pemët, qiellin... Më pëlqen kur Jane tregon ndonjë barsoletë, më pëlqen të dëgjoj Sanelën kur ajo fillon të këndojë dhe më pëlqen kur Mila na tregon atë që ka mësuar në stërvitjen e futbollit. "Po, po, i dua të shtunat, dhe gjithashtu i dua shokët e shoqet e mia. Kështu, të shtunat e mia shoqërohen me shëtitje me shokët e shoqet e mia.

Dhe e **diela**, e diela është dita ime kur dalim apo shkojmë në një shëtitje me familjen. Kur moti është i ftohtë ose me shi, ne qëndrojmë në shtëpi. Atëherë luaj me Brunon ose shikoj TV. Dhe, mezi pres të kalojë e diela, sepse e di që pas të dielës vjen e hëna. Kurse të hënën do të shoh përsëri shokët dhe shoqet e mia në shkollë.

Ja pra, kështu kalon java ime. Më duket e këndshme dhe interesante çdo ditë e javës. Si po e kaloni Ju javën djema?

Autore: Glikeria Ilioska

PËRMBAJTJA: ÇFARË MË PËLQEN TE VETJA? (ME PUNË DREJT SUKSESIT)

STANDARDET E VLERËSIMIT

Shpjegon se si përpjekja kontribuon në përvetësimin e asaj që dikush di dhe çfarë mund të bëjë. Ai identifikon aktivitetet korruptive dhe e thekson anën negative të tyre.

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Tipar pozitiv.



INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Letërsia, shprehja dhe krijimtaria** (*Teksti letrar - fabula, Renditja e ngjarjeve në tekst*); Matematikë, tema: **Matja** (Gjatësia); Arsimi figurativ, tema: **Formësimi i plastikës** (*Gjuha e artit në formësimin plastik*); Edukatë fizike dhe shëndetësore, tema: **Sporti dhe loja** (*Alfabeti atletik*).

NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË E MËPARSHME DHE TË ARDHSHE

Përmbajtja *Çfarë më pëlqen te vetja?* (Me punë drejt suksesit) ndërlidhet me përvojat e mëparshme të nxënësve që ata kanë fituar në kopshtin e fëmijëve ose në shtëpi. Njohuritë e mëparshme të fabulës do ta bëjnë mësimin më komod. Standardet e vlerësimit që zbatohen në këtë orë në periodat vijuese të zhvillimit do të përfaqësojnë një bazë për miratimin e mëtejshëm të koncepteve korrupsion dhe rryshfet.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Teatër kukullash i realizuar nga mësuesi, figura ose ilustrime lepujsh, breshkë, kafshë pylli, karota, internet (link për të ndjekur fabulën: <https://www.youtube.com/watch?v=Z0GNXywyO0M>), fabula e përshtatur "Lepuri dhe breshka" (shtojcë).

Këshilla për mësimdhënësin

- * Rekomandohet që mësuesi të dijë paraprakisht nëse nxënësit e dinë këtë fabul. Nëse e dinë këtë, për të pasur më shumë kohë për mësim nga përvoja, mësuesi ka lirinë të vendosë nëse do të përdorë dramatizimin, shikimin e përmbajtjes video apo ritregimin gojor të fabulës nga nxënësit gjatë aktivizimit të njohurive të mëparshme.
- * Duke supozuar se nocionet korrupsion dhe rryshfet janë të panjohura për nxënësit, nuk rekomandohet emërtimi i këtyre fenomeneve, por vetëm perceptimi i mitos dhe rryshfetit dhe njohja e tyre si dukuri negative në shoqëri.
- * Në orët paraprake për aktivitete të lira mësuesi mund të planifikojë krijimin e një teatri kukullash, që përveç nevojave të kësaj ore do t'i shërbejë atij në realizimin e orëve të tjera. Krijimi i personazheve mund të kryhet në orën e lëndës **Arsim figurativ** gjatë realizimit të temës **Formësimi i plastikës** ose gjatë aktiviteteve të lira.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITETI HYRËS - Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozim-aktivitet. Nxënësit shikojnë videon e fabulës "Lepuri dhe breshka". Mësuesi ua prezanton të njëjtën me ndihmën e një teatri kukullash ose nxënësit e ritregojnë me ndihmën e ilustrimeve. Prezantohet versioni klasik i fabulës. Nxënësit diskutojnë për përmbajtjen e fabulës. Ata vërejnë që

breshka fitoi sepse ishte këmbëngulëse. Ata tregojnë shembuj kur arritën ndonjë sukses me këmbëngulje dhe përpjekje.

Propozim-pyetje. *Për çfarë po përgatiteshin lepuri dhe breshka? - Si shkoi gara? - Kush fitoi? - Pse fitoi breshka? - Pse lepuri e humbi garën? - Çfarë është pozitive dhe çfarë negative në fabul? - Çfarë bëni ti për të arritur diçka?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozim-aktivitet. Nxënësit e ndjekin dramatizimin e versionit të përshtatur (shtojcën) në të cilin breshka i ofron karota lepurit për ta lënë të fitojë.

Diskutojnë se në cilën përrallë veprimet e breshkës janë të sakta dhe cilat jo. Ata shohin se breshka donte të fitonte pa mundim, dhe lepuri donte të merrte karota pa mundim.

Nxënësit ndahen në dy grupe. Grupi i parë ("Lepujt") duhet të vendoset në pozicionin e lepurit, dhe grupi i dytë ("Breshkat") në pozicionin e breshkës. Nxënësit e grupit të parë bien dakord mes tyre se si do të veprojnë kur breshka t'u ofrojë karota, dhe nxënësit e grupit tjetër ("Breshkat") bien dakord se çfarë do të bëjë breshka për të fituar. Ata e realizojnë dramatizimin me një përfaqësues nga secili grup. Pasi kanë mbaruar dramatizimin, inicihet diskutim për veprimet e lepurit dhe breshkës.

Nxënësit arrijnë në përfundimin se çdo sukses kërkon përpjekje. Kur sukse arrihet me përpjekjet personale, atëherë ata do të ndihen më mirë. Ata renditin shembuj nga jeta e përditshme kur dikush arriti sukses pa përpjekje.

Propozim-pyetje. *Si do të ndiheshit nëse do të ishit në vendin e breshkës? - Çfarë do të bënit në vend të saj? - Çfarë do të bënit nëse do të ishit në vendin e lepurit? - Si do ta pranoni suksesin pa mundim? - Çfarë duhet të bësh për të pasur sukses në diçka? - Pse dikush dëshiron të arrijë diçka pa mundim?*

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit bëjnë supozimet e tyre se çfarë ndodhi më tej me lepurin dhe breshkën.

Nxënësit supozojnë se çfarë do të ndodhë nëse e pranojnë suksesin pa përpjekje.

Nëpërmjet teknikës Stuhi mendimesh, ata japin propozime se si mund t'i rezistojnë arritjes së suksesit pa përpjekje (aktivitete korruptive).

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që ndërlihen me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar. Për shembull: *Pse është e nevojshme të përpiqesh, të mësosh, të ushtrosh? - Çfarë do të arrini me mundin e dhënë? - Si do t'ju ndihmojë kjo në jetë?*

Propozim-pyetje. *Si e trajtuan breshkën dhe lepurin banorët e tjerë të pyllit kur morën vesh se breshka fitoi padrejtësisht dhe lepuri pranoi karotat? - Si ndihen njerëzit kur e dinë se dikush ka arritur sukses pa asnjë përpjekje? - Çfarë mund të ndodhë nëse e pranoi suksesin pa asnjë përpjekje? - Si do të rezistoni nëse dikush ju ofron diçka për të pasur sukses pa mundim?*

SHTOJCË

Version i adaptuar i fabulës "Lepuri dhe Breshka"

Në një pyll jetonte një lepur që konsiderohej vrapuesi më i shpejtë në pyll. Një ditë, duke vrapuar përgjatë shtegut të pyllit, ai hasi breshkën, e shtyu dhe vazhdoi të vraponte duke thënë: "Unë jam banori më i shpejtë i këtij pylli!" A ka ndonjë më shpejt se unë? A ka atje? Unë e sfidoj këdo që dëshiron të garojë me mua!" Duke iu afruar ngadalë, breshka i tha: "Po aplikoj për të garuar me ty." Të gjithë banorët e pyllit u mahnitën. Breshka e dinte se megjithëse lepur i ishte një mburravec, ai ishte përsëri një vrapues i mirë. Ajo gjithashtu e dinte se nëse ata do të garonin, ai do ta mundte atë. Por ajo e dinte gjithashtu se lepurushi ishte shumë i dhënë pas karotave dhe do të jepte gjithçka për disa karota. Kështu breshka hartoi një plan për ta mposhtur atë. Ajo shkoi në një kopsht aty pranë jashtë pyllit, zgjodhi pesë ose gjashtë karota dhe ia çoi lepurit.

"O lepurush, e di që do të më mundësh në garë, por le të bëjmë një marrëveshje si kjo: Unë do të të jap karotat dhe ti më lër të fitoj garën." Por askush nuk duhet të marrë vesh për këtë!", i tha breshka.

Pastaj lepurit i shkëlqyen sytë nga gëzimi që do të merrte karota pa mundim dhe do të mund t'i hante për një javë të tërë. Ai u pajtua dhe ranë dakord me breshkën që, kur të vijë dita e garës, ai do të ulet nën një pemë dhe të hajë një karotë, dhe ajo të lëvizë lirshëm drejt qëllimit.

Kështu ishte. Ditën e garës, breshka po i afrohej dalëngadalë vijës së finishit dhe lepur i nuk gjendej askund. Gara mbaroi, breshka fitoi dhe kafshët e pyllit nuk u besonin syve. Ata nuk mund të besonin se breshka, kafsha më e ngadaltë në pyll, kishte fituar lepurin.

Autore: Glikeria Ilioska

PËRMBAJTJA: SHOKËT DHE SHOQET E MIA

STANDARDET E VLERËSIMIT

I njeh dhe emërton karakteristikat e shokëve të mirë. I përshkruan veprimet që janë karakteristike për shoqërimin (në shkollë, në lagje). Thekson lojëra të ndryshme me shokët që kontribuojnë në forcimin e shoqërisë.

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Shok/shoqe, shoqëri.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Të dëgjuarit dhe të folurit** (*Komunikimi verbal dhe joverbal*); Arsim fizik dhe shëndetësor, tema: **Bëj sport dhe luaj** (*Lojëra në grup/lojëra lëvizëse*).

NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË E MËPARSHME DHE TË ARDHSHE

Njohuritë, aftësitë dhe aftësitë që nxënësit i kanë fituar në përmbajtjet e temës **Unë jam fëmijë** paraqesin bazë për realizimin e kësaj përmbajtjeje. Lidhja vertikale vijon edhe në periudhën e ardhshme me aktivitete për respektimin e rregullave të jetesës së përbashkët, mospranimin dhe rezistencën e sjelljeve të dhunshme (verbale dhe fizike), zhvillimin e empatisë, ndjeshmërisë gjinore, gjithëpërfshirjes, njohjes dhe mospranimit të stereotipave dhe paragjyimeve.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Fleta, ngjyra dylli ose druri në pesë ngjyra (dy palë), dhjetë guralecë të sheshtë (dy palë), hamer (të bardhë ose me ngjyrë).

Këshilla për mësimdhënësin

* Gjatë realizimit të kësaj përmbajtjeje, përpuni t'i bëni nxënësit të shprehin ndjenjat e tyre ndaj shokëve/shoqeve të tyre dhe të perceptojnë përfitimet pozitive të shoqërisë. Jepni shembuj konkretë dhe kërkojuni nxënësve të përshkruajnë shoqërinë përmes shembujve konkretë pozitivë.

* Jepni shembuj përmes të cilëve nxënësit do të njohin praninë e stereotipave dhe paragjyimeve tek vetja dhe tek të tjerët dhe do të kundërshtojnë diskriminimin.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozim-aktivitet. Nxënësit diskutojnë lojërat e përbashkëta që i luajnë dhe përshkruajnë disa nga lojërat. Ata shikojnë ilustrime dhe tregojnë situata që lidhen me shembuj pozitivë dhe negativë të sjelljes



ndaj shokëve/shoqeve të tyre. Ata mbajnë qëndrim se cili shembull i ilustrimeve tregon sjellje pozitive dhe cili shembull tregon sjellje negative. Ata përshkruajnë se si sillen ndaj shokëve të tyre në situata konkrete (çfarë bëjnë nëse njëri prej tyre bie/pengohet, nëse dikush tallet me një nga shokët e tyre, nëse shohin dikë duke përdorur dhunë verbale ose fizike, në çfarë mënyre u ndihmojnë shokëve me zhvillim specifik ...).



Propozim-pyetje.

-Çfarë lojërash luani me shokët tuaj?

- Cilën situatë nga ilustrimet e arsyetoni dhe cilën jo? - Pse nuk e arsyetoni? - Si do të ndiheshit nëse do të ishit në vendin e tij/saj? - Si e kuptoni që dikush është një shok i mirë?

- Trego shembuj të shoqërisë së mirë dhe shembuj të shoqërisë së keqe! - Si sillesh me shokun/shoqen tënde?

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozim-aktivitet. Nxënësit ndahen në dy grupe dhe ndërtojnë një kullë me guralecë (ose disa manipulime të tjera që keni në klasë). Nxënësit një nga një vendosin një guralec në kullën që duhet të ndërtohet në lartësi. Fiton grupi që ndërton kullën më të lartë me guralecë. Mësuesi u tregon nxënësve rregullat se kur bie kulla e një grupi, shokët e atij grupi nuk duhet të zemërohen ose të zihen me lojtarin të cilit i ra kulla, por të gjithë duhet ta përqafojnë dhe t'i thonë së bashku: "Ishe i mirë, herën tjetër do t'ia dalësh të ndërtosh kullën".



Propozim-pyetje. Si u ndje shoku i skuadrës të cilit i ra kulla?

- Në cilin rast ai nuk do të ndihet mirë - kur ju filloni ta qortoni dhe shani sepse nuk arriti të ndërtojë kullën apo kur e ngushëlloni?

- Pse duhet t'i mbështesim shokët tanë?

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit vizatojnë simbole në fletë letre përmes të cilave dërgojnë mesazh/e shokëve të tyre. Ata i ndjekin udhëzimet e mësuesit për kuptimin e simboleve. Për shembull: Unë të respektoj - lule, dua të të ndihmoj – pëllëmbë dore, jam i/e lumtur që je shoku/shoqja ime - tërfil, etj. Fletët e vizatuara i vendosin në një zarf dhe ua japin shokëve të tyre.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë. Për shembull: *Pse duhet të jesh shok mik i mirë? - Pse është e nevojshme të kesh shokë? - Si do të të ndihmojë kjo në jetë?*

Propozim-pyetje. *Si u ndje shoku juaj kur e mori dhuratën? - Dhe si u ndjeve? – Çfarë mund të bëni në të ardhmen për të bërë diçka të mirë për shokun tuaj? – Në çfarë mënyre mund të forcohet shoqëria?*

TEMA 2: UNË JAM NXËNËS

Rezultatet nga të mësuarit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. identifikojë veten si nxënës/e dhe e përjeton shkollën si mjedisin e tij/saj për mësim;
2. shpjegojë përgjegjësitë e mësuesve dhe nxënësve në procesin mësimor dhe rolin e shkollës si mjedis për të mësuar dhe shoqërim;
3. përshkruajë dhe aplikojë rregullat e sjelljes në klasë, shkollë dhe oborrin e shkollës që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e higjienës dhe sjelljes jo të dhunshme.

Nxënësi/nxënësja do të pranojë se:

4. shkolla është një vend ku mësojnë së bashku, shoqërohen dhe respektohen ndërmjet tyre fëmijë që janë të ndryshëm për shumë arsye (gjinia, përkatësia etnike, pamja fizike, aftësitë/mundësitë, statusi social).



PËRMBAJTJA: KLASA DHE SHKOLLA JONË (KLASA JONË)

STANDARDET E VLERËSIMIT

Përkshkruan organizimin hapësinor të klasës dhe e shpjegon klasën si një hapësirë e përbashkët për të gjithë nxënësit në klasë (përfshirë edhe veten tuaj).

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Klasa.



INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Të dëgjuarit dhe të folurit** (*Përshkrim*); Matematikë, tema: **Gjeometri** (*forma 3D*), **Punë me të dhëna** (*Mbledh, shfaq, interpreton dhe lexon të dhëna*), **Operacione me numra** (*Mbledhja dhe zbritja deri në 10/20*), **Matje** (*Gjatësia*); Arsim figurativ, tema: **Pikturimi** (*Mjetet dhe materialet bazë për pikturim*).

NDËLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË E MËPARSHME DHE TË ARDHSHME

Përvojat e mëparshme i referohen njohjes dhe emërimit të nxënësit dhe mjeteve dhe orendive të shkollës nga nxënësi, termat *klasë* dhe *paralele*. Njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë që nxënësit do të fitojnë me këtë përmbajtje do të shërbejnë si bazë për përmbajtjen përmes së cilës nxënësi do të kuptojë dhe pranojë se shkolla është një vend ku mësojnë së bashku, shoqërohen dhe respektojnë njëri-tjetrin fëmijët që janë të ndryshëm në disa baza (gjinia, përkatësia etnike, pamja fizike, aftësitë/mundësitë, statusi social).

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Mozaiku enigmatik i bërë online ose nga mësuesi, karta, fletë, flip chart, shumësia me ngjyra.

Këshilla për mësimdhënësin

* Gjatë realizimit të aktiviteteve të kësaj përmbajtjeje, mësuesi duhet të fokusohet në nxitjen e nxënësve për të kuptuar dhe përjetuar klasën si një vend ku ata mësojnë, eksplorojnë, shoqërohen, respektojnë njëri-tjetrin, i respektojnë mendimet e të tjerëve dhe pranojnë njëri-tjetrin, pavarësisht dallimeve ndërmjet tyre (gjinia dhe përkatësia etnike, moshë, aftësitë, statusi social etj.).

* Krijoni një mjedis mësimi ku nxënësit do të ndihen rahat, të dashur dhe të sigurt. Lërinë ata të sjellin në klasë lodrën e tyre të preferuar ose librin me figura. Flisni me ta se sa rëndësi kanë këto sende për ta. Përshtatni mobilet dhe disponueshmërinë e lëndëve shkollore sipas moshës dhe interesave të nxënësve. Siguroni mjete mësimore që janë mjaft bindëse për të nxitur kuriozitetin e nxënësve. Krijoni një mjedis në të cilin nxënësi do të dëshirojë të vijë përsëri dhe të kalojë kohën në mënyrë cilësore.

* Mozaiku enigmatik online mund të krijohet nga mësuesi me ndihmën e disa aplikacioneve të disponueshme dhe falas online, ndër të cilat më të lehtat për t'u punuar janë: <https://www.jigsawplanet.com>, <https://puzzel.org/jigsaw> dhe <https://learningapps.org>.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozimi 1. Nxënësit, të ndarë në dy grupe, bëjnë mozaikë (online ose të punuar nga mësuesi) që tregojnë sende nga shkolla ose mjete shkollore. Pasi kanë plotësuar mozaikët, emërtojnë objektet dhe thonë se cilit grup i përkasin.

Propozimi 2. Nxënësit ndahen në dy grupe. Grupi i parë zbulon në klasë objekte që i kanë edhe në shtëpinë e tyre dhe i dyti zbulon objekte që nuk janë në shtëpinë e tyre. Pason një diskutim rreth ngjashmërive dhe dallimeve midis klasës dhe shtëpisë së tyre.

Propozim-pyetje. *Si quhen objektet që i zbuluat në mozaik? - Si quhen objektet që i zbuluat në klasë? - Ku ndodhen? - Çfarë objektesh keni në shtëpi dhe në klasë? - Çfarë objektesh nuk keni? - Pse disa objekte nuk janë në shtëpi, por që janë në klasë?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozimi 1. Nxënësit e përshkruajnë klasën (madhësinë, ngjyrën e mureve, objektet që gjenden në klasë - materialet dhe mjetet mësimore, mjete pamore, manipulativat etj.). Ata i përshkruajnë këndet në klasë dhe shpjegojnë qëllimin e tyre. Prononcohen se cili kënd është më interesant, më i bukur, në cilin kënd ndihen më këndshëm. Ata diskutojnë se çfarë u pëlqen dhe çfarë do të ndryshonin në klasën e tyre. Nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve, nxënësit arrijnë në përfundimin se klasa është një vend për të mësuar dhe shoqëruar.

Propozimi 2. Nxënësit luajnë lojën "Vizitë tek...". Së bashku ata shkojnë nga cepi në cep në klasë. Aty mësuesi i pret në rolin e një këndi. Ai u shpjegon si quhet këndi, për çfarë përdoret dhe si duhet ta përdorin nxënësit. (Mësuesi flet në vetën e parë: "Unë jam këndi i shkencave natyrore. Këtu do të kryeni eksperimente në shkencat natyrore. Jam shumë i lumtur kur vini tek unë" etj.). Ata zbulojnë se cilat objekte nuk i përkasin një këndi të caktuar dhe i vendosin në këndin përkatës. Nxënësit diskutojnë se çfarë u pëlqen dhe çfarë do të ndryshonin në klasën e tyre. Nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve, nxënësit arrijnë në përfundimin se klasa është një vend për të mësuar dhe shoqëruar. Ata e ngjyrosin emotikonin (simbol - shprehja e emocioneve me figura) si ndihen në klasën e tyre.

Propozim-pyetje. *Për çfarë shërben këndi i matematikës? - Po këndi i gjuhës amtare? - Për çfarë shërbejnë objektet në to? - Si përdoren? - Si duhet t'i ruajmë këndet? - Cili kënd është më i bukur/interesant/i këndshëm për ju? - Çfarë tjetër do të dëshironit të kishit në klasën tuaj? - Për çfarë*

shërben klasa? - Kush janë shokët e tu të klasës? – Si shoqëroheni në klasë? - Çfarë bëni bashkë dhe çfarë bëni vetëm? - Si duhet të silleni me njëri-tjetrin?

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit vizatojnë në letra një simbol për shoqërinë, mësimin, shoqërimin. Propozimet e tyre i vendosin në tabelë ose në flip chart dhe zgjedhin simbole për t'u përshtatur në një simbol të përbashkët për klasën e tyre. Bien dakord për emrin, dhe më pas e vizatojnë dhe e ngjyrosin simbolin.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

Propozim-pyetje. *Çfarë është më e rëndësishme për klasën tonë? - Si do ta paraqitni atë me një simbol? - Çfarë përfaqëson simboli që keni vizatuar?*

Propozim për aktivitete të lira. Së bashku me nxënësit krijoni mjete pamore për të plotësuar këndet në klasë. Krijoni një bibliotekë klase dhe një kënd leximi që do ta mbushni vazhdimisht me libra të rinj, tekste shkollore, libra me figura, enciklopedi dhe revista për fëmijë.

PËRMBAJTJA: KLASA DHE SHKOLLA JONË

(KLASA JONË)

STANDARDET E VLERËSIMIT

E shpjegon rolin e shkollës si një mjedis për të mësuar dhe shoqëruar. E përshkruan rrugën ndërmjet klasës dhe oborrit të shkollës dhe ambienteve të tjera të rëndësishme në shkollë. I përcakton rregullat për ruajtjen e higjienës personale gjatë përdorimit të tualetit dhe ambientit të tryezës dhe për ruajtjen e higjienës në këto ambiente.

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Shkolla, oborri i shkollës, tualetet, zyra, biblioteka, tryeza.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Të dëgjuarit dhe të folurit** (*Përshkrimi*); Matematikë, tema: **Gjeometri** (*forma 3D*), **Punë me të dhëna** (*Mbledh, prezanton, interpreton dhe lexon të dhëna*); Arsimit figurativ, tema: **Pikturim** (*Mjetet dhe materialet bazë për pikturim*).

NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË E MËPARSHME DHE TË ARDHSHE

Përmbajtja lidhet me përvojat e mëparshme të nxënësit/nxënëses në lidhje me qëndrimin e tij/saj në kopsht dhe përmbajtjet e mëparshme të lëndës **Unë jam nxënës** dhe do të jetë bazë për përvetësimin e mëtejshëm të kompetencave të nxënësit në lidhje me jetën ndërkulturore, ndjeshmërinë gjinore dhe përfshirjen e përmbajtjeve që vijnë në këtë temë.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Aparat digjital, projektor, karta me ambiente të ilustruara në shkollë dhe simbole për ambientet, letër-hamer, shkumësa me ngjyra.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake



Propozimi 1. Përgatitja paraprake. Gjatë aktiviteteve të lira, nxënësit dhe mësuesi bëjnë një shëtitje në shkollë (ndërtesa, oborri i shkollës, salla e sportit, tryezë, biblioteka, tualetet, klasat) dhe me aparat digjital apo celular bëjnë fotografi të objekteve të përmendura dhe ambienteve. Emërtohen objektet dhe ambientet. Rekomandohet që mësuesi të filmojë drejtimin e lëvizjes nga klasa në tryezë, nga klasa në sallën e sportit, nga klasa në bibliotekë. Mësuesi bën një album fotografik të fotografive që do t'i përdorë për qëllimet e pjesës hyrëse të orës së mësimi, kurse videon do të përdorë në pjesën kryesore të mësimi.

Në orë. Nxënësit e ndjekin prezantimin e albumit fotografik me ambientet dhe objektet në shkollë. Identifikojnë një godinë shkolle, oborr shkolle, sallë sporti... I krahasojnë me një foto ose ilustrim të një shkolle tjetër dhe zbulojnë dallimet. Nxënësit i ndërlidhin ilustrimet përkatëse të ambienteve me emrin e ambientit në shkollë.

Propozimi 2. Nxënësit shikojnë një prezantim ku tregon shkollën e tyre (objektet e jashtme) dhe një shkollë tjetër. Ata i gjejnë dallimet dhe ngjashmëritë në pamjen e dy shkollave.

Propozim-pyetje. *Si duket shkolla jonë? - Çfarë dini për të? - Çfarë doni të dini për të? - Si dallon nga shkollat e tjera? - Cilat ambiente i keni të njohura? - Për çfarë shërben çdo ambient/hapësirë? - Kush mëson në klasat e tjera?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozimi 1. Nxënësit ndahen në dy grupe dhe dramatizojnë. Nxënësit e grupit të parë dramatizojnë se si duhet të sillen në tryezë (marrin ushqim, hanë, i hedhin mbeturinat në vendin e duhur dhe e kthejnë tabakanë), dhe ata të grupit të dytë dramatizojnë se si duhet të sillen në tualet (hyjnë, trokasin në derën e tualetit për të kontrolluar nëse është e lirë, e mbyllin derën e tualetit, lëshojnë ujin pas kryerjes së nevojës, lajnë duart me ujë dhe sapun). Secili grup ndjek dramatizimin e grupit tjetër. Pasi të kenë përfunduar, përmes diskutimit plotësojnë dhe korrigjojnë se cilat procedura kanë munguar ose cilat nuk janë kryer si duhet.

Nxënësit e ndjekin videon e incizuar nga mësuesi për lëvizjen nga klasa në objektet ose ambientet përkatëse dhe më pas përshkruajnë mënyrën duke përdorur termat *majtas, djathtas, përpara, mbrapa, ngjitje, zbritje nga shkallët* etj.

Propozimi 2. Nxënësit ndahen në të paktën tre grupe. Zbatohet metoda e mozaikut në të cilën nxënësit, brenda grupit nikoqir dhe të ekspertëve, hetojnë ambientet dhe objektet në shkollë (grupi 1), qëllimin e ambienteve në shkollë (grupi 2), sjelljen e duhur në tryezë, tualet dhe në bibliotekën e shkollës (grupi 3). Ata ua prezantojnë gjetjet e tyre shokëve të klasës dhe mësuesit. Ata diskutojnë dhe nxjerrin një përfundim se për çfarë shërben secila nga ambientet e përmendura dhe si duhet të sillen në to.

Propozim-pyetje. *Çfarë zbuluat për shkollën tonë? - Çfarë ju pëlqeu më shumë në shkollën tonë? - Si duhet të silleni kur jeni në tryezë? - Si duhet të silleni në tualet? - Trego çfarë duhet të bësh! - Cila është rruga që duhet të bëni nga klasa në tryezë/tualet/bibliotekë/zyrë? - Pse duhet të dish rrugën për në ato ambiente? - Ku duhet t'i drejtoheni nëse humbisni në shkollë?*

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit diskutojnë se si do të donin të dukej shkolla e tyre dhe si mund të arrihet kjo.

Rezyme. Shkolla është shtëpia jonë e dytë. Në të mësojmë, shoqërohemi, respektojmë njëri-tjetrin dhe rritemi së bashku. Ne punojmë së bashku për të arritur sukses më të madh.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në klasë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

Propozim-pyetje. *Kush mëson në shkollën ku jeni dhe kush në shkollën që e keni vizatuar? – Çfarë janë ata fëmijë? (Nxënës) – Si ndiheni në shkollën tuaj? - Çfarë do të doje të bëheshe/të ndodhte që të ndiheshe edhe më këndshëm?*

Propozim për aktivitete të lira. Mblidhni sendet e përdorura tashmë (gota plastike, shishe plastike, ambalazh kartoni etj.) Lërin nxënësit të ndërtojnë një model shkolle me sendet e mbledhura.

PËRMBAJTJA: KLASA DHE SHKOLLA JONË

(KUJDESI PËR HIGJENËN NË SHKOLLË DHE OBORRIN E SHKOLLËS)

STANDARDET E VLERËSIMIT

E shpjegon rolin e nxënësve në kujdesin për higjienën në shkollë dhe në oborrin e shkollës.

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Shkolla, oborri i shkollës, koshi i plehrave.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Letërsia, të shprehurit dhe krijimtaria** (Personazhi, koha, vendi në tekst); Shkencat e natyrës, tema: **Njeriu dhe trupi i njeriut** (Kujdesi për shëndetin); Matematikë, lënda: **Gjeometri** (Format - 3D) ose **Punë me të dhëna** (Mbledh, prezanton, interpreton dhe lexon të dhëna); Arsim figurativ, tema: **Pikturim** (Mjetet dhe materialet bazë për pikturim).

NDRËLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË E MËPARSHME DHE TË ARDHSHE

Njohuritë e fituara paraprake të nxënësve janë të lidhura me shprehitë higjienike që ata kanë fituar në shtëpinë e prindërve/kujdestarëve dhe në kopshtin e fëmijëve. Njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e fituara do të jenë bazë për zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të nxënësve për kujdesin dhe mirëmbajtjen e mjedisit dhe mjedisit ku ata jetojnë, për ekologjinë dhe për ndërgjegjësimin për rëndësinë e burimeve natyrore.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Teksti "E Pikëllueshmja dhe e Hareshmja - një histori për dy shkolla" (Shtojca), laptop, tablet, internet.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozimi 1. Nxënësit ndjekin tekstin "E Pikëllueshmja dhe e Hareshmja - një histori për dy shkolla" (shtojcë) i cili lexohet ose dramatizohet nga mësuesi. Kur lexon apo dramatizon, mësuesi nxjerr në pah ilustrimet e të dyja shkollave. Nxënësit drejtojnë një diskutim lidhur me përmbajtjen e asaj që dëgjuan.

Propozimi 2. Nxënësit dhe mësuesi janë në një xhiro në oborrin e shkollës dhe hollin e shkollës. Ata vërejnë se çfarë nuk u pëlqen dhe çfarë u pëlqen në oborrin e shkollës dhe hollin e shkollës.

Propozim-pyetje. Pse u quajt shkolla e parë E Pikëllueshmja? - Kush kontribuoi për t'u ndjerë kështu? - Pse shkolla e dytë quhej e Hareshmja? - Pse është ndjerë e gëzuar? - Kush është përgjegjës për higjienën



në shkollë? - Çfarë ju pëlqeu në oborrin e shkollës? - Çfarë nuk ju pëlqeu? - Çfarë mund të përmirësohet në pamjen e shkollës dhe të oborrit të shkollës? - Kush mund të kontribuojë për këtë?

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozim-aktivitet. Nxënësit shikojnë dhe shpjegojnë ilustrimet, duke i lidhur në të njëjtën kohë me sjelljen dhe shqetësimin e tyre për higjienën në shkollë dhe në oborrin e shkollës. Shtohen edhe shembuj të tjerë që kanë të bëjnë me kujdesin për higjienën në shkollë dhe në oborrin e shkollës.



Nxënësit japin shembuj se çfarë do të ndodhë nëse hyjnë në shkollë me këpucë të pista, nëse hedhin mbeturina kudo, nëse nuk i vendosin gjërat në vendin e tyre etj. Vëmendje e veçantë i kushtohet hedhjes dhe përzgjedhjes së mbetjeve në një kosh të përshtatshëm (nëse shkolla ka kosha për selektimin e mbetjeve).

Ata konkludojnë se nxënësit dhe punonjësit duhet të kujdesen për higjienën në shkollë dhe në oborrin e shkollës. Neglizhenca për ruajtjen e higjienës në shkollë dhe në oborrin e shkollës sjell mundësinë e infektimit, sëmundjeve, por edhe një reputacion të keq të shkollës, pra edhe të nxënësve që mësojnë aty.

Propozim-pyetje. Në çfarë mënyre mund të kontribuoni që shkolla jonë të duket bukur dhe e rregullt? - Si duhet të ruajmë higjienën në shkollë dhe në oborrin e shkollës? - Si mund të kontribuoni në përmirësimin e higjienës? - Pse duhet t'i kushtoni vëmendje higjienës në shkollë dhe në oborrin e shkollës?

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Me ndihmën e një ueb-mjeti, mësuesi krijon një kuiz për përzgjedhjen e saktë të mbetjeve. Duke tërhequr kartat, nxënësit duhet të selektojnë mbetjet në koshin përkatës të plehrave. Propozim për një aplikacion të tillë: <https://app.wizer.me>; <https://h5p.org>; <https://www.liveworksheets.com>.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në klasë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

Propozim-pyetje. *Çfarë lloj mbetjesh ka? - Në çfarë kosha selektohen? - Pse është i nevojshëm selektimi i mbetjeve? - Si mund të kontribuoni në mbrojtjen e mjedisit?*

Propozim për aktivitete të lira. Mblidhni letrën që keni përdorur tashmë një herë në klasë. Kryeni aktivitete të ripërdorimit të letrës së bashku me nxënësit. Bëni sende që mund t'i përdorni në klasën tuaj.

SHTOJCË

E Pikëllueshmja dhe e Hareshmja – NJË HISTORI PËR DY SHKOLLA

Në një qytet, dy shkolla jetonin pranë njëra-tjetrës. Jo se ishin shumë të afër, por mund të shiheshin dhe bisedonin me njëra-tjetrën matanë rrugës. Më së shumti flisnin kur errësohej dhe kur shuheshin zhurmat e fëmijëve. Dritat në klasa do të fiken dhe do të ndizet vetëm drita para hyrjes së shkollës. Ishte kohë kur ato i tregonin njëra-tjetrës ngjarjet që i kishin ndodhur gjatë ditës. Njëra shkollë ishte me tre kate dhe tjetra ishte më e ulët, por disi më e gëzuar. Shkolla më e lartë quhej “e Pikëllueshmja”. Pse e quanin kështu? Muret e saj ishin të skalitura me ngjyra të ndryshme, oborri i shkollës ishte plot me plehra, megjithëse në të ishin vendosur kosha. Pemët e mbjella nga disa nxënës janë thyer, kurse bari është shkelur. Shkolla ishte e pikëlluar dhe nuk qeshi kurrë. Nuk kishte hare. Ajo thjesht po ëndërronte se sa bukur ishte kur e ndërtauan. Sa të lumtur ishin fëmijët dhe të rriturit. Ajo ëndërronte të kthehej në atë kohë.

Megjithatë, ndryshe nga ajo, shkolla e ulët ishte gjithmonë e gëzuar dhe me gëzim i thoshte shoqes së saj: "Uaa, e Pikëllueshme, sikur ta shihje se çfarë ndodhi sot!" Maria, e njeh ti, vajza nga I-3, ishte marrë vesh me shokët dhe shoqet e saj që të mbillnin lule në oborr. Dhe, nga ana tjetër, Adnani dhe shokët dhe shoqet e tij mblodhën të gjitha mbeturinat rreth koshave në këndin e lojërave të shkollës. Por imagjinoni e Pikëllueshme, askush nuk ua tha këtë, ata u organizuan vetë dhe bënë një aksion mjedisor”.

"Ahhhh!" - psherëtiu e trishtuar e Pikëllueshmja. “Unë, e Hareshme, të them sinqerisht, uroj që një ditë ta bëjnë edhe nxënësit e mi. Por disi duket se ata janë më të interesuar të më gërvishtin, të shkelin barin, të shkatërrojnë lulet dhe të luftojnë njëri-tjetrin.”

E Pikëllueshme, kam një propozim!”, tha e Hareshmja. “Nesër kur të vijnë nxënësit, thuani ziles të mos bjerë! Thuaju rubinetave të mos rrjedhin ujë dhe thuaji shkumsave të mos shkruajnë në dërrasë të zezë! Shkruani një letër për të gjithë nxënësit se jeni një shkollë e pikëlluar se nuk ju kushtojnë vëmendje! Shkruani atyre që, në vend që të zihen dhe ngacmohen, të shoqërohen midis tyre dhe të respektojnë njëri-tjetrin!”.

Ashtu ndodhi. Të nesërmen kur nxënësit prisnin të binte zilja për orën e parë, zilja ishte e heshtur. Kur Igori shkoi në dërrasën e zezë për të zgjidhur detyrën, shkumësi nuk po shkruante. Kur Ema shkoi të lante duart, rubineti bëri vetëm një zhurmë gurgullimë. Të gjithë u habitën se çfarë po ndodhte. Pikërisht atëherë, kur Ema ishte gati të mprehte lapsin nën një karrige, vërejti një letër të shkruarë. E hapi dhe filloi ta lexonte me zë të lartë. Ja çfarë shkruhej në letër:

"Të dashur nxënës, unë jam shkolla juaj!" A e dini emrin tim? E Pikëllueshmja. Dhe pse më thërrasin kështu? Sepse jam e shkarratitur e gjitha me ngjyra të ndryshme. Sepse në oborr nuk ka lule dhe pemë për t'u gëzuar. Sepse çdo ditë dëgjoj fjalë të këqija, dëgjoj grindje dhe shoh zënka. Jo, nuk dua të jem E

Pikëllluara! Dua të jem si e Hareshmhja! Dua te keni kujdes ku i hidhni mbeturinat, dua qe klasat të kenë mobile të pastra dhe të qëndueshme, dua të ruhen të gjitha krijimet e juaja, dua që të përdorni më shpesh ujin dhe sapunin, dua të jem shkollë e pastër dhe e bukur! Të lutem, më ndihmoni të jem shkolla juaj e lumtur dhe të mos quhem më e Pikëllueshmja!”.

Pasi Ema e lexoi letrën, nxënësit filluan të mendojnë rreth kësaj. Meli u ngrit dhe u sugjeroi: “Shokë, le ta bëjmë edhe shkollën tonë krenare me ne”. Le të korrigjojmë sjelljen tonë. Të kujdesemi për higjienën dhe rregullimin”.

Kaloi një vit nga kjo ngjarje. E Pikëllueshmja nuk quhej më kështu, por quhej e Hareshmja numër 2. Dhe ishte gjithmonë e gëzuar dhe e buzëqeshur. E pse ndihej ashtu? Çfarë ndodhi që e ndryshoi emrin kështu?

Autore: Glikeria Ilioska (e përshtatur në shqip)

PËRMBAJTJA: KLASA DHE SHKOLLA JONË (SI SILLEM NË KLASË, SHKOLLË DHE OBORRIN E SHKOLLËS?)

STANDARDET E VLERËSIMIT

I përcakton rregullat e sjelljes në klasë, shkollë dhe oborr të shkollës (ndalimi i vrapimit në korridore/shkallë, përdorimi i fjalëve ofenduese, sjellje agresive ndaj shokëve të klasës) dhe mënyrat e respektimit të tyre.

Klasa, shkolla, oborri i shkollës.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Të dëgjuarit dhe të folurit** (*Ritregimi, tregimi, përshkrimi*); Arsimit figurativ, tema: **Pikturimi** (*Mjetet dhe materialet bazë për pikturim*); Matematikë, tema: **Punë me të dhëna** (*Mbledh, prezanton, interpreton dhe lexon të dhëna*).



NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË E MËPARSHME DHE TË ARDHSHME

Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë e fituara të nxënësit gjatë qëndrimit në kopshtin e fëmijëve dhe në shtëpinë e prindërve/kujdestarëve, ndërveprimi me bashkëmoshatarët dhe përmbajtjet e temës **Unë jam fëmijë** janë bazë për realizimin e kësaj përmbajtjeje. Aftësitë, njohuritë, shkathtësitë e fituara do të jenë bazë për realizimin e përmbajtjeve të Shoqërisë dhe Kulturës Demokratike dhe Zhvillimit Personal e Social në klasat më të larta.


MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Kartolina me shembuj të sjelljes së përshtatshme dhe të papërshtatshme, laptop, program prezantimi Microsoft Power Point, Open Office Impress, <https://sway.office.com>, <https://nearpod.com>, <https://www.thinglink.com>, <https://pasteapp.com...>), letër, shkurtesa me ngjyra

Këshilla për mësimdhënësin

* Gjatë realizimit të kësaj përmbajtjeje, fokusi i aktiviteteve duhet të synohet në respektimin e diversitetit, përvetësimin e kompetencave për ndjeshmërinë gjinore, zhvillimin e empatisë, ruajtjen e mjedisit jetësor, solidaritetin dhe kohezionin e grupit.

* Kjo përmbajtje mund të realizohet edhe nëpërmjet një prezantimi interaktiv në të cilin nxënësit marrin pjesë në mënyrë aktive duke parë kornika video, duke zgjidhur kuize, duke dhënë sugjerimet e tyre që mund të regjistrojnë si regjistrim audio ose duke zgjedhur ilustrime me karta kur japin shembuj të rregullave që duhen respektuar në klasë, në shkollë dhe në oborrin e shkollës. Një shembull i një aplikacioni të tillë është: <https://nearpod.com>, në të cilin në një tabelë kolaborative përmes teknikës së Stuhi mendimesh nxënësit analizojnë një ilustrim, vizatojnë ose regjistrojnë zërin e tyre në përgjigje të një pyetjeje. Më pas përgjigjet dëgjohen së bashku.



PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozim-aktivitet. Nxënësit ndjekin një prezantim të situatave të ndryshme nga jeta e përditshme shkollore në të cilat shfaqen sjellje të përshtatshme dhe të papërshtatshme (vrpim nëpër korridore,

shprehja e fjalëve ofenduese, dhunë verbale ose fizike, mosrespektim të pronësisë së përbashkët). Nxënësit i analizojnë situatat dhe përcaktojnë se cilat janë sjellje pozitive dhe cilat negative.

Propozim-pyetje. *Cilët nga shembujt e parë janë të përshtatshëm (të saktë) dhe cilët sjellje të papërshtatshme (të parregullta)? - Pse mendon kështu?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozim-aktivitet. Nxënësit ndahen në dy grupe dhe shikojnë dy grupe kartash që tregojnë shembuj të sjelljes së drejtë dhe jo të drejtë në klasë, shkollë dhe oborr të shkollës. Pasi i ndajnë dhe i grupojnë në tre grupe (sjellja e drejtë dhe e padrejtë në klasë, sjellja e drejtë dhe e padrejtë në shkollë dhe sjellja e saktë dhe e gabuar në oborrin e shkollës), secili grup prezanton para shokëve të klasës. Ata diskutojnë pse disa sjellje janë të përshtatshme dhe pse disa sjellje janë të papërshtatshme dhe si ndikojnë ato te nxënësit, mjedisi i shkollës dhe mjedisi i afërt. Secili grup zgjedh një shembull nga kartat e sjelljes së joadekuat (nga kartat e grupit të kundërt) dhe kryen një dramatizim. Grupi tjetër e ndjek dramatizimin dhe kur do të vërejë se po ndodh ndonjë sjellje e papërshtatshme bërtet **STOP**. Një përfaqësues nga grupi shpjegon pse sjellja është e papërshtatshme dhe si duhet të sillen drejt në rastin e treguar.

Propozim-pyetje. *Përshkruani kartat që tregojnë sjellje të papërshtatshme në klasë/shkollë/oborr shkollor! - Pse mendoni se ato sjellje janë të papërshtatshme? - Cilat janë pasojat e një sjelljeje të tillë? - Si do të ndihen fëmijët e paraqitur në ilustrime? - Cilat janë pasojat për mjedisin tonë? - Cilat janë pasojat për natyrën? - Çfarë duhet të bëni për të parandaluar sjelljen e papërshtatshme?*

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit japin sugjerime për rregullat në klasë, shkollë dhe oborr të shkollës, vizatojnë sjellje të papërshtatshme në fletë, i ngjyrosin dhe i rrethojnë me të kuqe. Ata nxënësit që dinë të shkruajnë mund t'i shkruajnë rregullat. Rregullat e krijuara në këtë mënyrë vendosen në të gjithë shkollën. Rregullat e sjelljes në klasë janë të afishuara në klasë në një vend të dukshëm.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

Propozim-pyetje. *Për kë janë dedikuar këto rregulla? - Si do t'i respektoni ata? - Çfarë do të ndodhë nëse nuk i respektoni? – A mund të shtoni edhe ndonjë rregull tjetër? - Ku duhet të respektohen këto rregulla përveç shkollës?*

Propozim-aktivitete gjatë kohës së aktiviteteve të lira. Gjatë aktiviteteve të lira, nxënësit mund të vëzhgojnë dhe të mbledhin të dhëna se cilat rregulla po shkelen në shkollën e tyre. Aktiviteti mund të integrohet me lëndën Matematikë, tema: **Punë me të dhëna** (Mbledh, prezanton, interpreton dhe lexon të dhëna).

PËRMBAJTJA: NE NXËNËSIT DHE MËSUESI/MËSUESJA JONË

STANDARDET E VLERËSIMIT

E përshkruan rolin e mësuesit/mësueses si një person përgjegjës për të ndihmuar nxënësit të mësojnë atë që kërkohet nga lëndët e ndryshme dhe të mësojnë gjëra të tjera që janë të rëndësishme për jetën në shkollë dhe më gjerë. E përshkruan rolin e nxënësve, duke përfshirë veten e tyre, si përgjegjës për të ndjekur udhëzimet e mësuesit se si dhe çfarë të mësojnë. E krahason përgjegjësinë e mësuesve dhe nxënësve – që mësuesit të përpiqen t'i mësojnë nxënësit dhe që nxënësit të përpiqen të mësojnë.

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Nxënës, nxënëse, mësues/mësuese, përgjegjësi.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Të dëgjuarit dhe të folurit** (*Ritregimi, tregimi dhe përshkrimi*); Arsimit figurativ, tema: **Vizatim** (*Vizatim i thjeshtë*).



NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË E MËPARSHME DHE TË ARDHSHE

Ata nxënës që kanë ndjekur kopsht janë të njohur me rolin dhe kuptimin e mësuesit dhe të nxënësve. Pjesa tjetër e nxënësve e perceptuan atë gjatë periudhës së kaluar shkollare. Njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e fituara do t'u mundësojnë atyre të përshtaten më lehtë në mjedisin shkollor, të kuptojnë rolin e tyre dhe rolin e mësuesit dhe do të jenë bazë për zhvillimin e mëtejshëm pozitiv të raportit mësues-nxënës, duke përfshirë edhe faktorin prind - si pjesë e pandashme e procesit edukativo-arsimor.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Foto ose video inserte të aktiviteteve të përbashkëta në klasë, karta me aktivitete të përbashkëta të paraqitura, fletë, shumës me ngjyra.

Këshilla për mësimdhënësin

* Gjatë realizimit të kësaj përmbajtjeje, mësuesi fokusohet në aktivitetet e përbashkëta, ndërveprimin e ndërsjellë (nxënës – mësues), respektimin dhe raportin mes nxënësve. Mësuesi nuk duhet të vendoset në një pozicion superior, por të vendoset si motivues, koordinator, mentor, bashkëpunëtor që do t'i drejtojë dhe ndihmojë nxënësit.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozim-aktivitet. **Përgatitja paraprake.** Mësuesi/mësuesja jonë përgatit një video ose prezantim me foto ose video inserte të aktiviteteve të përbashkëta me nxënësit që janë zhvilluar në periudhën e kaluar.



Në orë. Nxënësit diskutojnë se si u ndjenë duke i bërë ato aktivitete dhe me kë i bënë ato aktivitete. Nga kartat e ofruara ata zgjedhin se çfarë bëjnë së bashku me mësuesin/mësuesen e tyre.

Nëse ka aktivitete të tjera që kryejnë me mësuesin/mësuesen e tyre, nxënësit vizatojnë, shkruajnë ose plotësojnë me gojë. Përmes diskutimit, ata përshkruajnë se si ndihen kur janë në shkollë me mësuesin e tyre. Nxënësit vizatojnë

mësuesin/mësuesen e tyre në një fletë letre. Ata e përshkruajnë atë dhe thonë emrin e tij/saj. E tregojnë edhe profesionin e tij/saj. Ata përshkruajnë atë që dinë për profesionin e mësuesit.

Propozim-pyetje. *Çfarë bëmë herën e fundit? - Kush mori pjesë në ato aktivitete? - Kur ishte më interesante për ju? - Kur u ndjetë më të lumtur? - Si i kryenim aktivitetet, ushtrimet, lojërat? - Si e ndihmuat njëri-tjetrin? - Çfarë jam unë dhe çfarë je ti? (Përgjigja e pritshme: mësues/mësuese, nxënës) – Si duhet të sillemi me njëri-tjetrin?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozim-aktivitet. Nxënësit përshkruajnë se cili është roli i mësuesit nëpërmjet teknikës *Stuhi mendimesh*: secili nxënës thotë një fjalë që lidhet me rolin e mësuesit/mësueses. Të njëjtën procedurë e bëjnë edhe me rolin e nxënësit.

Nxënësit e vendosin veten në pozitën e mësuesit/mësueses përmes lojës me role. Për shembull, ata tregojnë se si punon mësuesi në një orë mësimi në shkollë, por mund të fusin edhe elemente me një situatë në të cilën nxënësi (në këtë rast mësuesi është nxënës) ka nevojë për ndihmë në zgjidhjen e një detyre, një problemi nga jeta e përditshme e nxënësve të kësaj moshe etj. Zhvillohet një diskutim se cili është roli i mësuesit dhe cili është roli i nxënësve.

Nëpërmjet diskutimit nxënësit i përcaktojnë detyrat e nxënësve dhe detyrat e mësuesit.

Arrihet në përfundimin se si mësuesit ashtu edhe nxënësit kanë përgjegjësitë e tyre, të cilat nëse respektohen do të kenë sukses në mësim dhe punë.

Propozim-pyetje. *Cili është roli i mësuesit/mësueses në shkollë/klasë? - Cilat janë përgjegjësitë e mësuesit/mësueses ndaj nxënësve? - Cilat janë përgjegjësitë e nxënësve? - Si i ndihmon mësuesi/mësuesja nxënësit? - Si bashkëpunojnë nxënësit me mësuesin/mësuesen? - Pse kjo është e nevojshme? - Çfarë arrihet me një bashkëpunim të tillë? - Çfarë arrihet duke respektuar përgjegjësitë? - Çfarë rregullash duhet të respektojmë kur punojmë së bashku?*

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit e vendosin veten në një rol të kundërt dhe e pyesin mësuesin/mësuesen se si ndihet kur është me ta. Ata propozojnë idetë e tyre sesi bashkëpunimi i ndërsjellë mund të jetë më i suksesshëm. Nxirret përfundimi se secili ka përgjegjësitë e veta që duhen respektuar. Mësuesi dhe nxënësit janë më të kënaqur kur respektojnë njëri-tjetrin, ndihmojnë njëri-tjetrin, respektojnë rregullat e sjelljes dhe respektojnë përgjegjësitë e tyre.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

Propozim-pyetje. *Çfarë mund të bëjmë tjetër që të jemi më të suksesshëm në punë?*

Propozim-aktivitet gjatë kohës së aktiviteteve të lira. Nxënësit le t’ju intervistojnë juve ose ndonjë mësues/mësuese tjetër rreth asaj si mund të bëhesh mësues/mësuese dhe çfarë profesioni tjetër do të kishin zgjedhur nëse nuk do të ishin mësues.

TEMA 3: SHTËPIA IME

Rezultatet nga të mësuarit

Nxënësi/nxënësjë do të jetë i/e aftë të:

1. identifikojë veten si anëtar i familjes/bashkësisë;
2. shpjegojë rolin dhe përgjegjësitë e fëmijëve dhe të rriturve në familje/bashkësi;
3. dallojë kohën e lirë nga koha e kushtuar obligimeve në shtëpi dhe shkollë.



PËRMBAJTJA: SHTËPIA DHE FAMILJA – KU JETOJ (SHTËPI, BANESË)?

STANDARDET E VLERËSIMIT

Përshkruan shtëpinë, identifikon ambientet në shtëpi dhe shpjegon se për çfarë përdoren ato.

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Shtëpi/banesë, ambiente në shtëpi, oborr.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Leximi dhe shkrimi fillestar** (*Fjalë, shkronjë, tingull*); Arsim figurativ, lënda: **Formësimi i plastikës** (*Bazat e gjuhës figurative në formësimin plastik*); Matematikë, tema: **Matja** (*Gjatësia, masa, vëllimi*); Shkencat e natyrës, tema: **Qeniet e gjalla** (*Kafshët*).



NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË E MËPARSHME DHE TË ARDHSHEME

Njohuritë e mëparshme të nxënësve të fituara në kopshtin e fëmijëve dhe qëndrimi i tyre në familje/shtëpinë e kujdestarit janë bazë për realizimin e kësaj përmbajtjeje. Nxënësit tashmë kanë marrë njohuri për mënyrat e banimit (banesë, shtëpi), kështu që kjo përmbajtje paraqet një zgjerim të njohurive të tyre dhe do të jetë bazë për lidhje transversale me tema të ngjashme nga shkencat shoqërore, si dhe me lëndë të tjera të klasave më të larta.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Kuti kartoni, sende klase të ripërdorshme, plastelinë, glimanol, laptop, internet, karta.

Këshilla për mësimdhënësin

* Gjatë realizimit të kësaj përmbajtjeje mësimore, mësuesi duhet t'i kushtojë vëmendje statusit social të nxënësve kur numërohen dhomat dhe orenditë në hapësirat e shtëpisë ku jetojnë nxënësit. Për këtë arsye, vëmendja e nxënësve duhet të përqendrohet më shumë në atë se për çfarë shërbejnë ambientet në shtëpi se sa mobilet në dhoma dhe nëse ata i kanë të gjitha ambientet në shtëpi.


* Nxënësve u shpjegohet se *shtëpia* është një shtëpi, banesë ose strehë tjetër që është vendbanimi i zakonshëm i një personi, familjeje ose amvisërie. Është vendi ku anëtarët e familjes jetojnë dhe kryejnë aktivitetet e tyre të përditshme. Shtëpia është një vend ku ata duhet të ndihen të mbrojtur dhe të dashur.

* Mësuesi mund të krijojë karta flash për të njohur mobilet dhe ambientet në shtëpi duke përdorur mjete online: <https://www.goconqr.com>, <https://www.cram.com/flashcards> ose karta flash të printueshme: <https://www.canva.com>. Në pjesën e përparme të kartës ai vendos një ilustrim të mobileve dhe në anën tjetër të kartës vendos një fotografi të ambienteve (hapësirave) në shtëpi. Nxënësit duhet të gjejnë se cilës dhomë të shtëpisë i referohet ilustrimi i mobileve. E njëjta gjë mund të lidhet edhe gjatë integritimit me lëndën e Gjuhës maqedonase (*Njohja e shkronjave dhe fjalëve*), duke vendosur një fjalë ose shkronjën fillestare të fjalës në anën e pasme të kartelës.

Shembull për flash kartë e përpiluar me ndihmën e mjetit online *Goconqr*:

Pyetje: Në cilën dhomë bën pjesë divani?

Përgjigje: Dhomën e ditës.



PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN¹⁰

Aktiviteti paraprak. Në orët e aktiviteteve të lira nxënësit dhe mësuesi bëjnë modelin e një shtëpie apo banese për kukulla duke vendosur ambiente dhe mobilet në dhoma. Shtëpinë dhe mobilet i bëjnë nga materiale që mund të ripërdoren (kuti kartoni, kuti plastike dhe kartoni, sfungjerë ose prej plastelinë ose glimanoli dhe të ngjyrosura me shkumësa etj.). Shtëpia e bërë në këtë mënyrë do t'u shërbejë atyre për të realizuar shumicën e përmbajtjeve të temës **Shtëpia ime**.



AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozimi 1. Nxënësit ndjekin tregimin që mësuesi ua lexon me zë (në shtojcë) dhe u përgjigjen pyetjeve që ai u bën. Ata diskutojnë se cilat janë karakteristikat e ndërtesave dhe banesave në ndërtesa dhe cilat janë karakteristikat e shtëpive. Ato ndahen në dy grupe: **BANESË** dhe **SHTËPI**. Nis një debat lidhur me pyetjen që mësuesi bën pasi lexon tekstin: *Ku është më mirë të jetosh - në banesë apo në një shtëpi?* Në debat, secili grup mbron qëndrimin e vet dhe shpjegon pse mendon kështu. Nxënësit kuptojnë se vendbanimet në ndërtesa (banesa) dhe shtëpitë me një emër quhen *shtëpi* dhe se nuk ka rëndësi se ku jetojnë, por është e rëndësishme të ndihen rehat dhe të dashur në shtëpi.

Propozimi 2. Nxënësit shikojnë ilustrimet e ndërtesave dhe shtëpive dhe përshkruajnë ndryshimin midis tyre. Mësuesi mund t'u tregojë gjithashtu një video të një pjese të caktuar të qytetit ku shihen shtëpi dhe ndërtesa. Nxënësit diskutojnë për veçoritë e ndërtesave dhe shtëpive. Ata kuptojnë se të banuarit në ndërtesa (banesa) dhe shtëpi në të cilat njerëzit jetojnë me një emër quhen *shtëpi*.

Propozim-pyetje. *Ku jetonte Mario dhe ku Merali? – Si dallojnë ndërtesat nga shtëpitë? - Çfarë është shtëpia?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozimi 1. Nxënësit luajnë me një shtëpi të bërë dhe kukulla të bëra. Tërheqin letra në të cilat shkruhet ose vizatohet se në cilën dhomë duhet ta vendosin kukullën dhe përshkruajnë hapësirën në të cilën e vendosën kukullën (mobilet, emrin e ambientit). Nxënësit e tjerë i plotësojnë përgjigjet e nxënësit që e vendos kukullën në ambientin e duhur.

Propozimi 2. Nxënësit ndjekin një demonstrim të ilustrimeve që tregojnë ambiente dhe për secilin ambient diskutojnë se për çfarë shërben, emërtojnë mobilet dhe diskutojnë se për çfarë përdoret ky ambient. Për këtë qëllim, mësuesi mund të përgatisë një prezantim që përfshin ambientet e shtëpisë dhe shpjegim për qëllimin e tyre.

¹⁰ Në pjesën **Shtojca** është dhënë shembull për realizimin e kësaj përmbajtjeje përmes aplikimit të metodës së të menduarit dizajnues.

Propozim-pyetje. Cilat ambiente në shtëpi mund të emërtoni? - Për çfarë shërben çdo hapësirë? - Çfarë lloj mobiljesh ka në çdo dhomë? - Ku ju pëlqen të qëndroni më shumë? - Pse? - Në cilën dhomë jeni më rehat?

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit i lidhin ilustrimet e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi me një pasqyrë të një shtëpie të ilustruar që tregon ambientet e shtëpisë.



Duke vepruar kështu, nxënësit diskutojnë se cilat aktivitete në cilat ambiente kryhen.

Si një aktivitet shtesë, ata mund të vizatojnë, shkruajnë ose të shprehen me shkrim se cilën dhomë do të shtonin në shtëpinë e tyre dhe pse. Cili do të ishte qëllimi i asaj hapësire?

Ata arrijnë në përfundimin se çdo ambient në shtëpi ka një qëllim dhe se shtëpia është një vend ku ata ndihen të sigurt dhe të dashur.

Propozim-pyetje. Cilin ambient do të dëshironit të shtonit në shtëpinë tuaj? - Për çfarë do të shërbente? - Çfarë lloj mobile do të kishit? - Si do të ndiheshit në të?

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

Aktivitet shtesë. Nxënësit luajnë lojë online në të cilën ata i rregullojnë ambientet në shtëpi me mobilet e nevojshme dhe përshkruajnë qëllimin e secilës dhomë. Një lojë e tillë online me rregulla të thjeshta dhe të kuptueshme mund ta gjeni në linkun: http://www.gamekidgame.com/mobile/home-decoration/home_decoration.html.

Mësuesi gjithashtu mund të përgatisë një prezantim interaktiv në formën e një loje në: <https://view.genial.ly> ose <https://www.thinglink.com>, në të cilin kur prekni pikat interaktive hapet një dritare që ilustron qëllimin e dhomës përkatëse në shtëpi:



Propozim për aktivitete të lira. Kjo përmbajtje mund të integrohet me përmbajtjen *Habitatet e kafshëve* nga lënda e Shkencave natyrore, ku nxënësit mund të krijojnë habitate për disa kafshë dhe të krahasojnë vendbanimet e njerëzve me habitatet e kafshëve.

SHTOJCË

SHTËPI APO BANESË?

Përsëndetje! Unë jam Mario dhe jetoj në qytet. Në qytet ka shumë ndërtesa dhe shtëpi. Unë jetoj në shtëpi, kurse shoqja ime Merali jeton në banesë. Banesa ndodhet në katin e shtatë të pallatit. Kur e vizitoj, marr ashensorin (por mund të shkoj edhe nëpër shkallë). Në këtë kat ka disa banesa. Në njërin prej tyre jeton edhe Merali. Çdo banesë ka numër. Ajo jeton në banesën numër 21. Ndërtesa është shumë e lartë dhe ndonjëherë kur unë dhe Merali shikojmë nga dritarja e banesës së saj, njerëzit duken të vegjël si milingona. Me Meralin shikojmë të luajmë në këndin e lojërave për fëmijë që ndodhet pranë ndërtesës. Ne luajmë rrallë në banesë, sepse nëse jemi të zhurmshëm, fqinjët mund të hidhërohen, sepse edhe atyre u duhet kohë për të pushuar.

Kur Merali vjen për të më vizituar, ne luajmë në oborrin tonë. Këtu nuk kam ambient lojërash për fëmijë me lëkundje, por kam kosh për basketboll, ndaj mund të luajmë basketboll.

Merali thotë se do të jetonte më mirë në një shtëpi dhe unë i them që më interesant për mua është të jetoj në banesë sepse do të mund ta shoh qytetin nga lart.

Ku dëshironi të jetoni Ju djema?

Autore: Glikeria Ilioska

PËRMBAJTJA: SHTËPIA DHE FAMILJA (ME KË JETOJ?)

STANDARDET E VLERËSIMIT

I numëron anëtarët e familjes së tij, pra anëtarët e komunitetit në të cilin jeton. Përshkruan marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve në familjen/komunitetin në të cilin jeton (prindër - fëmijë, kujdestarë - fëmijë, vëllezër - motra). Ai shpjegon diversitetin në familje (familje me një ose dy prindër dhe një ose më shumë fëmijë, me prindër që jetojnë të ndarë, familje të zgjeruara, familje kujdestare, familje përkujdesëse).



NOCIONET që duhet të përvetësohen

Familja, prindër, kujdestarë, fëmijë, nëna, babai, vëllai, motra, gjyshja, gjyshi, të afërmit.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Të dëgjuarit dhe të folurit** (*Ritregimi, tregimi dhe përshkrimi*); Shkencat e natyrës, tema: **Qeniet e gjalla** (*Karakteristikat e qenieve të gjalla*); Matematikë, tema: **Operacionet me numra** (*Mbledhja dhe zbritja deri në 20*); Arsim figurativ, tema: **Formësimi i plastikës** (*Materialet bazë*).

NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË PARAPRAKE DHE TË ARDHSHME

Njohuritë e mëparshme i referohen përvojës së fituar në kopsht dhe në shtëpinë e familjes/kujdestarit, ndërveprimet me mjedisin e afërt dhe do të përfaqësojnë bazën për përvetësimin e njohurive dhe qëndrimeve të nxënësit në lidhje me fushat Zhvillimi personal dhe social dhe Shoqëria dhe Kultura demokratike.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Një shpil letrash që ilustronjë njerëz të moshave dhe gjinive të ndryshme, zare, letra, shkumësa me ngjyra.

Këshilla për mësimdhënësin

* Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mënyrës se si do t'u shpjegohet nxënësve se ka familje kujdestare dhe familje që përbëhen nga fëmijë dhe edukatorë (familje kujdestare dhe shtëpi-familje). Nxënësve u duhet shpjeguar se në ato familje mbizotëron harmonia, dashuria, mirëkuptimi dhe respekti, por edhe në ato familje numri i anëtarëve ndryshon.

* Mësuesi duhet të dijë përbërjen e klasës dhe të jetë veçanërisht i kujdesshëm kur shtron pyetje në lidhje me emërtimin e anëtarëve të familjes së nxënësit (babai, nëna, vëllai, motra etj.), nëse në klasë ka fëmijë nga familje me një prind ose fëmijë pa prindër. Shmangni pyetjet e ndjeshme në lidhje me mungesën e një prindi ose një anëtari tjetër të familjes.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozimi 1. Nxënësit kanë dy zare dhe një shpil letrash në të cilat janë vizatuar personazhe të të gjitha moshave, të cilat duhet të përfaqësojnë anëtarët e familjes së ngushtë dhe të gjerë (babai, nëna, vajza, djali, gjyshi, gjyshja, teza, xhaxhai, halla, kushërinjtë, etj.). Secili nxënës hedh zarin dhe thotë numrin që i ka rra. Sipas atij numri, nxënësi duhet të krijojë një familje imagjinare. Numri i anëtarëve të familjes duhet të korrespondojë me numrin e fituar me hedhjen e zarit. Ai nga shpili nxjerr letra me anëtarë të familjes dhe formon një familje. Përshkruan familjen e formuar duke i renditur anëtarët. Për shembull, duke hedhur zarin, ai fiton 6. Ai merr 6 letra nga shpili (sipas zgjedhjes së tij) dhe i cakton një rol secilit personazh: babai, nëna, vëllai, xhaxhai, gjyshi, teza.

Propozimi 2. Nxënësit shikojnë fotografi ose ilustrime të familjeve. Ata rendisin anëtarët e familjes nga fotot ose ilustrimet dhe emërtojnë marrëdhëniet familjare (babai, nëna, gjyshja, gjyshi, djali, vajza etj.).

Propozim-pyetje. *Sa anëtarë keni numëruar në familje? - A ka dallim në numrin e anëtarëve? - Sa anëtarë ka familja juaj?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozim-aktivitet. Nxënësit shikojnë ilustrime që tregojnë lloje të ndryshme familjesh (familje me dy prindër, familje me një prind, familje kujdestare/përkujdesëse dhe familje në shtëpi në grup) dhe i emërtojnë ato sipas shpjegimit të mëparshëm të mësuesit për llojet e familjeve.

Me ndihmën e kartave, ata formojnë një familje më të ngushtë dhe një familje të gjerë. Ata emërtojnë të afërmit (babai, nëna, vëllai/vëllezërit, motra/motrat, gjyshja, gjyshi, teza etj.). Ata i thonë emrat e anëtarëve të familjes së tyre të ngushtë dhe më pas të familjes së tyre të gjerë. Ata diskutojnë kuptimin e harmonisë, mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë në familje.

Propozim-pyetje. *Cilët janë anëtarët e familjes me dy prindër, familjes me një prind dhe familjes kujdestare/përkujdesëse? - Cili është ndryshimi mes tyre? - Cilët anëtarë e përbëjnë familjen e ngushtë dhe cilët e përbëjnë familjen e gjerë? - Çfarë është më e rëndësishme të ekzistojë në familje? - Si ndiheni në familjen tuaj? - Kur ndiheni më rehat në familjen tuaj? - Çfarë mund të bëni për t'u ndjerë edhe më rehat?*

AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit vizatojnë familjen e tyre në një fletë letre dhe më pas i vendosin fletët në një grumbull. Secili nga nxënësit afrohet dhe zgjedh një vizatim. Tregon/ qëllon nëse vizatimi tregon një familje më të ngushtë apo më të gjerë, i numëron dhe përshkruan anëtarët. Qëllon familjen e kujt e përshkroi.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

Propozim-pyetje. *A janë të gjitha familjet njësoj? - Si ndryshojnë ato? - Çfarë është e përbashkët për të gjitha familjet?*

Propozim për aktivitete të lira. Së bashku me mësuesin nxënësit bëjnë kukulla të moshave dhe gjinive të ndryshme. Kukullat mund të bëhen nga qese letre, çorape të vjetra, letra të vjetra duke përdorur teknikën e formësimit etj. Kukullat e bëra do t'u shërbejnë atyre për të luajtur role gjatë realizimit të përmbajtjeve të lëndës Shoqëria, por edhe për lëndë të tjera mësimore.

PËRMBAJTJA: ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË SHTËPI (SI KUJDESIMI PËR SHTËPINË TONË?)

STANDARDET E VLERËSIMIT

I përmend dhe i shpjegon procedurat për ruajtjen e higjienës personale me përdorim të përgjegjshëm të ujit. Identifikon se ku hidhen mbeturinat shtëpiake. Ai shpjegon rolin e tij dhe rolin e anëtarëve të familjes në ruajtjen e higjienës në shtëpi. Diferencion punët dhe përgjegjësitë e të rriturve dhe fëmijëve në familje/shtëpi. Ai shpjegon se anëtarët e familjes meshkuj dhe femra janë njësoj përgjegjës për kujdesin e shtëpisë (mirëmbajtjen e higjienës, gatimin etj.).

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Kujdesi, të rritur, detyra, respekt, përgjegjësi, higjienë.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Lexim dhe shkrim fillestar** (*Shkrim fillestar*); Matematikë, tema: **Punë me të dhëna** (*Mbledh, prezanton, interpreton dhe lexon të dhëna*); Arsimit figurativ, tema **Pikturim** (*Pikturim dhe kolazh*).

NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË PARAPRAKE DHE TË ARDHSHME

Mjedisi i afërt dhe ndërveprimi me familjen dhe shokët dhe shoqet e nxënësit/nxënësës janë bazë për realizimin e kësaj përmbajtjeje. Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë e fituara nga kjo përmbajtje do të paraqesin bazë për ngritjen e mëtejshme të zhvillimit personal dhe social.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Objekte nga klasa, një shtëpi e bërë për kukulla, kukulla të bëra nga letra ose material tjetër, fletë, shkumësa me ngjyra, prezantim.

Këshilla për mësimdhënësin



* Mundohuni të nxirrni nga nxënësit sa më shumë shembuj të përgjegjësive që ata kanë në shtëpi. Theksoni rëndësinë e punëve të rregullta të shtëpisë dhe rëndësinë e ruajtjes së higjienës, shpërndarjes së detyrave, kursimit të ujit dhe energjisë elektrike, ruajtjes së duhur të mbeturinave, sjelljes së përgjegjshme ndaj kafshëve shtëpiake. Aplikoni shembuj shkak-pasojë për kryerjen e rregullt dhe të parregullt të detyrimeve.

* Nëpërmjet luajtjes së roleve në pjesën kryesore të mësimit, ju do të keni një pasqyrë të qartë në kuptimin e nxënësit/nxënëses për rolin e tij/saj në shtëpi dhe nëse ekzistojnë stereotipat gjinorë. Përpiquuni të ndërhyni duke dhënë shembuj të qartë dhe specifik se përse duhen shmangur stereotipat.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORË

Përgatitja paraprake. Mësuesi përgatit një skenë nga një mjedis shtëpie: dhomë ditore, kuzhinë, dhomë për fëmijë me ndihmën e mjeteve dhe objekteve që disponon në klasë. E njëjta gjë mund të përgatitet me ndihmën e shtëpisë së kukullave që kanë bërë për nevojat e përmbajtjeve të mëparshme.

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozim-aktivitet. Mësuesi prezanton ilustrime që tregojnë aktivitete të ndryshme në shtëpi të kryera nga fëmijët. Secili nxënës shënon në një fletë se sa nga aktivitetet e treguara kryen në shtëpinë e tij. Në fund nxënësit bëjnë një përmbledhje të numrit të përgjithshëm të aktiviteteve dhe nëse ka disa aktivitete që nuk janë prezantuar, i shtojnë ato.



Propozim-pyetje. *Cilat janë detyrat e tua në shtëpi? – Kur dhe si i kryen?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozimi 1. Nxënësit ndahen në dy grupe. Secili nga grupet duhet të përgatisë një dramatizim të përditshmërisë së familjes. Anëtarët e grupit marrin rolet e tyre dhe improvizojnë aktivitetet që zhvillohen në familje. Dramatizimi mund të kryhet edhe me ndihmën e shtëpisë së kukullave dhe kukullave të bëra. Nxënësit diskutojnë se cilët anëtarë të familjes kryejnë cilat detyra. Diskutohet stereotipizimi i roleve gjinore në shtëpi. Gjatë kryerjes së aktivitetit mësuesi i udhëzon nxënësit të tregojnë mënyrat se si e kursejnë energjinë elektrike dhe ujin dhe si i selektojnë mbetjet.



Propozimi 2. Nxënësit ndjekin një prezantim të përgatitur nga mësuesi që tregon skena të aktiviteteve të përditshme në shtëpi (ruajtja e higjienës në shtëpi, gatimi, hekurosja, shikimi i televizorit, ujitja e luleve,

lojëra të ndryshme, pazari, rregullimi i oborrit/kopshtit, kujdesi për kafshët shtëpiake, kryerja e riparimeve etj.). Diskutohet se çfarë bëjnë në shtëpinë e tyre dhe kush çfarë bën në shtëpinë e tyre. Diskutohet stereotipizimi i roleve gjinore në shtëpi.

Propozim-pyetje. *Cilat punë në shtëpi bëjnë të rriturit dhe cilat fëmijët? - Si ndryshojnë këto detyra? - Nëpërmjet cilave aktivitete ndihmoni në shtëpi? - Pse fëmijët nuk mund të bëjnë disa gjëra që mund të bëjnë të rriturit? - Çfarë punësh mund të bëni së bashku me të rriturit? - Çfarë pune të pëlqen të bësh? - A ka një ndarje të punës së burrave dhe grave? - Çfarë mund të bëni që të mos ketë një ndarje të tillë? - Çfarë do të ndodhë nëse familjarët nuk i respektojnë detyrimet e tyre?*

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitete. Nxënësit diskutojnë dhe japin sugjerime se cilat mënyra të tjera mund të kontribuojnë në rregullimin, higjienën dhe kursimin e ujit dhe energjisë elektrike në shtëpi.

Propozim-pyetje. *Në çfarë mënyre mund të kontribuoni për rregullin dhe higjienën në shtëpi? - Si mund të kontribuoni në kursimin e ujit dhe energjisë elektrike në shtëpi?*

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në klasë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.



Propozim për aktivitete të lira. Nxënësit vizatojnë një poster që tregon aktivitetet e tyre dhe aktivitetet e anëtarëve të familjes në shtëpinë e tyre. Posterit mund të plotësohet me shembuj që tregojnë mënyra për të kursyer ujin dhe energjinë elektrike.

PËRMBAJTJA: ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË SHTËPI (RESPEKTIMI I NDËRSJELLË NË SHTËPI)

STANDARDET E VLERËSIMIT

Dallon veprimet që kontribuojnë në respektin e ndërsjellë të anëtarëve të familjes/komunitetit dhe të jetuarit së bashku nga veprimet që e prishin atë.

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Kujdesi, të rritur, respekti.



INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Të dëgjuarit dhe të folurit** (*Ritregimi, tregimi dhe përshkrimi*); Arsimit figurativ, tema: **Pikturim** (*Pikturim dhe kolazh*); Arsimit muzikor, tema: **Këndojmë, luajmë dhe kërcejmë** (*Shprehja muzikore dhe krijimtaria*).

NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË PARAPRAKE DHE TË ARDHSHME

Përvojat e mëparshme në zgjidhjen e konflikteve dhe respektimi i mendimit të tjerëve paraqesin bazën për zhvillimin e aftësive që nxënësit duhet të fitojnë në këtë përmbajtje mësimore. Në klasat më të larta, nxënësit do të zhvillojnë shkathtësitë e tyre për zhvillim personal dhe social përmes përmbajtjes së integruar në edukimin për shkathtësitë e jetës dhe shoqërisë.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Kartonë të gjelbër dhe të kuq për çdo nxënë, ilustrime me situata të paraqitura problemore nga jeta familjare.

Këshilla për mësimdhënësin

* Fëmijët në këtë periudhë zhvillimi e kanë më të vështirë të pranojnë koncepte abstrakte, siç është termi konflikt, ndaj rekomandohet përdorimi i termave të përafërta dhe të njohura për ta.

* Shkathtësitë sociale janë thelbësore që një fëmijë të ndërveprojë me të tjerët. Në këtë periudhë zhvillimi, fëmija është në gjendje të zbatojë strategji të përshtatshme, si p.sh., zgjidhja e konflikteve duke gjetur një zgjidhje që do të jetë e pranueshme nga të dyja palët. Është gjithashtu shumë e rëndësishme që fëmijët të zhvillojnë "empatinë" (të njohin ndjenjat e të tjerëve), gjë që do t'i lejojë ata të tregojnë mirëkuptim dhe qëndrim të kujdesshëm ndaj moshatarëve dhe të rriturve. Duke qenë se fëmija gjatë kësaj periudhe zhvillon vetëkontroll dhe di të përmbahet gjatë një bisede, mësuesi duhet t'i përdorë këto të dhëna për të zhvilluar aftësinë e fëmijës për të negociuar kundrejt kundërshtimit, respektimin e mendimit të tjerëve kundrejt preferimit të mendimit të vet.

* Gjithmonë theksojini nxënësve që të dëgjojnë dhe analizojnë pikëpamjet e të tjerëve dhe t'i trajtojnë ata me respekt, edhe kur ata nuk janë dakord.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozim-aktivitet. Mësuesi shkruan në dyshtemenë e klasës numrin 6. Nxënësit e rrethojnë numrin dhe diskutojnë se cilin numër shohin. Disa nxënës pritet të thonë se është numri 6 dhe disa se është numri 9. Ata bien dakord së bashku se cilin numër e shohin.

Propozim-pyetje. *Pse nuk mund të përcaktonit se cilin numër po shihnit? - Si e gjete zgjidhjen?*



AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozim-aktivitet. Nxënësit ndahen në dy grupe dhe brenda grupeve përpiqen të hartojnë tregime për situatat e shfaqura. Ata diskutojnë se çfarë çoi në shkaktimin e situatave të paraqitura dhe si mund të zgjidhet problemi.



Grupet i prezantojnë përgjigjet dhe zgjidhjet e tyre për problemet. Diskutohet nëse ka ndonjë zgjidhje tjetër për problemet. Pasi janë ezauruar përgjigjet e grupeve, mësuesi i shpalos ilustrimet ku është treguar zgjidhja e problemeve:



Nxënësit e kuptojnë se problemi është zgjidhur pasi familjarët kanë rënë dakord mes tyre dhe kanë gjetur një zgjidhje të përbashkët dhe të dyja palët kanë mbetur të kënaqur. Këtë e arritën duke respektuar mendimin e tjetrit.

Nxënësit tregojnë shembuj nga jeta e përditshme se si e kanë zgjidhur një problem, duke respektuar mendimin e tjetrit dhe me ndihmën e marrëveshjes reciproke.

Propozim-pyetje. *Përshkruani arsyen e situatave të tilla të pakëndshme! - Si lindi konflikti? - Si ndihen pjesëmarrësit në situata? - Si mund të zgjidhen situata të tilla? - Cila është zgjidhja? - Pse është e rëndësishme të pajtoheni me njëri-tjetrin? - Si do të ndihen pjesëmarrësit pas zgjidhjes së situatës? - Çfarë është më e rëndësishme në zgjidhjen e situatave të tilla? - Si ndryshe do të tregosh respekt për tjetrin?*

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit ndahen në dy grupe. Secili grup ka për detyrë të zgjidhë një situatë problemore nga jeta familjare që mësuesi ia ka vendosur më parë. Pasi bien dakord për zgjidhjen, secili grup prezanton, kurse anëtarët e grupit tjetër duke përdorur teknikën Semafor (duke ngritur një karton të kuq për **JO** dhe një karton të gjelbër për **PO**) japin përgjigje kthyesë nëse zgjidhja është e saktë apo jo. Ata diskutojnë se si i kanë zgjidhur situatat problemore dhe sugjerojnë mënyra të tjera për ta zgjidhur problemin.



Propozim-pyetje. *Si e keni zgjidhur problemin? – Çfarë erdhët në konkluzion, çfarë **NUK** duhet të aplikoni kur zgjidhni situata problemore? - Në çfarë mënyrash të tjera mund të zgjidhen situatat nga ky shembull?*

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

PËRMBAJTJA: AKTIVITETE BRENDA DITËS (NJË DITË ME FAMILJEN TIME)

STANDEDET E VLERËSIMIT

Thekson aktivitetet e anëtarëve të familjes/komunitetit gjatë ditës, duke përfshirë edhe aktivitetet personale.

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Mëngjes, gjatë ditës, në mbrëmje, gjatë natës.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Letërsia, shprehja dhe krijimtaria** (*Radhitja e ngjarjeve në tekst*); Matematikë, tema: **Punë me të dhëna** (*Mbledh, prezanton, interpreton dhe lexon të dhëna*), **Matja** (*Koha*); Arsim figurativ, tema: **Pikturim** (*Pikturim dhe kolazh*).



NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË PARAPRAKE DHE TË ARDHSHME

Nxënësit i kanë marrë njohuritë e mëparshme për aktivitetet, orarin e aktiviteteve dhe pjesët e ditës nga rrethi i përditshëm. Kjo përmbajtje paraqet zgjerim të njohurive të fituara tashmë, dhe është një bazë për zhvillimin e shprehive dhe shkathtësive për planifikimin e kohës, marrjen e njohurive për nevojën për aktivitete të planifikuara dhe efektive.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Tabelë e vizatuar e aktiviteteve, ngjitëse/spikerë për aktivitetet e vizatuara, model shtëpie kukullash, kukulla që përfaqësojnë gruan, burrin, djalin, vajzën, teksti "Dita e Anës".

Këshilla për mësimdhënësin

* Gjatë realizimit të kësaj përmbajtjeje, kushtojini vëmendje faktit që nxënësi, përveç aktiviteteve të tij gjatë ditës, të numërojë dhe përshkruajë edhe aktivitetet e anëtarëve të familjes/komunitetit. Në këtë mënyrë ai do të marrë një pasqyrë më globale për rëndësinë e planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve, por edhe marrjen e përgjegjësisë për punët në familje dhe komunitetin e gjerë.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

Përgatitja paraprake. Nxënësit shënojnë aktivitete në familjen/komunitetin e tyre që janë kryer një ditë më parë (vizatojnë ose përpilojnë fjali). Për këtë mund të shërbejnë edhe kartelat që mësuesi i ka përgatitur dhe dhënë më parë dhe në të cilat paraqiten aktivitete të ndryshme. Në shtëpi nxënësit i ndajnë kartat me aktivitetet që kanë kryer.

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozim-aktivitet. Nxënësit i "lexojnë" shënimet e tyre për atë që kanë bërë një ditë më parë dhe diskutojnë se cilat aktivitete janë të ndryshme dhe cilat janë të njëjta ose të ngjashme me shokët e tjerë të klasës. Në tabelë, me ndihmën e Diagramit të Venit, prezantohen kartat me aktivitetet e nxënësve. Pastaj i krahasojnë aktivitetet që i kanë pasur të njëjta.



Propozim-pyetje. *Çfarë bëtë ditën e djeshme? - Cilat aktivitete janë të ngjashme me ju dhe cilat janë të ndryshme? - Në cilën pjesë të ditës i keni kryer ato aktivitete?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozimi 1. Nxënësit e ndjekin tekstin “Dita e Anës” (shtojcë) që lexon mësuesi. Gjatë leximit të tekstit, mësuesi paraqet një ilustrim ose prezantim që tregon aktivitetet e Anës dhe familjes së saj gjatë ditës. Gjatë leximit mësuesi u parashtron nxënësve pyetje nëse bëjnë të njëjtën gjë si Ana. Nxënësit duke ngritur letrat lart (të kuqe për **JO** dhe të gjelbër për **PO**) japin përgjigje kthyesë. Fillon një diskutim rreth asaj se si e kaloi ditën Ana dhe më pas secili nxënës/nxënësë prononcohet se si e kalon dita e tij/saj dhe cilat aktivitete janë të njëjta ose të ngjashme dhe cilat janë të ndryshme nga aktivitetet e Anës. Gjatë leximit dhe prezantimit mësuesi përmend termat *mëngjes*, *ditë*, *mbrëmje* dhe *natë*. Nëse disa nxënës kanë vështirësi në dallimin e këtyre termave, mësuesi përdor shembuj praktikë për të shpjeguar termat.



Nxënësit i ngjyrosin kartat e ofruara me ngjyrën e duhur që i përgjigjet mëngjesit, ditës, mbrëmjes dhe natës dhe përcaktojnë se cilat aktivitete në cilat pjesë të ditës i kryejnë.

Propozimi 2. Me ndihmën e shtëpisë së kukullave dhe kukullave të bëra, nxënësit realizojnë një dramatizim të aktiviteteve që kanë gjatë ditës. Për këtë, përveç shtëpizës, mësuesi duhet të ketë përgatitur një model ose objekte që do të përfaqësojnë shkollën, vendin e punës, këndin e lojërave etj.

Nxënësit i ngjyrosin kartat e ofruara me ngjyrën e duhur që i përgjigjet mëngjesit, ditës, mbrëmjes dhe natës dhe përcaktojnë se cilat aktivitete në cilat pjesë të ditës i kryejnë.

Propozim-pyetje. *Cilat aktivitete në ditën tuaj janë të ngjashme me aktivitetet e Anës dhe cilat janë të ndryshme? - Përshkruani se si po ju shkon dita juaj për ju dhe familjen/komunitetin tuaj! - Përshkruani se si do ta planifikoni ditën tuaj! - Pse duhet ta planifikojmë ditën? - Çfarë do të ndodhte nëse nuk i përmbushim detyrimet tona gjatë ditës? - Cilat janë aktivitetet tuaja të preferuara? - Cilat aktivitete do të përjashtoni nga orari ditor? - Pse? - Cila pjesë e ditës është më e këndshme për ju?*

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit plotësojnë një tabelë të dhënë me të dhëna se çfarë aktiviteti dhe sa herë në ditë kryejnë. Për shembull: i lajnë dhëmbët në mëngjes, pas çdo vakti, në mbrëmje para se të shkojnë në shtrat; hanë në mëngjes, në drekë, hanë meze dhe darkë etj. Ata diskutojnë se çfarë aktiviteti bëjnë më shpesh, pse është dhe çfarë aktiviteti i ndihmon ata të ndihen mirë.

					ВКУПНО
					5
					4
					2
					1
					1
					1
					1



Propozim-pyetje. Çfarë aktiviteti bëni më shpesh? - Cilin aktivitet do t'i shtonit orarit ditor?

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

Propozim për aktivitete të lira. Nxënësit vizatojnë një strup "Dita ime" ose "Si e imagjinoj ditën time ideale".

SHTOJCË

DITA E ANËS

Unë quhem Ana dhe mësoj në klasën e parë. Familja ime përbëhet nga babai, nëna ime dhe motra ime e madhe. Dita ime fillon në orën 7 të mëngjesit. Në atë moment zgjohem, e rregulloj shtratin, i rregulloj pizhamet dhe i lë mënjane që t'i gjej lehtësisht dhe t'i vesh natën. Pasi vishem, shkoj në banjë, i laj dhëmbët me pastë dhëmbësh, e laj fytyrën dhe kreh flokët. Unë i bëj të gjitha vetë. Babai dhe nëna ime shkojnë në punë dhe unë jam gati të shkoj në shkollë.

(Pyetje nga mësuesi: A ngrihesh edhe ti në orën 7 të mëngjesit? - A e rregullon shtratin si Ana? - A i rregullon pizhamet si Ana? - A lahesh, lan dhëmbët dhe kreh flokët ashtu siç bën Ana?)

Shkoj në shkollë me shokët e mi Matejin dhe Sarën. Ne ecim me kujdes në trotuar së bashku dhe gjithmonë kemi kujdes të semafori.

(Pyetje nga mësuesi: *A shkoni në këmbë edhe ju në shkollë? – Nëse jo, kush dhe me çfarë ju çon? – A ecni nëpër trotuar nëse ecni në këmbë?*)

Mbërrijmë në shkollë dhe këtu takojmë nxënësit e tjerë dhe mësuesen tonë. Ne ndjekim me kujdes mësuesen dhe jemi aktivë në klasë. Unë shkoj direkt në shtëpi nga shkolla në mënyrë që prindërit e mi të mos shqetësohen se pse jam vonuar.

(Pyetje nga mësuesi: *Çfarë bëni në shkollë? – Ku shkoni pasi mbarojnë mësimet?*)

Kur kthehem në shtëpi, unë dhe motra ime hamë diçka të lehtë dhe më pas bëjmë detyrat e shtëpisë, mësojmë dhe përgatitemi për obligimet e shkollës të ditës së nesërme. Pastaj mami dhe babi vijnë nga puna dhe ulemi për të ngrënë drekë.

(Pyetje nga mësuesi: *A i bëni detyrat e shtëpisë kur Ana i bën? – A është koha juaj e drekës e njëjtë me kohën e drekës së Anës?*)

Pasdite së bashku me motrën vizatojmë, luajmë lojëra, lexojmë ose rrimë me shoqet tona. Në mbrëmje darkojmë bashkë me babin dhe mamin dhe më pas shikojmë televizor. Ngadalë po vjen koha kur më duhet të shtrihem për të fjetur.

(Pyetje nga mësuesi: *Si po kalon pasditja juaj? – A i bëni të njëjtat gjëra si Ana?*)

Para se të shkoj në shtrat, përgatis çantën e shkollës, përgatis rrobat për shkollë, e shtroj shtratin për të fjetur, vesh pizhamet, shkoj në tualet, lahem dhe i laj dhëmbët. Natën shkoj në shtrat më herët dhe fle gjithë natën sepse duhet të jem e freskët dhe e pushuar për ditën tjetër.

(Pyetje nga mësuesi: *A e bën gati edhe ti çantën e shkollës dhe rrobat për shkollë si Ana? – A mendon edhe ti njësoj si Ana: duhet të shkosh në shtrat më herët që të jesh i freskët dhe i pushuar për ditën tjetër?*)

Autore: Glikeria Ilioska

TEMA 4: VENDI NË TË CILIN JETOJ


Rezultatet nga të mësuarit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. emërtoje dhe përshkruajë vendin (qytet/fshat) ku jeton, të emërtojë shtetin dhe të njoh flamurin shtetëror;
2. përshkruajë se për çfarë shërbejnë dyqanet/arketet, tregu, ambulanca/spitali/Ndihma e parë, farmacia, Policia, Shërbimi i zjarrfikësve dhe t'i theksojë profesionet që ndërlidhen me to;
3. respektojë rregullat themelore të trafikut për lëvizje të lirë në trafik.

Nxënësi/nxënësja do të:

4. ndërgjegjësohet për përkatësinë ndaj shtetit të vet.



PËRMBAJTJA: QYTETI/FSHATI DHE SHTETI IM – KU JETOJ (QYTET/FSHAT, SHTET)?

STANDARDET E VLERËSIMIT

Emërton dhe përshkruan vendin ku jeton (qytet/fshat), emërton shtetin dhe njeh flamurin e tij.

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Fshat, qytet, shtet, flamur.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Të dëgjuarit dhe të folurit** (*Grupimi i fjalëve*); Art figurativ, tema: **Vizatim** (*Vizatim i thjeshtë*).



NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË PARAPRAKE DHE TË ARDHSHME

Nxënësi/nxënësja tashmë ka një ide për termat fshat dhe qytet. Kjo është baza për zgjerimin e njohurive për mënyrën se si funksionon qyteti dhe si funksionon fshati dhe aftësia për të krahasuar qytetin dhe fshatin. Pritet që nxënësi/nxënësja të ketë vështirësi në vizualizimin e termit shtet, por në këtë rast mjafton të dihet se vendi ku ai jeton është në vendin tonë të përbashkët që quhet Republika e Maqedonisë së Veriut. Njohuritë dhe aftësitë e fituara do të jenë bazë për ndërtimin e identitetit të tij kombëtar si qytetar i vendit tonë.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Internet, laptop, letra (shtojcë), karta me terma të shkruar QYTET dhe FSHAT ose qytet dhe fshat vizatuar (numri i kartave që përfaqësojnë fshat duhet të jetë më i madh se numri i kartave që përfaqësojnë qytet), flamuri i Republikës së Maqedonisë së Veriut, shkumësa me ngjyra.

Këshilla për mësimdhënësin

- * Kur realizoni këtë përmbajtje, filloni me shembuj konkretë të pamjes së fshatit/qytetit, objekteve që ndodhen aty, profesioneve që janë në fshat/qytet dhe lidhjes/varësisë së qytetit nga fshati dhe fshatit nga qyteti.
- * Filloni me shembuj që përshkruajnë vendbanimin e nxënësit, më pas bëni një krahasim me qytetet/fshatrat e tjerë.
- * Kur demonstoni hartën mece të vendit tonë, mos u kërkon nxënësve të përshkruajnë kufijtë, por shpjegoni se sipërfaqja brenda vijës së vizatuar është, në fakt, vendi ynë, por e zvogëluar shumë herë.
- * Mos u përpiqni të bëni paraqitjen e hartave të qytetit dhe fshatit (në pjesën kryesore të mësimit, propozimi 2) në hartën e mece të korrespondojë me paraqitjen e qyteteve dhe fshatrave në hartën gjeografike. Mjafton që nxënësit të perceptojnë se ka më shumë fshatra se qytete dhe se ato përfaqësojnë fshatrat dhe qytetet që ndodhen në vendin tonë. Tregojuni atyre se ka fshatra dhe qytete të tjera në botë.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

Përgatitja paraprake e mësimeve për pjesën hyrëse 1. Në aplikacionin: <https://www.jigsawplanet.com> mësimeve përgatitë dy mozaikë, njërin me ilustrimin e qytetit dhe tjetrën me ilustrimin e fshatit.

Përgatitja paraprake e mësimeve për pjesën hyrëse 2. Mësimeve përgatit një kuiz me asociacione në aplikacion: <https://wordwall.net> (në seksionin *image quiz*), në të cilin nxënësit zbulojnë fillimisht ilustrimin që tregon një qytet dhe më pas ilustrimin që tregon një fshat.

Përgatitja paraprake e mësimeve për pjesën kryesore të orës. Mësimeve vizaton një hartë mece të Republikës së Maqedonisë së Veriut në një fletë të madhe letre. Përgatit letra në të cilat ka shkruar fjalët **FSHAT** dhe **QYTET** ose ka vizatuar një fshat dhe një qytet.

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozimi 1. Nxënësit ndahen në dy grupe. Grupi i parë zbulon mozaikun me një ilustrim të një qyteti dhe grupi i dytë zbulon mozaikun me një ilustrim të një fshati.

Propozimi 2. Nxënësit e zgjidhin asociacionin dhe zbulojnë fotografitë e qytetit dhe të fshatit.

Nxënësit diskutojnë çfarë kanë zbuluar, nëse kanë qenë ndonjëherë në një qytet/fshat dhe përshkruajnë qytetin dhe fshatin.



Propozim-pyetje. Çfarë zbuluat në fotografi? - Si duket qyteti, dhe si duket fshati?

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozimi 1. Nxënësit diskutojnë ngjashmëritë midis qytetit dhe fshatit dhe më pas ndryshimet midis qytetit dhe fshatit. Ata perceptojnë se qyteti është një vendbanim i madh, dhe fshati është një vendbanim më i vogël. Ata emërtojnë vendbanimin e tyre (a është qytet/fshat dhe emri i qytetit/fshati), e përshkruajnë dhe e krahasojnë me ilustrimet. Ata numërojnë çfarë ka në fshat dhe çfarë jo në qytet dhe anasjelltas. Ata i klasifikojnë kartat në dy grupe: **Qytet** dhe **Fshat** (shtojcë). Mësuesi mund të printojë kartat ose t'i ngarkojë ato në një aplikacion online në formën e një kuizi me lidhje.

Propozimi 2. Nxënësit ndahen në dy grupe. Grupi i parë përshkruan qytetin, dhe i dyti fshatin. Grupi i parë i rendit kartat në të cilat është shkruar (ose vizatuar) **QYTETI** në hartën memece. E njëjta procedurë kryhet nga grupi i dytë. Ata emërtojnë vendbanimin e tyre (a është qytet/fshat dhe emri i qytetit/fshati), e përshkruajnë dhe e krahasojnë me ilustrimet.

Nxënësit vërejnë se edhe qytetet dhe fshatrat ndodhen në të njëjtin vend. Ky është vendi ynë, i cili quhet Republika e Maqedonisë së Veriut. Çdo vend ka flamurin e tij, kështu që edhe vendi ynë ka flamurin e tij. Nxënësit përshkruajnë flamurin që u tregon mësuesi.



Propozim-pyetje. *Cilat janë ngjashmëritë dhe cilat janë ndryshimet midis qytetit dhe fshatit? - Si lidhen qyteti dhe fshati? - Si quhet qyteti/fshati ku jetoni? - Përshkruani qytetin/fshatin në të cilin jetoni! - Si quhet vendi ku jetoni? - Përshkruani flamurin e Republikës së Maqedonisë së Veriut!*

Aktivitet shtesë për nxënësit. Imagjinoni që jeni një udhërrëfyes turistik! Si do ta përshkruani vendbanimin tuaj për turistët?





AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit e përshkruajnë flamurin e vendit tonë, e identifikojnë midis dy deri në tre flamuj të vendeve të tjera dhe më pas e ngjyrosin. Ata e dëgjojnë himnin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe diskutojnë se ku e kanë dëgjuar dhe në cilat raste këndohet himni.

Propozim-pyetje. *Si u ndjetë derisa e ngjyrosnit flamurin dhe dëgjonit himnin kombëtar?*

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

SHTOJCË



PËRMBAJTJA: LUAJ I SIGURT DHE ORIENTOHEM NË HAPËSIRË

STANDARDET E VLERËSIMIT

Njeh dhe përshkruan vendet e sigurta për të luajtur (shesh lojërash, park, oborr...). Dallon vend të sigurt nga të pasigurt për të luajtur dhe lëvizur. Është i orientuar në hapësirë: majtas/djathtas dhe përpara/prapa.

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Shesh lojërash, orientimi, majtas/djathtas, përpara/prapa, siguria, rregullat.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Matematikë, tema: **Punë me të dhëna** (*Mbledh, prezanton, interpreton dhe lexon të dhëna*), **Gjeometri** (*Vendndodhja, lëvizja dhe drejtimi*); Arsimit figurativ, tema: **Formësimi i plastikës** (*Materialet/mjetet bazë për formësimin e plastikës*).



NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË PARAPRAKE DHE TË ARDHSHME

Nxënësit tashmë kanë njohuri të mëparshme të marra në kopsht dhe në shtëpinë e familjes se ku dhe si duhet të lëvizin dhe të luajnë në mënyrë rregullt dhe të sigurt. Kjo përmbajtje do të synojë në konkretizimin e vendeve të sigurta dhe të pasigurta për të lëvizur dhe luajtur duke u fokusuar në pasojat e përzgjedhjes së një vendi të pasigurt për të luajtur. Njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e fituara do të jenë bazë për zhvillimin e mëtejshëm të zhvillimit personal dhe social, me qëllim parashikimin e pasojave të veprimeve të veta dhe të veprimeve të të tjerëve për veten dhe për të tjerët.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Maketë e këndit të lojërave e bërë nga kartoni, kuti dhe materiale të tjera, kartonë të kuq dhe të gjelbër për çdo nxënës, prezantim i bërë nga mësuesi.

Këshilla për mësime

* Gjatë realizimit të kësaj përmbajtjeje mësimore, çdoherë theksoni lidhje shkak-pasojë për nevojën për një vend të sigurt për të luajtur. Jepni shembuj konkretë se ku dhe pse duhet zgjedhur një vend i sigurt për të luajtur. Rendisni oborrin e shtëpisë/ndërtesën/shkollën dhe këndin e lojërave për fëmijë si shembuj të vendeve të sigurta për të luajtur. Analizoni me nxënësit detajet e secilit shesh lojërash - nëse është i sigurt apo jo.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

Përgatitja paraprake. Gjatë aktiviteteve të ira mësuesi dhe nxënësit bëjnë një maketë të këndit të lojërave për fëmijë në të cilën në anën e djathtë ka rrugë, kurse në anën e majtë një parking automobilash. Ata gjithashtu bëjnë kukulla letre.

Në orën e mëparshme mësuesi i udhëzon nxënësit të vizatojnë ose të shkruajnë vendet ku kanë luajtur gjatë javës.

AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozimi 1. Nxënësit i paraqesin rezultatet e vëzhgimit dhe diskutojnë se ku kanë luajtur gjatë javës. I regjistrojnë rezultatet në formën e një tabele dhe shohin se cili është vendi më i zakonshëm për të luajtur.

Propozimi 2. Nxënësit e ndjekin prezantimin që mësuesi paraprakisht e ka përgatitur dhe diskutojnë rreth asaj se cilat janë vendet e tyre për lojë në krahasim me ato fotografi të paraqitura në prezantim.

Propozim-pyetje. *Në cilat vende luani? - Cilat janë vendet tuaja të zakonshme për të luajtur?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozim-aktivitet. Nxënësit e përdorin maketën e këndit të lojërave për të treguar se çfarë është në të djathtë dhe çfarë në anën e majtë të këndit të lojërave. Me ndihmën e kartonëve të kuq, ata shënojnë se cilat vende nuk janë të sigurt për të luajtur brenda dhe rreth këndit të lojërave. Ata diskutojnë pse ato vende nuk janë të sigurt. Ata gjithashtu numërojnë vende të tjera që nuk janë të sigurt për të luajtur dhe lëvizur dhe shpjegojnë pse ato vende nuk janë të sigurt. Ata numërojnë vendet që janë të sigurt për të luajtur dhe shpjegojnë pse ato vende janë të sigurt.

Propozim-pyetje. *Cilat vende për të luajtur janë të sigurt? - Pse janë të sigurt? - Cilat vende nuk janë të sigurt për të luajtur dhe për të lëvizur? - Pse nuk janë të sigurt? - Çfarë mund të ndodhë nëse luajmë dhe lëvizim në vende të pasigurt? - Përshkruani se si duket një vend i sigurt dhe si duket një vendi i pasigurt për të luajtur dhe lëvizur!*

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Nxënësit ndahen në dy grupe. Çdo nxënës nga grupet ka një karton të kuq dhe një të gjelbër. Mësuesi tregon një vend për të luajtur (për shembull, një rrugë) dhe nxënësit ngritin kartonin e kuq ose gjelbër, sipas asaj nëse mendojnë se rruga është një vend i sigurt ose i pasigurt për të luajtur. Ata i shkruajnë rezultatet për secilin grup në një tabelë. Fiton grupi me rezultatet më të sakta. Nxënësit diskutojnë se çfarë duhet të keni kujdes kur zgjedhin një vend për të luajtur.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

Propozim-pyetje. *Numëroni vendet e sigurt për të luajtur dhe lëvizur! - Çfarë duhet t'i kushtoni më shumë vëmendje kur zgjidhni një vend për të luajtur?*

PËRMBAJTJA: UNË LËVIZ I SIGURT DHE MARRË PJESE NË TRAFIK (SHENJAT E TRAFIKUT DHE SEMAFORI)

STANDARDET E VLERËSIMIT

Njeh shenjat bazë të trafikut dhe semaforët.

Nacionet që duhet të përvetësohen

Semafori (shenjat e trafikut).

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Matematikë, tema: **Gjeometri (2D-forma dhe 3D-forma)**; Arsim figurativ, tema: **Formësimi i plastikës (Materialet/mjetet bazë për formësimin e plastikës)**.



NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË PARAPRAKE DHE TË ARDHSHME

Nxënësit që kanë ndjekur kopshtin tashmë janë njohur me kuptimin e semaforëve. Kjo përmbajtje paraqet një thellim të njohurive dhe shkathtësive tashmë të fituara, si dhe do të paraqesë bazë për ngritjen e temave të kulturës së trafikut në periudhat vijuese të zhvillimit të nxënësve.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME

Modele semaforësh të bërë për këmbësorë, semafor për shoferë dhe shenja bazë të trafikut, kukulla letre, kryqëzim i improvizuar. Link në video në lidhje me kuptimin e semaforit: <https://www.youtube.com/watch?v=OB6cZh5uub8&t=4s>.

Këshilla për mësimdhënësin

* Gjithmonë theksoni sigurinë e nxënësve si këmbësorë në trafik. Nëse keni kushte, përmbajtjen mësimore mund ta kryeni jashtë klasës me ushtrime për kalimin e rrugës në një test komunikacioni në oborrin e shkollës.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

Përgatitje paraprake. Në orën e Arsimit Figurativ, gjatë përpunimit të përmbajtjes nga tema: **Formësimi i plastikës**, mësuesi dhe nxënësit krijojnë një semafor për këmbësorët dhe një semafor për drejtuesit e automjeteve, shenjat bazë të trafikut dhe një model të një kryqëzimi që do të shërbejë si ndihmë pamore gjatë përpunimit të përmbajtjeve për lëndën Shoqëria që kanë të bëjë me trafikun dhe sigurinë në komunikacion.

Përgatitja paraprake e nxënësve. Nxënësit në kushte shtëpie ndjekin video-mësimin që mësuesi e ngarkon në Platformën Kombëtare të Mësimin në Distançë dhe u përgjigjen pyetjeve që lidhen me mësimin. Një mësim i tillë i mësimin në shtëpi është baza për metodën e **Klasës së përmbysur**.

AKTIVITET HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozim-aktivitet. Nxënësit ua qëllojnë gjëgjëzave rreth semaforëve dhe shenjave të trafikut. Ato përshkruajnë pamjen e semaforëve dhe shenjave bazë të trafikut.

Propozim-pyetje. *Si duket semafori? - Sa drita ka? - Çfarë ngjyre kanë semaforët? - Si duken shenjat e trafikut? - Çfarë forme dhe ngjyre kanë?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozim-aktivitet. Nxënësit ndjekin prezantimin e semaforëve dhe shenjave të trafikut nga mësuesi dhe perceptojnë rolin e tyre në komunikacion, cila dritë do të thotë çfarë dhe cila shenjë e trafikut çfarë. Ata e ndjekin videon në linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=OB6cZh5uub8&t=4s> (Ministria e Punëve të Brendshme), ku përshkruan semaforin, rëndësinë e semaforit për sigurinë e këmbësorëve dhe si të respektohet sinjalizimi i semaforëve nga këmbësorët. Ata diskutojnë për përmbajtjen e videos.

Nxënësit ndahen në dy grupe. Grupi i parë, me ndihmën e kukullave prej letre që përfaqësojnë këmbësorët, kryen lëvizjen e këmbësorëve në një udhëkryq, duke i kushtuar vëmendje sinjalizimit me dritë të semaforëve dhe kuptimit të shenjave të trafikut. Anëtarët e grupit tjetër monitorojnë aktivitetin e tyre dhe nëse vërejnë ndonjë parregullsi, bërtasin **STOP**. Rolet e grupeve ndryshojnë. Diskutohet se sa e rëndësishme është njohja dhe respektimi i semaforëve dhe shenjave të trafikut. Ata e kuptojnë se siguria e tyre në komunikacion varet nga njohja e semaforëve dhe kuptimi i shenjave të trafikut.

Propozim-pyetje. *Cilat lloje të semaforëve ekzistojnë? - Pse shërbejnë? - Çfarë do të thotë për këmbësorët drita e gjelbër dhe e kuqe në semafor? - Çfarë duhet të bëni kur shihni dritën e kuqe në semaforin e këmbësorëve? - Përshkruani se çfarë duhet të bëni kur kaloni rrugën! - Pse është e rëndësishme të dihet kuptimi i semaforëve dhe shenjave të trafikut? – Në çfarë mënyre do të jeni të sigurt në trafik si këmbësorë?*

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-aktivitet. Në një maketë të caktuar me rrugë, semaforë dhe shenja të trafikut, nxënësit gjejnë rrugën nga shtëpia në shkollë, duke i kushtuar vëmendje shenjave të trafikut, semaforëve dhe rregullave për lëvizje të sigurt në rrugë. Ata zbulojnë disa mënyra për të shkuar në shkollë.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

Propozim-pyetje. Përshkruaj rrugën nga maketa që e kalove nga shtëpia në shkollë! - A mund të gjesh një mënyrë tjetër për të shkuar në shkollë? – Në çfarë mënyre e zgjodhe rrugën si më të sigurtën?



PËRMBAJTJA: NDIHMA E PARË, ZJARRFIKËSI DHE POLICIA

STANDARDET E VLERËSIMIT

Liston numrat e telefonit të Ndhmës së Parë, Policisë dhe Zjarrfikësve. Ai shpjegon rolet e Ndhmës së Parë, Shërbimit Zjarrfikës dhe Policisë dhe i lidh ato me situata konkrete

NOCIONET që duhet të përvetësohen

Ndihma e parë/ambulanca, polici, vetura e policisë, vetura e zjarrfikësve, zjarrfikës.

INTEGRIMI ME LËNDË, TEMA, PËRMBAJTJE

Gjuhë maqedonase, fusha: **Të dëgjuarit dhe të folurit** (Zhvillimi i një bisede të shkurtër); Arsim muzikor, tema: **Dëgjimi i muzikës** (Llojet e muzikës - muzikë për fëmijë); Arsim Figurativ, tema: **Pikturim** (Pikturim dhe kolazh).

NDËRLIDHJA VERTIKALE ME NJOHURITË PARAPRAKE DHE TË ARDHSHME

Pritet që nxënësit të kenë tashmë njohuri bazë për kuptimin dhe rolin e Ndhmës së Parë, Shërbimit Zjarrfikës dhe Policisë. Nëpërmjet kësaj përmbajtje mësimore, ata do të thellojnë njohuritë e marra tashmë nga kopshti apo nga shtëpia/komuniteti ku jetojnë. Njohuritë e reja të thelluara do të jenë bazë për marrjen e njohurive të reja nga trafiku dhe kultura e trafikut.

MJETET DHE PAJISJET E NEVOJSHME: automjete lodër (ambulancë, zjarrfikës, makinë policie lodër), teksti "Në pyll" (shtojcë), ilustrime ose fotografi të një polici/police, zjarrfikës/zjarrfikëse, mjeku/mjeke, kuiz i përgatitur online.

Këshilla për mësimdhënësin

- * Nëse keni mundësi, ftoni një pjesëmarrës në klasë (polici/police, zjarrfikës/zjarrfikëse, mjek/mjeke) i cili do të tregojë ndodhi interesante nga puna e tij, kurse nxënësit do t'i bëjnë pyetje.
- * Bëjuani me dije nxënësve që nuk duhet telefonojnë kurrë numrat e telefonit të shërbimeve pa ndonjë nevojë specifike.
- * Identifikoni pranimë e stereotipave dhe paragjykimeve të nxënësit në lidhje me profesionet e specifikuar. Nëpërmjet shembujve konkretë, tregojuni atyre se këto profesione kryhen me sukses dhe profesionalisht nga pjesëtarët e gjinisë mashkullore dhe femërore.

PROPOZIM-AKTIVITETE PËR ORËN

AKTIVITET HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake

Propozim-aktivitet. Nxënësit e ndjekin tekstin "Në pyll" që lexohet nga mësuesi i cili tregon në të njëjtën kohë ilustrimin nga materialet mësimore. Ndahen në dy grupe dhe secili grup bie dakord se cilat pyetje t'i



bëjnë grupit tjetër. Grupet i përgjigjen pyetjes: *Pse shërbejnë Ndihma e Parë, Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Policia?*, dhe më pas dalin në përfundimin se nëse ka zjarr thirret Shërbimi i Zjarrfikësve, nëse ka kundërvajtje ligjore thirret Policia dhe nëse ka rrezik për shëndetin e njerëzve thirret Ndihma e Parë.

Propozim-pyetje. *Përse shërbejnë Ndihma e Parë, Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Policia?*

AKTIVITETI KRYESOR – Të mësuarit nga përvoja

Propozim-aktivitet. Nxënësit e përshkruajnë ambulancën (automjetin e Ndihmës së Parë), automjetin e zjarrfikësve dhe të policisë sipas makinave lodër ose sipas ilustrimeve. Ata i vëzhgojnë ilustrimet apo fotografitë që ua paraqet mësuesi dhe e përshkruajnë uniformën dhe rolin e policëve, zjarrfikësve dhe mjekëve. Në kartat që tregojnë ambulancë, zjarrfikësë dhe automjete policie, ata shkruajnë numrat e telefonit për thirrje.

Nxënësit ndahen në tre grupe dhe secili grup ka për detyrë të luajë një lojë brenda situatës në të cilën një anëtar i grupit duhet të telefonojë Ndihmën e Parë, Policinë ose Zjarrfikësin. Në një telefon të improvizuar e telefonon shërbimin e duhur. Në fund të lojës, ata diskutojnë nëse kanë vlerësuar saktë se cilin shërbim duhet të telefonojnë dhe nëse e dinin numrin për të thirrur.

Propozim-pytje. *Si duken automjetet e ambulancës, zjarrfikësve dhe policisë? - Si duken uniformat e personave që punojnë në këto shërbime? - Në cilën situatë duhet të telefononi Ndihmën e Parë, Policinë apo Zjarrfikësin? - Cilët janë numrat e telefonit për të thirrur?*

AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve

Propozim-pyetje. Nxënësit e zgjidhin kuizin e përgatitur nga mësuesi (kartat e lidhjes, **E SAKTË /JO E SAKTË** ose asociacione) në një aplikacion online ose në një nga programet e prezantimit. Ata diskutojnë se ku janë përgjigjur saktë dhe ku duhet të korrigjojnë.

Refleksion. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë se çfarë kanë bërë në orë, si janë ndjerë, çfarë kanë mësuar, pse u nevojitet ajo që kanë mësuar.

Propozim-pyetje. *Pse duhet të dimë numrat e Ndihmës së Parë, Shërbimit Zjarrfikës dhe Policisë?*

SHTOJCË

NË PYLL

Vllatkoja papritmas hyri në dhomën e Imerit. Ishte shumë i shqetësuar dhe fliste shpejt:

- Imer, eja shpejt të shohësh çfarë ka ndodhur! Sipër, mbi fshat, ka shumë njerëz, automjete, njerëz me uniforma dhe shihet tym nga pylli!

Ymeri veshi me shpejtësi atletet dhe të dy vrapuan drejt pyllit aty pranë për të parë se çfarë po ndodhte.

Dhe vërtet, rrëzë malit, pak më larg nga shtëpitë e fundit të fshatit ku banonin, ishin mbledhur shumë njerëz. Të gjithë po flisnin të emocionuar. Imeri vuri re se zjarrfikësit tashmë po mblidhnin mjetet zjarrfikës së ujit, pranë ambulancës qëndronin doktori dhe doktresha, ndërsa policja po i pyeste diçka banorët e mbledhur aty.

Në atë moment aty ishte edhe babai i Vllatkos. Ai erdhi te Vllatkoja dhe Imeri dhe në momentin që do t'u thoshte të shkonin në shtëpi, Vllatkoja e pyeti:

- Babi, çfarë ndodhi? Pse ka një shërbim zjarrfikës, polici, ambulancë? Pse del tym prej pyllit?

- Bir, një i pandërgjegjshëm i ka vënë flakën pyllit. Për fat të mirë, fqinji ynë Tariq ka vërejtur tym dhe menjëherë ka lajmëruar zjarrfikësin. Zjarrfikësit e shuanin zjarrin para se ai të përfshinte pyllin.

- Prandaj dëgjova sirenat. Kanë fishkëllyer, fishkëllyer... por nuk më ka shkuar mendja se ishte zjarr, - tha Imeri.

- Po, për fat erdhën shpejt zjarrfikësit, policia dhe ambulanca.

– Po pse Policia dhe Ndihma e Parë? Apo ata nuk e shuajnë zjarrin?

-Ambulanca duhet të vijë në rast se ka ndonjë njeri të lënduar dhe Policia ka ardhur për të hetuar se kush e ka ndezur zjarrin. Shkaktimi i zjarrit është kundërligjore, Imer, - u përgjigj babai i Vllatkos.

- Oh, psherëtiu Vllatkoja, për fat të mirë nuk ka të lënduar, por duhet gjetur autori dhe kjo është punë e Policisë. Pylli mund të digjej dhe a nuk e dimë që pyjet janë pasuria jonë natyrore dhe ne duhet t'i mbrojmë. Shpresoj të mos ketë më raste të tilla.

Turma tashmë kishte filluar të shpërndahej, por Vllatkoja dhe Imeri ende qëndronin këmbë dhe shikonin zjarrfikësit duke mbledhur pajisjet e tyre. Në atë moment ata ishin heronjtë e tyre. Ata dëshironin që edhe ata të ishin zjarrfikës kur të rriteshin.

Autore: Glikeria Ilioska

SHTOJCA

SHTOJCA NR.1

Ndërlidhja me standardet nacionale¹¹

Përmbajta	Fusha e kompetencave			
	<i>Shoqëria dhe kultura demokratike</i>		<i>Edukimi digjital, zhvillimi personal dhe social, teknika, teknologjia dhe sipërmarrja dhe shprehja dhe kultura artistike</i>	
	<i>Nxënësi/nxënësja do të mund:</i>	<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	<i>Nxënësi/nxënësja do të mund:</i>	<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>
Kush jam?	VI-A.5 të kuptojë dallimet ndërmjet njerëzve mbi çdo bazë (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.);	VI-B.1 nuk duhet të diskriminojë në bazë të dallimeve ndërmjet njerëzve (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social etj.);	V-A.13 të komunikojë me të tjerët dhe të paraqitet në mënyrë të përshtatshme për situatën; V-A.17 të kërkojë përgjigje kthyesë dhe mbështetje për veten, por edhe për të dhënë përgjigje kthyesë konstruktive në dobi të të tjerëve;	V-B.2 realizimi i identitetit të vet kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimit personal;
Çfarë mund të bëj tani dhe çfarë do të mund të bëj në të ardhmen?	VI-A.2 të analizojë sjelljen e tij për të përmirësuar, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet;	VI-B.2 të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat	V-A.4 të vlerësojë aftësitë dhe arritjet e veta (duke përfshirë pikat e forta dhe të dobëta) dhe në bazë të tyre të përcaktojë prioritetet që do t'i mundësojnë	V-B.3 arritjet dhe mirëqenia e dikujt varen në masën më të madhe nga përpjekja që vet investon dhe nga rezultatet që ai arrin;

¹¹ Programi mësimor SHOQËRIA për klasën e I-rë, Shkup, 2021.

		dhe interesat e tyre;	zhvillim dhe avancim;	
			V-A.6 të vendosë synime për mësimin dhe zhvillimin personal dhe të punojë në tejkalimin e sfidave që dalin në rrugën drejt realizimit të tyre;	
Çfarë pëlqen vetja ? (Orari javor)	më te im	VI-A.2 të analizojë sjelljen e tij për të përmirësuar, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet;	VI-B.2 të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;	V-A.8 të organizojë kohën e tij/saj në një mënyrë që do t'i mundësojë atij/asaj të arrijë në mënyrë efikase dhe efektive qëllimet e vendosura dhe të përmbush nevojat e veta;
Çfarë pëlqen vetja? (Me punë drejt suksesit)	më te	VI-A.2 të analizojë sjelljen e tij për të përmirësuar, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet;	VI-B.2 të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;	V-A.9 të parashikojë pasojat e veprimeve të tij dhe të veprimeve të të tjerëve për veten dhe të tjerët; V-A.10 të zbatojë parimet etike kur vlerëson të drejtën dhe të gabuarën në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të shfaqë tipare të virtytshme të karakterit (siç janë: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria,
				V-B.3 arritjet dhe mirëqenia e dikujt varen në masën më të madhe nga përpjekja që vet investon dhe nga rezultatet që ai arrin; V-B.4 çdo veprim që e ndërmerr ka pasoja për të ose për rrethin e tij/saj;

			guximi dhe vetëdisiplina);	
Shokët dhe shoqet e mia	VI-A.5 të kuptojë dallimet ndërmjet njerëzve mbi çdo bazë (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.); VI-A.6 të njohë praninë e stereotipave dhe paragjytimeve tek vetja dhe tek të tjerët dhe të kundërshtojë diskriminimin; VI-A.7 të njohë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin e vet, të perceptojë pasojat e dhunës dhe ta kundërshtojë atë;	VI-B.1 nuk duhet të diskriminojë në bazë të dallimeve ndërmjet njerëzve (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.);	V-A.10 të zbatojë parimet etike kur vlerëson të drejtën dhe të gabuarën në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të shfaqë tipare të virtytshme të karakterit (siç janë: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina); V-A.12 me sukses të përballet me presionet sociale;	V-B.8 ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - pasi ai/ajo ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve të kënaqin interesat dhe nevojat e tij/saj, ai/ajo gjithashtu ka përgjegjësinë t'u japë hapësirë të tjerëve për të kënaqur interesat dhe nevojat e tyre;
Klasa dhe shkolla jonë (Klasa jonë)	VI-A.5 të kuptojë dallimet ndërmjet njerëzve mbi çdo bazë (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.);	VI-B.2 të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;	V-A.15 të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;	V-B.4 çdo veprim që e ndërmerr ka pasojë për të ose për rrethin e tij/saj;
Klasa dhe shkolla jonë (Klasa jonë)	VI-A.2 të analizojë sjelljen e tij për të përmirësuar, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet;	VI-B.2 të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në	V-A.15 të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke	V-B.4 çdo veprim që e ndërmerr ka pasojë për të ose për rrethin e tij/saj;

		lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;	marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;	
Klasa dhe shkolla jonë (Kujdesi për higjienën në shkollë dhe oborrin e shkollës)	VI-A.2 të analizojë sjelljen e tij për të përmirësuar, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet;	VI-B.2 të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;	V-A.15 të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve; V-A.19 të bëjë sugjerime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe të parashikojë pasojat për të nxjerrë përfundime dhe për të marrë vendime racionale;	V-B.4 çdo veprim që e ndërmerr ka pasoja për të ose për rrethin e tij/saj;
Klasa dhe shkolla jonë (Si sillem në klasë, shkollë dhe oborrin e shkollës?)	VI-A.2 të analizojë sjelljen e tij për të përmirësuar, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet; VI-A.6 të njohë praninë e stereotipeve dhe paragjykimeve tek vetja dhe tek të tjerët dhe të kundërshtojë diskriminimin; VI-A.7 të njohë shfaqjen e dhunës verbale dhe	VI-B.1 nuk duhet të diskriminojë në bazë të dallimeve ndërmjet njerëzve (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.); VI-B.2 të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e	V-A.10 të zbatojë parimet etike kur vlerëson të drejtën dhe të gabuarën në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të shfaqë tipare të virtytshme të karakterit (siç janë: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);	V-B.4 çdo veprim që e ndërmerr ka pasoja për të ose për rrethin e tij/saj; V-B.7 iniciativa, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për kryerjen e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme;

	fizike në mjedisin e vet, të perceptojë pasojat e dhunës dhe ta kundërshtojë atë;	tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;	V-A.19 të bëjë sugjerime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe të parashikojë pasojat për të nxjerrë përfundime dhe për të marrë vendime racionale;	
Ne nxënësit dhe mësuesi/mësu esja jonë	VI-A.2 të analizojë sjelljen e tij për të përmirësuar, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet; VI-A.6 të njohë praninë e stereotipeve dhe paragjykimeve tek vetja dhe tek të tjerët dhe të kundërshtojë diskriminimin;	VI-B.1 nuk duhet të diskriminojë në bazë të dallimeve ndërmjet njerëzve (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.); VI-B. 2 të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;	V-A.15 të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve; V-A.19 të bëjë sugjerime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe të parashikojë pasojat për të nxjerrë përfundime dhe për të marrë vendime racionale;	V-B.4 çdo veprim që e ndërmerr ka pasoja për të ose për rrethin e tij/saj;
Shtëpia dhe familja - Ku jeton (shtëpi, banesë)?	VI-A.3 të formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e tij, të dëgjojë dhe analizojë pikëpamjet e njerëzve të tjerë dhe t'i trajtojë me respekt, edhe kur nuk është dakord;	VI-B.2 të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;	IV-A.2 të vlerësojë se kur dhe në çfarë mënyre nevojitet përdorimi efektiv i TIK-ut për të zgjidhur një detyrë/problem	IV-B.1 Edukimi digjital është i nevojshëm për jetën e përditshme – lehtëson mësimin, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;

Shtëpia dhe familja (<i>Me kë jetoj?</i>)	VI-A.5 të kuptojë dallimet ndërmjet njerëzve mbi çdo bazë (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.);	VI-B.1 nuk duhet të diskriminojë në bazë të dallimeve ndërmjet njerëzve (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.);	V-A.3 të identifikojë komponentët e ndryshëm të identitetit të vet, i cili ndërtohet mbi bazën e përkatësisë në grupe të ndryshme shoqërore (për shembull, identiteti gjinor, etnik dhe kombëtar) dhe rolet e ndryshme që ka në jetë (për shembull, nxënësi, djali/vajza);	V-B.2 realizimi i identitetit të vet kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimit personal;
Rolet dhe përgjegjësitë në shtëpi (<i>Si kujdesimi për shtëpinë tonë?</i>)	VI-A.2 të analizojë sjelljen e tij për të përmirësuar, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet; VI-A.6 të njohë pranimin e stereotipeve dhe paragjykitimeve tek vetja dhe tek të tjerët dhe të kundërshtojë diskriminimin;	VI-B.1 nuk duhet të diskriminojë në bazë të dallimeve ndërmjet njerëzve (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.); VI-B.2 të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;	V-A.15 të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;	V-B.8 ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - pasi ai/a jo ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve të kënaqin interesat dhe nevojat e tij/saj, ai/a jo gjithashtu ka përgjegjësinë t'u japë hapësirë të tjerëve për të kënaqur interesat dhe nevojat e tyre;
Rolet dhe përgjegjësitë në shtëpi (<i>Si kujdesimi për shtëpinë tonë?</i>)	VI-A.3 të formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e tij, të dëgjojë dhe analizojë pikëpamjet e njerëzve të tjerë dhe t'i trajtojë me	VI-B.2 të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin	V-A.9 të parashikojë pasojat e veprimeve të tij dhe të veprimeve të të tjerëve për veten dhe të tjerët;	V-B.8 ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - pasi ai/a jo ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve të kënaqin interesat

	respekt, edhe kur nuk është dakord;	pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;	V-A.19 të bëjë sugjerime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe të parashikojë pasojat për të nxjerrë përfundime dhe për të marrë vendime racionale;	dhe nevojat e tij/saj, ai/ajo gjithashtu ka përgjegjësinë t'u japë hapësirë të tjerëve për të kënaqur interesat dhe nevojat e tyre;
Aktivitete brenda ditës (<i>Një ditë me familjen time</i>)	VI-A.2 të analizojë sjelljen e tij për të përmirësuar, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet;	VI-B.2 të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;	V-A.8 të organizojë kohën e tij/saj në atë mënyrë që t'i mundësojë atij/asaj të arrijë në mënyrë efikase dhe efektive qëllimet e përcaktuara dhe të përmbush nevojat e veta;	V-B.3 arritjet dhe mirëqenia e dikujt varen në masën më të madhe nga përpjekja që vet investon dhe nga rezultatet që ai arrin;
Qyteti/fshati dhe shteti im – Ku jetoj (<i>qytet/fshat, shtet</i>)?	VI-A.22 të identifikojë dhe respektojë të gjitha simbolet kombëtare të shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të shfaq ndjenjën e përkatësisë ndaj shtetit;	VI-B.13 identiteti kombëtar, i cili rezulton nga përkatësia në shtetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, është komponent thelbësor i identitetit të të gjithë qytetarëve të shtetit;	V-A.3 të identifikojë komponentët e ndryshëm të identitetit të vet, i cili ndërtohet mbi bazën e përkatësisë në grupe të ndryshme shoqërore (për shembull, identiteti gjinor, etnik dhe kombëtar) dhe rolet e ndryshme që ka në jetë (për shembull, nxënësi, djali/vajza);	V-B.2 realizimi i identitetit të vet kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimit personal;
Luaj i sigurt dhe oriento hem në hapësirë	VI-A.11 të zbatojë rregullat dhe dispozitat për pjesëmarrje të sigurt në trafik;	VI-B.8 çdo qytetar është i detyruar të respektojë ligjet dhe rregullat dhe dispozitat që rregullojnë sjelljen e njerëzve dhe	V-A.9 të parashikojë pasojat e veprimeve të tij dhe të veprimeve të tjerëve për veten dhe të tjerët;	V-B.4 çdo veprim që e ndërmerr ka pasojë për të ose për rrethin e tij/saj;


		funksionimin e institucioneve;	V-A.19 të bëjë sugjerime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe të parashikojë pasojat për të nxjerrë përfundime dhe për të marrë vendime racionale;	
Unë lëviz i sigurt dhe marrë pjesë në trafik (Shenjat e trafikut dhe semafori)	VI-A.11 të zbatojë rregullat dhe dispozitat për pjesëmarrje të sigurt në trafik;	VI-B.8 çdo qytetar është i detyruar të respektojë ligjet dhe rregullat dhe dispozitat që rregullojnë sjelljen e njerëzve dhe funksionimin e institucioneve;	V-A.9 të parashikojë pasojat e veprimeve të tij dhe të veprimeve të tjerëve për veten dhe të tjerët;	V-B.4 çdo veprim që e ndërmerr ka pasojë për të ose për rrethin e tij/saj;
Ndihma e parë, Zjarrfikësi dhe Policia	VI-A.11 të zbatojë rregullat dhe dispozitat për pjesëmarrje të sigurt në trafik;	VI-B.8 çdo qytetar është i detyruar të respektojë ligjet dhe rregullat dhe dispozitat që rregullojnë sjelljen e njerëzve dhe funksionimin e institucioneve;	V-A.9 të parashikojë pasojat e veprimeve të tij dhe të veprimeve të tjerëve për veten dhe të tjerët;	V-B.4 çdo veprim që e ndërmerr ka pasojë për të ose për rrethin e tij/saj; VII-B.5 resurset nuk janë të pakufizuara dhe se është e nevojshme të përdoren me përgjegjësi.

SHTOJCA NR. 2

VETËVLERËSIMI I NXËNËSVE

Përshkrim. Duke qenë se nxënësit në fillim të klasës së parë nuk dinë ende shkrim-lexim, vetëvlerësimi realizohet duke treguar simbole ose shkallë që nxënësit duhet të rrethojnë, veçojnë ose ngjyrosin. Në fund të gjysmëvjetorit të dytë, nxënësit kanë mësuar shkrim-lexim dhe mund të përdorin fjali të shkurtra për t'u vetëvlerësuar. Vetëvlerësimi mund të jetë në fund të orës së mësimit, pas një aktiviteti, loje ose në fund të çdo teme të trajtuar.

Shembull për vetëvlerësim në fund të orës (faza para shkrim-leximit):



Sa jam i/e kënaqur nga ajo që kam mësuar këtë orë?

(NËNVIZO ME SHENJËN E EMOTIKONIT)

Shembull për vetëvlerësim në fund të orës (faza e shkrim-leximit):




Се самооценувам

Име и презиме_____

Наставна содржина _____

Колку научив на овој час? (обој ја скалата)

Што ми беше најинтересно? (нацртај или напиши)



Што би сакала/сакал да научам уште нешто? (нацртај или напиши)





Vetëvlerësohem

Emri dhe mbiemri.....

Përmbajtja mësimore.....

Sa mësova nga kjo orë? (ngjyros)

Çfarë ishte më interesante për mua? (vizato ose shkruaj)

Çfarë do të kisha dashur të mëson edhe diçka tjetër? (vizato ose shkruaj)

SHTOJCA NR. 3

Shembull për integrim ndërlëndor në një ditë mësimore

	SI KUJDESEMI PËR SHTËPINË TONË
Lënda	Shoqëri
Tema	Shtëpia ime
Rezultati nga të mësuarit	E shpjegon rolin dhe përgjegjësitë e fëmijëve dhe të rriturve në familje/komunitet.
Standardet e vlerësimit	I përmend dhe shpjegon procedurat për ruajtjen e higjienës personale me përdorim të përgjegjshëm të ujit; të identifikojë se ku hidhen mbeturinat shtëpiake; e shpjegon rolin e tij dhe rolin e anëtarëve të familjes në ruajtjen e higjienës në shtëpi; e dallon punët dhe përgjegjësitë e të rriturve dhe fëmijëve në familje/shtëpi; shpjegon se anëtarët e familjes meshkuj dhe femra janë njësoj përgjegjës për kujdesin e shtëpisë (ruajtja e higjienës, gatimi, etj.).
Përmbajtja	<i>Rolet dhe përgjegjësitë në shtëpi</i>
Nocionet	Kujdesi, të rriturit, obligimi, respekti, përgjegjësia, higjiena.
Lënda	Gjuhë amtare
Fusha	Shkrim-leximi fillestar
Rezultati nga të mësuarit	Shkruan fjalë dhe fjali të shkurtra
Standardet e vlerësimit	Shkruan fjali të shkurtëra, duke përdorur shkronjën e madhe dhe shenjat e interpunkcionit (pikë, pikëçuditje dhe pikëpyetje).
Përmbajtja	<i>Shkrimi fillestar</i>
Nocionet	Shkronjat e shtypit, shkronjat e vogla, shkronja e mëdha, pikë, pikëpyetje, pikëçuditëse.
Lënda	Matematikë
Tema	Puna me të dhëna
Rezultati nga të mësuarit	Përdor tabela dhe diagrame për të nxjerrë përfundime; rendit, shfaq dhe lexon të dhënat në tabela dhe diagrame.
Standardet e vlerësimit	Grumbullon dhe regjistron të dhëna në listë dhe tabelë; rendit të dhënat në një tabelë; lexon dhe shpjegon të dhënat e paraqitura në një tabelë.
Përmbajtja	<i>Mbledh, prezanton, interpreton dhe lexon të dhëna nga diagrami</i>
Nocionet	Të dhëna, tabelë, diagrami.
Lënda	Arsim figurativ
Tema	Pikturim
Rezultati nga të mësuarit	I dallon ngjyrat themelore dhe shprehet në mënyrë kreative me to.
Standardet e vlerësimit	Pikturon objekte dhe personazhe të njohuria nga rrethina.
Përmbajtja	<i>Pikturim dhe kolazh</i>
Nocionet	Pikturë, ngjyrat kryesore, nuancat, të lehta, të errëta, pikturë.

Mjetet dhe pajisjet nevojshe	e	Tabelat për regjistrimin e rezultateve, ilustrimet, prezantimi i përgatitur nga mësuesi, letër (fletët e bllokut), temperë, lapsa.
Monitorimi i progresit	i	Përgjigje me gojë në diskutim; përgjigje me gojë dhe me shkrim të parashtruara nga mësuesi; mënyra dhe procedura për zgjidhjen e detyrave; aktiviteti dhe kontributi në punën në grup; kontribut në nxjerrjen e përfundimeve. Shënim. Në orën e lëndës Shoqëria do të përdoret Rubrika si instrument për monitorimin e përparimit të nxënësve.
Aktivitete (Janë paraparë 1 orë për përgatitje paraprake dhe 5 orë mësimore së bashku me aktivitetet e lira.)		
Aktiviteti paraprak		Nxënësit ndahen në tre grupe dhe për detyrë shtëpie e kanë këtë detyrë: - anëtarët e grupit të parë shkruajnë se kush çfarë bën në shtëpinë e tyre; - anëtarët e grupit të dytë mbledhin të dhëna se për çfarë e përdorin ujin anëtarët e familjes së tyre gjatë ditës; - Anëtarët e grupit të tretë mbledhin të dhëna se si i selektojnë mbetjet nga shtëpia e tyre. Të dhënat i regjistrojnë në tabela të përgatitura më parë nga mësuesi (shtojcë). Të dhënat e marra do të jenë të dobishme për aktivitetet e ardhshme në ditën e punës.
Shoqëria AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake		Nxënësit ndjekin një prezantim të ilustrimeve që tregojnë aktivitete të ndryshme në shtëpi të kryera nga fëmijët. Secili nxënës shënon në një fletë se sa nga aktivitetet e prezantuara kryen në shtëpinë e tij. Në fund nxënësit bëjnë një përmbledhje të numrit të përgjithshëm të aktiviteteve dhe nëse ka disa aktivitete që nuk paraqiten, i shtojnë ato. Secili nxënës i numëron aktivitetet e tij në shtëpi. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve: <i>Cilat janë detyrat e juaja në shtëpi? - Kur dhe si i realizoni ato?</i>
AKTIVITETI KRYESOR – të mësuarit nga përvoja		Nxënësit e ndjekin prezantimin e përgatitur nga mësuesi, ku janë shfaqur skena të aktiviteteve të përditshme në shtëpi, por këtë herë nga të gjithë anëtarët e familjes (ruajtja e higjienës në shtëpi, gatimi, hekurosja, shikimi i televizorit, ujitja e luleve, lojëra në grup, bëjnë pazar, rregullimi i oborrit/kopshtit, kujdesi për kafshët shtëpiake, riparimet etj.). Pason një diskutim për atë që ata po bëjnë në shtëpinë e tyre kush çfarë dhe po bën në shtëpinë e tyre. Diskutohet stereotipizimi i roleve gjinore në shtëpi. Fillohet një diskutim në lidhje me pyetjet e mëposhtme: <i>Cilat punë në shtëpi kanë të rriturit dhe cilat fëmijët? - Si ndryshojnë këto detyra? - Nëpërmjet cilat aktivitete ndihmoni në shtëpi? - Pse fëmijët nuk mund të bëjnë disa gjëra që mund të bëjnë të rriturit? - Çfarë punësh mund të bëni së bashku me të rriturit? - Çfarë pune të pëlqen të bësh? - A ka një ndarje të punës së burrave dhe grave? - Çfarë mund të bëni që të mos ketë një ndarje të tillë? - Çfarë do të ndodhë nëse familjarët nuk i respektojnë detyrimet e tyre?</i>
AKTIVITETI PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve		Nxënësit diskutojnë dhe bëjnë propozime për mënyra të tjera që mund të kontribuojnë në rregullimin, higjienën, kursimin e ujit dhe energjisë elektrike dhe grumbullimin e duhur të mbeturinave shtëpiake.
Gjuhë amtare AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i		Nxënësit përsëri shikojnë prezantimin që tregon aktivitetet e fëmijëve në shtëpi dhe i lexojnë fjalitë e shkurtër nën çdo ilustrim në lidhje me aktivitetet në shtëpi. Për shembull: <i>Djali po ujit lulet. - Vajza po e rregullon shtratin. - Djali e rregullon dhomën etj.</i> Në këtë mënyrë i përsërisin shkronjat e mësuara dhe praktikojnë leximin me zë.

njohurive paraprake	
AKTIVITETI KRYESOR – të mësuarit nga përvoja	Nxënësit e ndjekin prezantimin e përgatitur nga mësuesi, ku shfaqen skena të aktiviteteve të përditshme në shtëpi, por këtë herë nga të gjithë anëtarët e familjes (ruajtja e higjienës në shtëpi, gatimi, hekurosja, shikimi i televizorit, ujitja e luleve, lojërat në grup, bëjnë pazar, rregullojnë oborrin/kopshtin, kujdesi për kafshët shtëpiake, bëjnë riparime etj.) dhe për çdo ilustrim gojarisht tregojnë fjali. Ndahen në tre grupe dhe shkruajnë fjali që lidhen me ilustrimet. Grupi i parë kryen aktivitete për hartimin e fjalive pyetëse duke përdorur shenjën e pikëpyetjes. Grupi i dytë harton fjali thirrmore duke përdorur pikëçuditjen në fund të fjalisë. Grupi i tretë harton fjali rrëfimore. Ata i prezantojnë punimet. I shkruajnë fjalitë në afishe/spikerë që do t'i përdorin kur do të punojnë me librin “Si kujdesemi për shtëpinë tonë”.
AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve	Nxënësit përzgjedhin fjalitë përmes të cilave shprehin rregullat për kursimin e ujit, selektimin e saktë të mbeturinave shtëpiake dhe rregullat e sjelljes në shtëpi. Fillohet një diskutim lidhur me pyetjen se përse është e nevojshme që ata të dinë të shkruajnë dhe lexojnë fjali rrëfyese, pyetëse dhe thirrëse.
Matematikë AKTIVITETI HYRËS – Aktivizimi i njohurive paraprake	Secili nxënës shënon në një fletë se sa nga aktivitetet e treguara kryen në shtëpinë e tij. Në fund secili nxënës përmbledh numrin e përgjithshëm të aktiviteteve dhe nëse ka disa aktivitete që nuk prezantuar, nxënësit i shtojnë ato në fletë. Ata u përgjigjen pyetjeve: <i>Sa më shumë/më pak aktivitete ka nxënësi 1 se nxënësi 2? - Sa aktivitete gjithsej kanë nxënësit në nivel klase?</i> Nxënësit i paraqesin përgjigjet e tyre.
AKTIVITETI KRYESOR – të mësuarit nga përvoja	Nxënësit i prezantojnë të dhënat e mbledhura nga detyrat e shtëpisë. Bazuar në rezultatet e paraqitura në tabela, krijohen tabela me një diagram në të cilat tregohen rezultatet e të gjithë klasës. Fillohet një diskutim për numrin e obligimeve sipas familjarëve, për shembull, sa herë në ditë hapet rubineti, sa mbetje hidhen. Nxënësit diskutojnë se cili anëtar i familjes kryen më shumë detyra, cili më pak, si duhet të jetë ndarja e detyrave, kush përdor më shumë ujë, për çfarë përdor më shumë ujë dhe për çfarë më pak etj. Më kalohet në hartimin dhe zgjidhjen e problemeve tekstuale që lidhen me rezultatet e fituara. Fillimisht mësuesi jep një shembull dhe më pas nxënësit të ndarë në dyshe hartojnë detyra tekstuale. Për shembull: <i>Mile e hap rubinetin 10 herë gjatë ditës. Motra e tij 8 herë. Sa herë gjithsej e hapin rubinetin gjatë ditës? - Jana hodhi 14 letra në koshin e letrës, kurse Lina 4 më pak. Sa letra hodhi Lina? - Mblidheni numrin e përgjegjësive tuaja në shtëpi me numrin e përgjegjësive në shtëpinë e shokut tuaj!</i> etj. Nxënësit zgjidhin detyrat dhe paraqesin përgjigjet. Në afishe/spikerë i shkruajnë detyrat dhe zgjidhjet që do të përdorin kur do të punojnë me librin “Si kujdesemi për shtëpinë tonë”.
AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve	Nxënësit zgjedhin detyrat sipas asaj cilit grup bëjnë pjesë: rregullat e kursimit të ujit, selektimi i saktë i mbeturinave shtëpiake dhe rregullat e sjelljes në shtëpi.
Arsimi figurativ AKTIVITETI HYRËS –	Nxënësit diskutojnë se cilat ngjyra përfaqësohen në ilustrime, cilat ngjyra janë primare, zbulojnë praninë e ngjyrave kryesore në mjedisin e afërt. Ata i numërojnë obligimet e fëmijëve në shtëpi, mënyrat e kursimit të ujit dhe selektimin e mbeturinave shtëpiake. Nëpërmjet këtij diskutimi përcaktohet edhe motivi i veprave

Aktivizimi i njohurive paraprake	artistike që do të krijojnë. Ata diskutojnë se cilën teknikë të pikturimit do të aplikojnë në veprat e artit.
AKTIVITETI KRYESOR – të mësuarit nga përvoja	Nxënësit ndahen në tre grupe. Grupi i parë duhet të pikturojë obligimet e fëmijëve në shtëpi (secili anëtar i grupit vizaton një deri në dy obligime); grupi i dytë duhet të pikturojë se si mund të kursehet uji në shtëpi, dhe i treti duhet të pikturojë se si selektohen mbeturinat në shtëpi. Pikturat vizatohen në fletë të përgatitura më parë në format A4 nga mësuesi.
AKTIVITET PËRFUNDIMTAR – Nxjerrja e konkluzioneve	Secili grup i prezanton krijimet e tij para shokëve/shoqeve të tij. Punimet artistike analizohen dhe vlerësohen estetikisht nga nxënësit dhe mësuesi. I grupojnë krijimet sipas motivit që kanë pikturuar.
Aktivitete të lira	Të gjitha krijimet mblidhen dhe krijohet një libër me titull “Si kujdesemi për shtëpinë tonë”. Libri u prezantohet nxënësve dhe mësuesve të tjerë.

Shtojcë

Grupi 1: Aktivitete në shtëpi							
	Unë	Nëna	Babai	Vëllai/motra	Gjyshja	Gjyshi	Tezja/xhaxhai
Gatuan							
Fshin pluhurin							
E shtron dhe e pastron tryezën para dhe pas ngrënies							
Larja e enëve							
E rregullon dhomën e fëmijëve							
Rregullon shtretërit							
I ujit lulet							
Ushqen kafshët shtëpiake							
E shëtitë kafshën shtëpiake							
Bën pazar							

Grupi 2: Përdorimi i ujit							
	Unë	Nëna	Babai	Vëllai/motra	Gjyshja	Gjyshi	Tezja/xhaxhai
Larja e duarve/fytyrës							
Pastrimi i dhëmbëve							
Bën dush							
I nxjerr lulet							
Larja e oborrit							
Larja e enëve							

Grupi 3: Selektimi i mbetjeve							
	Unë	Nëna	Babai	Vëllai/motra	Gjyshja	Gjyshi	Tezja/xhaxhai
E selekton letrën							
E selekton plastikën							
E selekton qelqin							

Rubrika për monitorimin e progresit të nxënësve

kategoritë (standardet e vlerësimit)	1 pikë	2 pikë	3 pikë	4 pikë
I dallon obligimet dhe përgjegjësitë e të rriturve dhe fëmijëve në familje/shtëpi.	I dallon obligimet dhe përgjegjësitë e të rriturve dhe fëmijëve vetëm me ndihmën e mësuesit.	I dallon obligimet dhe përgjegjësitë e të rriturve dhe fëmijëve në familje/shtëpi me inkurajim dhe udhëzim nga mësuesi dhe shokët e klasës.	I dallon obligimet dhe përgjegjësitë e të rriturve dhe fëmijëve në familje/shtëpi me orientim të here pas here të mësuesit.	Në mënyrë të pavarur i dallon dhe i përshkruan obligimet dhe përgjegjësitë e të rriturve dhe fëmijëve në familje/shtëpi.
Shpjegon se edhe anëtarët e familjes meshkuj edhe femra janë njësoj përgjegjës për kujdesin e shtëpisë (mirëmbajtjen e higjienës, gatimin, etj.).	Përgjegjësitë dhe obligimet në shtëpi i ndanë sipas përkatësisë gjinore.	Shpjegon për ndarje të barabartë të përgjegjësisë dhe obligimeve në shtëpi, por nuk është i sigurt në përgjigje.	Shpjegon për ndarje të barabartë të përgjegjësisë dhe obligimeve në shtëpi me orientim të here pas here të mësuesit.	Në mënyrë të pavarur shpjegon se edhe anëtarët meshkuj edhe femra të familjes janë përgjegjës njësoj për kujdesin në shtëpi (për mirëmbajtjen e higjienës, për gatim etj.)
E sqaron rolin e vet dhe rolin e anëtarëve të familjes në mirëmbajtjen e higjienës në shtëpi.	E di se si mbahet higjiena në shtëpi por nuk e definon rolin e vet dhe rolin e anëtarëve të familjes.	Shpjegon rolin e vet dhe rolin e anëtarëve të familjes në mirëmbajtjen e higjienës në shtëpi me ndihmën e mësuesit dhe shokëve të klasës.	Shpjegon rolin e vet dhe rolin e anëtarëve të familjes në mirëmbajtjen e higjienës në shtëpi me orientim të here pas here të mësuesit.	Në mënyrë të pavarur dhe konkrete e shpjegon rolin e vet dhe rolin e anëtarëve të familjes në mirëmbajtjen e higjienës në shtëpi.
I thekson dhe i shpjegon procedurat për	Nuk i tregon procedurat e mirëmbajtjen së	Tregon një pjesë të procedurave për përdorimin e	I tregon dhe i shpjegon procedurat për	Në mënyrë të pavarur i tregon dhe i shpjegon procedurat

mirëmbajtjen e higjienës personale me përdorim të përgjegjshëm të ujit.	higjienës personale me përdorim të përgjegjshëm të ujit.	përgjegjshëm të ujit me nxitje të mësuesit.	mirëmbajtjen e higjienës personale me përdorim të përgjegjshëm të ujit me orientim të here pas here të mësuesit.	për mirëmbajtjen e higjienës personale me përdorim të përgjegjshëm të ujit.
Identifikon se ku hidhen mbeturinat e familjes.	Nuk identifikon vende për hedhjen e mbeturinave të familjes.	Tregon vendin ku hidhen mbeturinat me ndihmën e mësuesit.	Identifikon ku hidhen mbetjet e amvisërisë me udhëzime të herpashershme të mësuesit.	Në mënyrë të pavarur identifikon ku hidhen mbetjet e amvisërisë.
Bashkëpunon dhe jep kontribut në punën në grup.	Nuk bashkëpunon me nxënësit në grup dhe nuk merr pjesë në përfundimin me sukses të detyrave të dhëna.	Bashkëpunon rrallë me nxënësit në grup dhe jep kontribut të vogël në përfundimin me sukses të detyrave të dhëna.	Bashkëpunon me disa nxënës në grup dhe jep kontribut në përfundimin me sukses të detyrave të dhëna.	Bashkëpunon vazhdimisht me të gjithë nxënësit në grup dhe jep kontribut të madh në përfundimin me sukses të detyrave të dhëna.
Gjithsej				

SHTOJCA NR. 4

SHEMBULL I APLIKIMIT TË METODOLOGJISË SË TË MENDAURIT DIZAJNUES

	Shoqëria	Shkencat natyrore	Gjuhë maqedonase	Arsim figurativ
Tema/fusha	Shtëpia ime	Materialet	Edukimi dhe kultura mediatike	Formësimi plastik
Rezultatet nga të mësuarit	E identifikon veten si anëtar i familjes/komunitetit.	E ndërlidhë aplikimin e materialeve me cilësitë e tyre.	Veçon informacione nga lloje të ndryshme të mediave me ndihmën e mësuesit.	Krijon me veprime të ndryshme: grisje, prerje, përkulje, bashkim, ndarje, palosje, formësim.

Standardet e vlerësimit	E përshkruan shtëpinë, i identifikon ambientet në shtëpi sqaron se për çfarë shërbejnë.	Bën dallim midis cilësive të materialin dhe aplikimit të tij. E sqaron aplikimin e materialeve varësisht nga cilësitë e tyre.	Veçon informacione nga një tekst i shkruar sipas udhëzimeve të dhëna (nga broshura, reklama nga gazeta/bilbordi, revistë për fëmijë, tekst i marrë nga interneti).	Identifikon materialet natyrore dhe artificiale që mund të përdoren për formësim. Përdor materiale të ndryshme natyrore dhe artificiale në formësim.
Përmbajtja	<i>Ku jetoj?</i>	<i>Aplikimi i materialeve</i>	<i>Informacione nga media të ndryshme</i>	<i>Materialet/mjetet bazë për formimin e plastikës</i>
Nocionet	Shtëpi/banesë, ambientet në shtëpi.	Letër, karton.	Revista për fëmijë, interneti.	Materialet natyrore dhe artificiale.
Mjetet dhe pajisjet e nevojshme	Fleta, laptop, internet, kuti kartoni, ngjitës, gërsërë, argjilë, plastelinë, kukulla.			
Monitorimi i progresit	Përgjigje gojarisht në diskutim; përgjigjet me gojë dhe me shkrim të parashtruara nga mësuesi; aktivitet dhe kontribut në punën në grup; kontribut në nxjerrjen e përfundimeve; realizim praktik.			

Ora	Aktivitete (6 orë janë planifikuar së bashku me orën për aktivitete të lira)
Ora 1-rë dhe 2-të Hulumtimi dhe mirëkuptimi (ndërtimi i empatisë ndaj përdoruesit)	Nxënësit e dëgjojnë tregimin që mësuesi lexon ose ua tregon me gojë (shtojcë). Diskutojnë për përmbajtjen. Ata e kuptojnë se zgjidhja e problemit nga tregimi është të bëjnë një shtëpi për kukullat. Mësuesi i ndan nxënësit në 3 grupe dhe ata ndjekin udhëzimet në lidhje me mënyrën e zbatimit të metodës së hulumtimit dhe qëllimin e saj. Secili grup ka për detyrë të zbatojë një metodë (vëzhgim, hulumtim dhe intervistim). Grupi i parë: VËZHGIM. Nxënësit ndjekin prezantimin ose videon që u prezanton mësuesi, ku përshkruhen llojet e shtëpive (shtëpi ose banesë) dhe hapësirat në shtëpi. Grupi i dytë: HULUMTIM. Nxënësit hulumtojnë Në internet dhe/ose revistat për fëmijë për shembuj të modeleve të shtëpive të kukullave. Mësuesi u tregon se si të kërkojnë dhe çfarë të dhënash mund të përdorin. Rezultatet e fituara i printojnë (nëse ka mundësi), shënojnë ose vizatojnë ë fleta. Grupi i tretë: INTERVISTIM. Nxënësit u intervistojnë shokët e tyre të klasës dhe stafin e shkollës duke përdorur 5 Pse-në? Për shembull: <i>Pse është më mirë të bësh një shtëpi kukullash nga kartoni? - Pse nuk mund ta bëjmë prej metali apo xhami? - Pse maketat janë bërë nga materiali që është i lehtë për t'u mbështjellë, prerë, ngjitur?</i> etj. Përmbajtja e secilës pyetje pasuese <i>Pse...?</i> do të varet nga përgjigja e dhënë nga personi i intervistuar. Përgjigjet e të intervistuarve regjistrohen në formë audio, video ose teksti. Nxjerrja e përfundimit. Nxënësit në bazë të konkluzioneve të nxjerra orientohen të identifikojnë tri sfida për zgjidhjen e problemit. Për shembull:

		<table> <tr> <th>VËZHIM</th><th>HULUMTIM</th><th>INTERVISTIM</th></tr> <tr> <td>Njerëzit jetojnë në banesë ose shtëpi.</td><td>Ka lloje të ndryshme të shtëpive të kukullave.</td><td>Maketat bëhen nga një material që është i lehtë për punë.</td></tr> <tr> <td>Në secilën shtëpi ka disa lloje të hapësirave dhe secila hapësirë ka qëllimin e vet.</td><td>Në shtëpitë e kukullave hapësirat janë të njëjta sikurse në shtëpitë reale, por janë më të vogla.</td><td>Shtëpia e kukullave është më lehtë të bëhet nga një karton më i trashë.</td></tr> <tr> <td>Në shtëpi duhet të ndjehemi të sigurt dhe të dashur.</td><td>Shtëpia e kukullave mund të bëhet me shabllon, por mund ta krijojmë edhe vetë.</td><td>Në shtëpitë e kukullave, mobilet mund të bëhen nga kuti boshe, plastelinë, argjile.</td></tr> </table>	VËZHIM	HULUMTIM	INTERVISTIM	Njerëzit jetojnë në banesë ose shtëpi.	Ka lloje të ndryshme të shtëpive të kukullave.	Maketat bëhen nga një material që është i lehtë për punë.	Në secilën shtëpi ka disa lloje të hapësirave dhe secila hapësirë ka qëllimin e vet.	Në shtëpitë e kukullave hapësirat janë të njëjta sikurse në shtëpitë reale, por janë më të vogla.	Shtëpia e kukullave është më lehtë të bëhet nga një karton më i trashë.	Në shtëpi duhet të ndjehemi të sigurt dhe të dashur.	Shtëpia e kukullave mund të bëhet me shabllon, por mund ta krijojmë edhe vetë.	Në shtëpitë e kukullave, mobilet mund të bëhen nga kuti boshe, plastelinë, argjile.
VËZHIM	HULUMTIM	INTERVISTIM												
Njerëzit jetojnë në banesë ose shtëpi.	Ka lloje të ndryshme të shtëpive të kukullave.	Maketat bëhen nga një material që është i lehtë për punë.												
Në secilën shtëpi ka disa lloje të hapësirave dhe secila hapësirë ka qëllimin e vet.	Në shtëpitë e kukullave hapësirat janë të njëjta sikurse në shtëpitë reale, por janë më të vogla.	Shtëpia e kukullave është më lehtë të bëhet nga një karton më i trashë.												
Në shtëpi duhet të ndjehemi të sigurt dhe të dashur.	Shtëpia e kukullave mund të bëhet me shabllon, por mund ta krijojmë edhe vetë.	Në shtëpitë e kukullave, mobilet mund të bëhen nga kuti boshe, plastelinë, argjile.												
Ora e 3-të	Përcaktimi i sfidës	Ngushtimi i fokusit. Zgjidhet një temë që është më afër mundësive të tyre për realizim. Gjatë përcaktimit të sfidës, përdoret metoda e Grupimit sipas temave. Ne i grupojmë sfidat e identifikuara dhe zgjedhim një temë – Bërja e një shtëpie kukullash dhe objekteve/mobilitë për dhomat e shtëpisë.												
Gjenerimi i ideve		Nëpërmjet teknikës Stuhi mendimesh, nxënësit bëjnë propozime se nga çfarë mund të bëhet modeli i shtëpisë së kukullave dhe objektet /mobilitet e dhomave në shtëpinë/shtëpinë e kukullave, si do të duket, çfarë madhësie do të jetë, për çfarë do të përdoret. Idetë shkruhen në tabelë. Nxënësve u lexohet matrica e vlerësimit e cila përmban elementet e mëposhtme: - nga kartoni, plastelina dhe argjila të krijojnë objekte që do të jenë praktike për përdorim; - objektet duhet të jenë të lehtë për t'u bërë; - të mund të përdoren për një kohë më të gjatë. (Shënim. Megenëse gjatë kësaj periudhe nxënësit janë në fazën e shkrim-leximit, shkruhen vetëm fjalë ose fjali të shkurtra.) Nxënësit votojnë për idetë e propozuara. Ideja me numrin më të madh të votave pranohet të jetë prototipi që do të bëjmë në orën e ardhshme.												
Ora e 4-ët dhe 5-të	Prototipizim	Në fillim të orës së mësimi përsëriten elementet e matricës së vlerësimit dhe lënda e përzgjedhur që do të zhvillohet. Prototipi është i natyrës fizike, ka një aplikim praktik dhe do të përdoret për qëllimet e temës Shtëpia ime . Nxënësit ndahen në dy grupe dhe punojnë për të bërë shtëpinë e kukullave dhe mobilje/objekte për shtëpinë e kukullave. Gjatë punimit, nxënësit i vërejnë karakteristikat e materialeve me të cilat punojnë (letër: palosja, prerja, ngjitja; plastelinë dhe argjile: shtrirje, shtypje, grisje) dhe i përshkruajnë dhomat dhe qëllimin e dhomave në shtëpi.												
Ora e 6-të	Testim	Testimi i objekteve të përfunduara kryhet në klasë dhe në klasa të tjera me shokët e tyre të klasës. Demonstrohen objektet e prodhuara dhe merren ide për përdorimin e tyre. Mbledhja e të dhënave dhe udhëzime për përmirësim. Nëpërmjet një ankete, nxënësit prononcohen nëse u pëlqejnë objektet e bëra, sa të lehta apo të vështira ishin për t'u bërë, nëse ishin praktike dhe çfarë do të përmirësonin te objektet e bëra. Idetë e fituara për përmirësim do të përdoren për prodhimin e objekteve të tjera që do të kenë karakter praktik.												

TREGIM PËR KUKULLAT

Në një qytet ka një shkollë, dhe në shkollë ka një klasë. Por nuk është një klasë e zakonshme. Brenda saj nxënës, ka një dërrasë të zezë, ka tavolina dhe karrige dhe dollapë dhe libra shkollorë dhe lodra. Epo, kur jemi te lodrat, besoj jeni të interesuar se çfarë lloj lodrash ka? Hmm, le të numërojmë! Ka një breshkë, një lepur, disa topa dhe tre ose katër kukulla. Klasa ka gjithçka, vetëm një gjë mungon. Nuk kanë shtëpi ku të jetojnë kukullat. Dhe ata janë shumë të pikëlluar sepse nuk kanë shtëpi. Prandaj një ditë vendosën t'u tregonin fëmijëve që mësojnë në atë klasë për problemin e tyre. Kur fëmijët e morën vesh, ata u mbledhën menjëherë dhe filluan të merren vesh se si ta zgjidhnin problemin. Si mendoni nxënës, si e zgjidhën problemin fëmijët e asaj shkolle?

Autore: Glikeria Ilioska

Falënderim

Falënderime të veçanta shkojnë për mësuesit klasorë që në mënyrë joegosite e ndanë përvojën e tyre dhe morën pjesë në realizimin praktik të skenarëve nga Doracaku:

1. Sonja Trifunovska, mësuese klasore – mentore, SHMK "Goce Dellçev" - Tetovë.
2. Lejla Iljazi-Sejdiu, mësuese klasore, SHMK "Goce Delçev" – f. Stençe, komuna e Bërvenicës.
3. Dançe Atanasovska-Ilieva, mësuese klasore, SHMK "Kosta Racin" - f. Podarësh, Radovish.
4. Severxhane Kasami, mësuese klasore, SHMK "Kirili dhe Metodi" - fsh. Stajkovc, Shkup.

Autorja

Literatura e shfrytëzuar

- *Koncepti i arsimit fillor*. 2021. Shkup.
- *Standardet nacionale për arritjet e nxënësve në fund të arsimit fillor*. 2021. Shkup: MASH, BZHA.
- *Programi mësimor i Shoqërisë për klasën e parë*. 2021. Shkup: MASH, BZHA.
- *Planifikimi dhe zbatimi i mësimdhënies sipas konceptit të ri për arsimin fillor, Moduli 2*. 2021. MASH, BZHA.
- Ilioska, G. 2021. *Shoqëria për klasën e parë, materiale për mësim*. Shkup: BZHA.
- Anderson, L.W., Krathwohl, D.R. i saradnici. 2001. *A Taxonomy for Learning, Teaching, and Assessing; A Revision of Bloom's Taxonomy of Educational Objectives*.
- Mikanović, Brane. 2014. *Ishodi učenja i standardi znanja u osnovnom obrazovanju*.
- Prenton Kit, Snezhana Jankullovskaja, H. *Mësimdhënia dhe të nxënit në shekullin e 21-të*. 2009. Shkup: Projekt i USAID për arsim fillor.
- <https://www.teachthought.com/critical-thinking/blooms-taxonomy-verbs>, i aksesueshëm prej dhjetor 2021.
- <https://www.teachthought.com/pedagogy/differentiated-instruction>, i aksesueshëm prej dhjetor 2021.
- Mickovska, Gorica. 2015. *Vlerësimi formativ në mësimin klasor: doracak*. Shkup.
- Damovska, Lena. 2021. *Loja dhe të mësuarit – koncepte të reja në mësimin e hershëm*. Shkup: "Prosvetno dello".
- Liedtka, J. 2018. Why design thinking works. Harvard Business Review, 96(5), 72–79.
- Igor Dimovski, Risto Malçeski, Cvetanka Malçeska. 2019. *Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve*. Shkup: Armaganka.